


Ai i donte udhëtimet dhe i mahniste dëgjuesit me rrëfimet e kujtimeve të tija, veçanërisht ato parisiane. Ishte një nonkonformist i lindur dhe më lejoni të kujtoj rrëfimin e një udhëtimi që një delegacion intelektualësh rumunë dhe, natyrisht, Viktor Eftimi, e ndërmori gjatë një dimri të egër në Bashkimin Sovjetik. Prej disa ditësh ndodheshim në Moskë në pritje të takimit me Josif Visarionoviç Stalinin. Ditët kalonin nën stuhitë e dëborës dhe acareve të pamëshirshme, ndërsa takimi vonohej.

AKAD. ALEKSANDRU BALACI: Si Viktor Eftimi i kërkoi Stalinit në zyrën e tij vizatimin

Përktheu: Dr. Luan Topçiu



Libri i studiuesit Thomas Frashëri

**Princa të Lilit, bij
të Arbërit, familjarë
të Sulltanit**

(fq. 10)

Nga Prof. Dr. Pëllumb Xhufi

SHËNIME MBI LIBRAT

Shqyrtim shkencor i veprës “Ali
pashë Tepelena në artin botëror”
të studiuesit Luan Tashi

(fq. 4)

Nga Akademike, Prof. Zake Prelvukaj

Drita Çomo,

kronikat e fshehta të një jete
- ditari dhe dosja

Nga Elona Baçi

(fq. 6)

Disa mendime për prozën
e Nazmi Rrahmanit

Nga Kujtim Morina

(fq. 8)

Libri “Burgu i Spaçit”, i autorit Dine Dine

**Burgu i Spaçit në një libër
që duhet lexuar**

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 12)

Vështrim rreth poemës “Lumi im”, pjesë e librit
“Mos më pyet ku kam qenë”

Lumi poetik i Ilirian Zhupës

Nga Sadedin Mezuraj

(fq. 14)

Botim i ri nga “Minerva”

**KAMAL RAVIKANT
Duaje veten sikur prej saj
varet jeta jote**

(fq. 21)

ZEF MAZI



Një libër i rëndësishëm për Kosovën botuar
në përvjetorin e Pavarësisë së saj
Kosova, lufta e heshtur

Diplomacia e padukshme që ndryshoi lojën (1991-1999)

Nga Lutfi Dervishi

Përmes këtij rrëfimi, Mazi vendos në qendër rolin e Shqipërisë për Kosovën, sfidat e një shteti të vogël në një krizë të madhe, përplasjet mes realpolitikës dhe së drejtës ndërkombëtare, si dhe peshën e vendimeve që shpesh merren pas dyerve të mbyllura.

(fq. 9)

NJË KUJTIM ME KADARENË,
NJË MBRËMJE DHJETORI NË TIRANË

**Gruas
që i shkon dimri**

Nga Burbuqe Spahiu Lukacevic

(fq. 16)

**Nikos Vlahakis
Ode të shkurtra
për pemët e
shekujve**

Përktheu nga greqishtja
Niko Kacalidha



BIBLIOTEKË

Delvina Kërluku

(fq. 15)

**Mes kohës që ikën
dhe mallit që djeg**

Donika Dabishevc

(fq. 17)

Ngjitun si thue n'mish

Odise Kote

(fq. 18)

Rregulla të thyera...

Ervin Nezha

(fq. 19)

Arratia

Anja Mugerli

(fq. 20)

Këpucët

Përktheu nga origjinali: Nikollë Berishaj

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Roman i Ri nga “Ombra GVG”


**“Zonjusha mbresëlënëse
Kesidi” nga Meihan Boey**

(fq. 11)

Libri shqip
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta
brenda SHBA-së

www.alblibris.al



Takimi im i parë me Viktor Eftimiun ndodhi në kohën e adoleshencës sime. Isha nxënës i Kolegjit Kombëtar në Krajovë dhe, në një nga mbrëmjet letrare, recitova vargjet ogurzeza nga *Gjel i zi*, që evokonin figurën e zymtë të Rojtarit të Burgut, rojtar i errësirës së burgut “shtatë mijëvjeçar”, bashkë me familjen e tij prej përbindshash me: “gruan hardhucë” dhe “fëmijët minj”.

Në atë kohë lexoja ato faqe që kanë mbetur të paharruara për mua edhe sot: rrëfimet e ndritura të Krishtlindjes dhe rrëfimin për një regjizor gjenial, i cili ia kishte kushtuar tërë jetën dhe veprimtarinë e tij e kishte vënë në shërbim (tërësisht) të kultit të dramaturgut të pavdekshëm, William Shakespeare-it.

Në vitin e largët 1953 u angazhova për barazimin e nocionit të përkthyesit me atë të shkrimtarit dhe arrita të themeloj Seksionin e Përkthimeve dhe të Letërsisë Botërore pranë Lidhjes së Shkrimtarëve.

Po atëherë u krijuan edhe grupe shkrimtarësh që të përkthenin tërësisht, në gjuhën rumune, veprat e disa prej krijuesve të mëdhenj të letërsisë botërore. Për përkthimin e veprave të Molierit dhe Shakespeare-it (u botuan pesëmbëdhjetë vëllime!), u përpoqën, ia arritën me rezultate me vlerë artistike të jashtëzakonshme, Tudor Arghezi, Ion Barbu, Alexandru Philippide, Adrian Maniu, Demostene Botez, Tudor Vianu, Tudor Mușatescu, Ion Marin Sadoveanu, Alexandru Kirițescu, Ion Frunzetti, N. Argintescu-Amza, Dan Duțescu, Leon Levițchi dhe, krah as meje, miqtë e mi Mihnea Gheorghiu dhe Valentin Lipatti.

Ai i donte udhëtimet dhe i mahniste dëgjuesit me rrëfimet e kujtimeve të tija, veçanërisht ato pariziane. Ishte një nonkonformist i lindur dhe më lejoni të kujtoj rrëfimin e një udhëtimi që një delegacion intelektualësh rumunë dhe, natyrisht, Viktor Eftimi, e ndërmori gjatë një dimri të egër në Bashkimin Sovjetik. Prej disa ditësh ndodheshim në Moskë në pritje të takimit me Josif Visarionoviç Stalinin. Ditët kalonin nën stuhitë e dëborës dhe acareve të pamëshirshme, ndërsa takimi vonohej.

AKAD. ALEKSANDRU BALACI: Si Viktor Eftimi i kërkoi Stalinin në zyrën e tij vizatimin

Përktheu: Dr. Luan Topçiu

Natyrisht, ishte gjithmonë i pranishëm Viktor Eftimi — i qeshur e shpotitës, fliste dhe shkruante pa të meta gjuhën frënge, bënte vërejtje të mprehta mbi tekstet e përkthyer që i paraqisnim në takimet javore, në përpjekjen për përkryerjen e kryeveprave botërore, përmes një përçapje intelektuale të rrallë, që synonte të dëshmonte se përkthimi është letërsi dhe se përkthyesi është shkrimtar. Viktor Eftimi, gjithmonë elegant (jo vetëm se vishej plot sqimë), përdorte me mjeshtëri thumbimin e mprehtë, shpesh të drejtuar me mirëdashje ndaj kolegut të tij

Demostene Botez-it.

Shtëpia e tij ishte shndërruar në një vend të parapëlqyer takimesh — një shtëpi e ëndërruar dhe e realizuar nga një artist i fjalës — ku zhvilloheshin mbledhje me karakter kulturor, herë-herë takime letrare, të shoqëruara me ftesa bujare për të rinjtë e etur për dije dhe për afirmim letrar.

Viktor Eftimi ishte, siç dihet, një recitues i jashtëzakonshëm. Ne që e kemi njohur dhe e kemi dëgjuar nuk do ta harrojmë kurrë mënyrën se si ai deklamonte, me sukses të plotë para një publiku të magjepsur, vargjet e asaj që ai e quante *Balada e Arit* nga kryevepra *Gjeli i zi*.

Ai i donte udhëtimet dhe i mahniste dëgjuesit me rrëfimet e kujtimeve të tija, veçanërisht ato pariziane. Ishte një nonkonformist i lindur dhe më lejoni të kujtoj rrëfimin e një udhëtimi që një delegacion intelektualësh rumunë — Al. Rosetti, C. I. Parhon, Emil Petrovici dhe, natyrisht, Viktor Eftimi — e ndërmori gjatë një dimri të egër në Bashkimin Sovjetik. Prej disa ditësh ndodheshim në Moskë dhe prisnim të na priste vetë Iosif Visarionoviç Stalin.

Ditët kalonin nën stuhitë e dëborës dhe acareve të pamëshirshme, ndërsa takimi vonohej. Çdo mëngjes, Viktor Eftimi e takonte mikun dhe kolegun e tij të Akademisë Rumune, Alexandru Rosetti, duke i deklamuar vargjet e famshme nga *L'Expiation* të Viktor Hugo-it, që përshkruajnë tronditshëm çoroditjen e ushtrisë franceze gjatë tërheqjes nga Rusia, të pushtuar nga një dimër i pamëshirshëm:

„Sortira-t-on jamais de ce funeste empire?

Deux ennemis! le czar, le nord.

Le nord est pire.”

“Cari” i kohës i priti më në fund dhe Viktor Eftimi e përshkroi atë si një burrec, një mistrec dashakeq, që u bënte pyetje befasuese intelektualëve rumunë mbi përdhunimet e kryera nga ushtarët e Ushtrisë së Kuqe ose mbi sjelljen arrogante të autoriteteve sovjetike. Ndërkohë që fliste, Stalini mbante kokën ulur dhe vizatonte mbi një letër të bardhë profile, silueta njerëzish, skica ndërtesash — një lloj shkarkimi i një tensioni të vazhdueshëm të brendshëm. Në fund të takimit, Viktor Eftimi guxoi t’i kërkonte Stalinin, si kujtim, një nga vizatimet e improvizuara para delegacionit rumun. Tërësisht i çmeritur, “gjeneralisimi” ia dha, por nonkonformisti nuk u kënaq me kaq dhe i kërkoi edhe ta

1 A do të arrijmë ndonjëherë të dalim nga kjo perandori fatkeqe? /Dy armiç na kërcënojnë: Cari dhe veriu.


Ah, më i tmerrshëm është veriu.



nënshkruante vizatimin — dhe I. V. Stalin u bind!

Ishte një gjest disi ballkanik i shkrimtarit të krisur, i cili nuk i harroi kurrë qiejt që u harkuan mbi lindjen e tij - si shqiptar, por që i shërbeu gjatë gjithë jetës “Zonjës së Lartë, gjuhës rumune”.

Ndonjëherë e mikloja sonetistin e madh duke i thënë se e kishte tejkaluar Francesco



Petrarkën, jo vetëm për nga sasia — Eftimiu ka shkruar mbi një mijë sonete — por edhe për nga larmia tematike, pasi ai nuk ishte vetëm këngëtar i një gruaje të vetme, Laurës. Më vjen keq që kam humbur (apo m'u vodh?) një sonet me tejdukshmërinë e kristalit, që ma kishte kushtuar dhe në të cilin emri Alexandru rimonte tingëllueshëm me *cațelandru*. (qenushi)

Ishte muaji maj i vitit 1965. Së bashku me redaktorët Daicoviciu dhe Creangă, ndodheshim në Vjenë, duke përfaqësuar tre universitetet rumune — Cluj Napoca, Iași dhe Bukuresht — në manifestimet e gjashtëqindvjetorit të Universitetit të kryeqytetit austriak. Aty mora lajmin se, së bashku me Viktor Eftimiun, Eugen Jebeleanun dhe Marin Predën, bëja pjesë në një delegacion të PEN Club-it rumun, të ftuar nga homologu francez për dhjetë ditë në Francë.

Më 14 maj në mbrëmje, në stacionin e madh dhe modern të Vjenës, pritëm Viktor Eftimiun dhe Marin Predën (Jebeleanu ndodhej tashmë në Paris). U përqaftuam, siç ndodh kudo në botë kur qëllon që njerëz të njohur takohen në vende të panjohura. U përpoqëm të gjenim vende në vagonët e fjetjes të Wiener Walzer-it, por ishte e pamundur. Në vend të kësaj u vendosëm në dy kabina treni bosh të klasit së parë. Kur treni u nis, filluan reshje shiu të rrëmbyeshëm. Ishte një natë e jashtëzakonshme pranë dy krijesve të mëdhenj të shkrimit rumun. Eftimiu deklamonte me zë të fuqishëm, të magjishëm; Marin Preda dëgjonte, ndërsa unë, në emër të udhëtimit të përbashkët, intonoja vargjet e harmonisë së epërme nga *Invitation au voyage* të Charles Baudelaire-it. Në orën katër të mëngjesit kalonim pranë Innsbruckut, dhe mrekullia vazhdoi për orë të tëra edhe në Zvicër: male, dëborë e përjetshme, liqene alpine. Ishim tejet të përqendruar duke soditur në vazhdimësi.

Pas Bazelit, në hyrje të Francës, bisedën e kontrolloi me kujtimet “franceze” Viktor Eftimiu, duke ngritur një gotë në vagonin-restorant Beaujolais për fatin e mbarë të udhëtimit tonë. Në Paris na prisnin Yves Gandon dhe Jean de Beer, drejtuesit e PEN Club-it francez, si dhe një këshilltar i ambasadës sonë, Vlad. Me një makinë gjigante, *une belle américaine*, përshkuam Parisin në momentet e perëndimit të diellit dhe pa trafik.

Ishte e shtunë, fundjavë, dhe qyteti i madh ishte i braktisur nga banorët vendas. Në Rue Pierre Charon, në një ndërtesë të vjetër, selia e Shtëpisë së Miqve të PEN Club-it, u strehuam në një banesë modeste, por të ngrohtë. Bëmë një dush të fortë, por tepër të nxehtë, për shkak të një instalimi hidraulik që mbeti i prishur deri në largimin tonë, objekt i ankesave të gjata, por të kota, të mjeshtrit Viktor Eftimiu, adhurues i madh i “larjeve” të gjata.

Në kuadrin e këtyre shënimeve të përmbledhura për “qëndrimin” tonë parizian, përmend takimin në *Société des Gens de Lettres*, ku, si miq “të shquar”, u ftuam akëcili të merrnim fjalën. Admiruam edhe një herë frëngjishten e përsosur të bashkëpunëtorit më të vjetër në jetën e gazetës *Le Figaro*, dekanit të presidentëve të PEN Club-eve, që ishte Viktor Eftimiu; patetizmin e kthjellët të poetit të madh Eugen Jebeleanu; maturinë shprehëse të Marin Predës. Ndërsa unë, mbajta një paraqitje mbi tiparet karakteristike të kulturës rumune, duke theksuar latinitetin tonë ishullor në oqeanin e larmishëm gjuhësor të Europës Juglindore. Ishte një takim mes intelektualësh, i udhëhequr nga vullneti i fortë për të bashkëpunuar



në shpëtimin e vlerave shpirtërore dhe të dinjitetit njerëzor.

Kujtoj një koktej në Ambasadën Rumune, ku ishin ftuar personalitete të botës kulturore; një takim tek Suzanne Fasquelle, pasardhësja e shquar e La Rochefoucauld-it. Kishte shumë gazetarë që e rrethonin Viktor Eftimiun, tashmë të njohur për ta. Pastaj në Teatrin “Sarah Bernhardt”, ku aktorët e talentuar rumunë


(në krye me Radu Beligan-in) dhanë një shfaqje me *Rinocerontët*. Atëherë i njoha aktorët që nuk do të vdesin kurrë: Elvira Popescu dhe Eugène Ionesco-n, i cili e vlerësoi shfaqjen rumune të dramës së tij si më të realizuarën artistikisht.

I pranishëm, dominues shpirtërisht, në këto ditë dhe net, Viktor Eftimiu nuk na shoqëroi (duke u justifikuar se ishte tejet e lodhshme për të) në një udhëtim

në jug të Francës, në Avignon, Nicë dhe Menton, por ishte i pranishëm më 25 maj, kur Yves Gandon ofroi një darkë zyrtare për dyzet persona, me fjalime, me dëshmi simpatie intelektuale dhe bashkëpunimi të ardhshëm.

Për këtë udhëtim tonin, Viktor Eftimiu mbajti një konferencë të shkëlqyer në radio. Ma dhuroi tekstin e saj dhe unë ia përcolla Muzeut të Letërsisë Rumune. (Shpresoj të mos ketë humbur, si soneti *Alexandru–cațelandru*!).

Viktor Eftimiu ka mbetur një shpirt i dritës, që ruan kujtimet tona, në vrullin e një personaliteti tejet të gjallë, me humanizmin e tij mbi botën, jetën dhe artin.



Cili ishte akademik

ALEKSANDRU BALACI

Alexandru Balaci (lindur më 12 qershor 1916 , Aurora (Mehedinți) - vdiq më 7 mars 2002 , Bukuresht) ishte një italianist rumun , kritik letrar dhe historian , politikan komunist , anëtar i Akademisë Rumune.

Pasi mbaroi shkollën e mesme në Kraiova dhe Fakultetin e Letërsisë dhe Filozofisë në Bukuresht , ai mori doktoraturën në vitin 1943 me tezën Giovanni Pascoli mbi neoklasizmin italian .

Ai ishte, nga ana tjetër, kryeredaktor në ESPLA, nënkryetar i Komitetit Shtetëror për Kulturë dhe Art, drejtor i Bibliotekës Rumune në Romë të vendosur në ish- Accademia di Romania (Shkolla Rumune në Romë), midis viteve 1981-1990, profesor dhe drejtues departamenti në Fakultetin e Letërsisë në Bukuresht, nënkryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Rumanisë dhe kryeredaktor i revistës Viața românească .

Ai iu përkushtua studimit të kulturës italiane, duke shkruar vepra të shumta referimi dhe duke përkthyer veprat e personaliteteve të saj të mëdha. Ai koordinoi veprën monumentale Historia e Letërsisë Italiane dhe fjalorë të shumtë. Ai ishte anëtar i shumë akademive dhe shoqatave evropiane dhe botërore.

Luan Tashi u lind më 25 shkurt 1965 në Prishtinë. Ai është studiues dhe profesor në Fakultetin e Arteve dhe në Fakultetin e Komunikimit Masiv pranë Kolegjit AAB në Prishtinë.

Para se të trajtohet libri i tij i tretë, me titull *“Ali pashë Tepelena në artin botëror”*, është e domosdoshme të ndalemi në rrugëtimin intelektual dhe shkencor të autorit, si dhe në faktorët që e shtynë profesor Tashin të hulumtojë dhe të studiojë këtë personalitet kompleks dhe shumëdimensional, i cili zë një vend të veçantë në historinë dhe kujtesën kulturore shqiptare.

Për të kuptuar këtë shtysë kërkimore, është e nevojshme të përmendet vepra e tij paraprake, *“Portrete të Skenderbeut gjatë shekujve”*. Për realizimin e kësaj vepre, profesor Tashi zhvilloi për shumë vite kërkime të vazhdueshme në galeri arti, muze, biblioteka, arkiva, si dhe në koleksione të ndryshme publike dhe private në vende të ndryshme të botës, përfshirë: Romën, Firencen, Tiranën, Sofjen, Athinën, Dubrovnikun, New York-un, Washington-in dhe qendra të tjera të rëndësishme kulturore. Si rezultat i këtyre hulumtimeve të gjera, ai krijoi një koleksion të pasur me qindra portrete dhe materiale ikonografike nga burime origjinale, të shoqëruara me të dhëna bibliografike dhe artefakte të ndryshme që lidhen me figurën e Gjergj Kastrioti Skenderbeut. Ky koleksion, në vitin 2018, me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, u prezantua nga Luan Tashi në librin *“Portrete të Skenderbeut gjatë shekujve”*, të botuar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Kjo vepër ka zënë vend në bibliotekat më prestigjioze botërore, ndër të cilat: Bayerische Staatsbibliothek (München), Akademie der Wissenschaften und der Literatur (Mainz), Biblioteca Nazionale Centrale (Roma), Columbia University (New York), Library of Congress (Washington), Woodrow Wilson Presidential Library and Museum (Staunton), National Library (New York), Princeton University Library (New Jersey) dhe Yad Vashem - The World Holocaust Remembrance Center (Jerusalem). Njëkohësisht, kjo vepër prestigjioze është pjesë edhe e institucioneve kryesore shqiptare, si Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës “Pjetër Bogdani” në Prishtinë, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në Tiranë, Akademia e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe Biblioteka Universitare “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Shqyrtim shkencor i veprës “Ali pashë Tepelena në artin botëror” të studiuesit Luan Tashi

Nga Akademike, Prof. Zake Prelvukaj

Gjatë gjithë këtij rrugëtimi kërkimor dhe hulumtimor shumëvjeçar mbi figurën e Gjergj Kastrioti Skenderbeut, profesor Tashi vuri re se në shumicën e arkivave dhe muzeve ku kishte hulumtuar, ishin të pranishme edhe portrete, dokumente dhe burime ikonografike që lidhen me figurën e Ali pashë Tepelenës. Ky fakt u bë një nxitje e rëndësishme intelektuale, e cila, pas përfundimit të studimit mbi Skenderbeun, e shtyu autorin t'i përvishej një projekti të ri kërkimor dhe të fillonte studimet e thelluara mbi këtë personalitet.

Në dhjetor të vitit 2025, Luan Tashi botoi librin e tij të tretë, me titull *“Ali pashë Tepelena në artin botëror”*, një vepër me pasuri të rrallë ikonografike, kushtuar njërit prej figurave më të spikatura dhe më të diskutuara të historisë shqiptare. Kjo vepër është redaktuar nga Prof. Dr. Irakli Koçollari, një nga njohësit më të mirë të jetës dhe veprimtarisë së Ali pashë Tepelenës, dhe është pajisur me recension shkencor nga studiuesi i shquar i artit shqiptar dhe botëror, Prof. Dr. Ferid Hudhri.

Ky botim përbën librin e tretë të autorit dhe përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në studimet historike, kulturore dhe ikonografike shqiptare. Libri i qaset figurës komplekse të Ali pashë Tepelenës përmes një këndvështrimi të veçantë, konkretisht përmes pasqyrimin të tij në artin botëror. Përmes pikturave, gravurave, ilustrimeve dhe burimeve të tjera ikonografike të ruajtura në arkiva të ndryshme evropiane,

Luan Tashi sjell në vëmendje mënyrën se si Ali pasha është perceptuar dhe interpretuar nga artistë dhe udhëtarë të huaj ndër shekuj.

Vepra nuk ndalet vetëm në dimensionin estetik të këtyre përfaqësimeve artistike, por trajton gjithashtu domethënien historike dhe politike të figurës së Ali pashë Tepelenës, duke e analizuar atë si një pararendës të proceseve që çuan drejt formimit të vetëdijes kombëtare shqiptare dhe, më pas, drejt Pavarësisë së Shqipërisë. Ndërthurja e historisë me artin e bën librin tërheqës dhe të vlefshëm si për studiuesit dhe studentët, ashtu edhe për lexuesit e interesuar për historinë shqiptare.


Libri përbën një studim të gjërë dhe të detajuar mbi prezantimin e figurës dhe personalitetit të Ali pashë Tepelenës, ku i nënshtrohet një analize të hollësishme portreteve, duke i sistemuar të gjitha ve-



prat sipas rendit kronologjik. Në këtë kuadër, për secilën vepër evidentohen me saktësi viti i realizimit, autori, vendndodhja aktuale, teknika artistike e përdorur, përmasat, si dhe të dhëna të tjera relevante që kontribuojnë në një interpretim të plotë historik, artistik dhe ikonografik.

Libri i profesor Tashit është i pasuruar me qindra imazhe të Ali pashë Tepelenës, që nga ato të realizuara nga artistë që e kanë parë dhe pikturuar pashain drejt-përdrejt, deri te përfaqësimet e krijuara mbi bazën e imagjinatës artistike. Përveç kësaj, libri përmban edhe një sërë artefaktesh të tjera, si letra, korrespondencë, harta, piktura, gravura, litografi, akuarele, viza-time etj.. Gjithashtu, ai ofron një paraqitje të detajuar të trungut familjar të Ali pashë Tepelenës, si dhe një studim mbi varrezat e pashait, dy djemve dhe nipit të tij.

Për realizimin e këtij studimi mbi fig-



urën e Ali pashë Tepelenës në veprat e artistëve evropianë, Luan Tashi ka zhvilluar kërkime në muze dhe galeri të njohura në Stamboll, Janinë, Pargë, Prevezë, Artë, More, si dhe në vende të tjera që lidhen drejtpërdrejt me jetën dhe veprimtarinë e Aliut.

Pyetja se si dhe pse bota evropiane e kohës u orientua drejt studimit të këtij personaliteti të veçantë, i cili administronte një territor të gjerë të tokave arbërore, gjen përgjigjen e saj në fillimshkullin XIX. Ky interesim nis, në mënyrë të veçantë, me udhëtimet dhe veprën e Lordit Byron.

Në vitin 1811, pas përfundimit të udhëtimeve të tij, poeti i shquar anglez Lord Bajron u kthye në Angli, ku përgatiti dhe botoi veprën monumentale *Shtegtimet e Çajlld Haroldit*, e konsideruar gjerësisht si një nga kryeveprat e letërsisë botërore romantike. Në këtë periudhë, Bajroni pozoi për piktorin anglez Thomas Phillips, i veshur me kostumin tradicional shqiptar që kishte marrë gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri. Portreti u ekspozua disa muaj më vonë në Akademinë Mbretërore të Arteve në Londër, duke ngjallur interes të jashtëzakonshëm në qarqet artistike dhe intelektuale evropiane.

Poema *Çajlld Haroldi* pati një ndikim të ndjeshëm në formësimin e perceptimit evropian mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilët Bajroni i përshkruan me tone admiruese, veçanërisht për mikpritjen, karakterin luftarak dhe traditat e tyre. Këto përshkrime kontribuan në rritjen e interesimit të artistëve, shkrimtarëve dhe udhëpërshkruesve të shekullit XIX për Shqipërinë si hapësirë kulturore dhe historike.

Në të njëjtën kohë, figura e Ali pashë Tepelenës u shndërrua në një objekt të rëndësishëm vëmendjeje për udhëpërshkrues, diplomatë, shkrimtarë dhe artistë evropianë. Tepelena dhe Janina u bënë destinacione të rëndësishme për piktorë që synonin të portretizonin pashain dhe ambientin oriental-ballkanik të oborrit të tij. Piktori britanik Charles Cockerell, së bashku me mikun e tij Thomas Hughes, ndërmoren një udhëtim artistik në territoret shqiptare, duke ndjekur pothuajse të njëjtin itinerar dhe duke realizuar vizatime e skica me vlerë dokumentare dhe estetike.

Ndër veprat më të rëndësishme të kësaj periudhe spikat litografia e piktorit francez Louis Dupré, me titull *Ali Tepelena, pashai i Janinës, duke gjuajtur në liqenin e Butrintit*, e cila konsiderohet gjerësisht si një nga imazhet më autentike të figurës së Ali pashës dhe ka shërbyer si referencë ikonografike për shumë autorë të mëvonshëm. Po ashtu, piktori Alexandre Colin realizoi tablonë *Ali Tepelena, pasha i Janinës, në krahët e Vasiliqisë*, duke kontribuar në mitizimin artistik të figurës së tij.

Ali pashë Tepelenës i atribuohet numri më i madh i tablove dhe portreteve ndër figurat kryesore të historisë shqiptare të shekullit XIX. Portretet më të hershme të tij datojnë para vitit 1804, ndër të cilat dallohen tri akuarele të realizuara nga John Philip Morier, William Haygarth dhe Henry Holland, të cilat përbëjnë dëshmi të hershme vizuale të ikonografisë së pashait.

Figura e Ali pashë Tepelenës u shndërrua në një burim frymëzimi për shumë artistë evropianë, të cilët, përveç portretizimit të tij, gjetën subjekte të veçanta në peizazhet e territoreve të Arbërisë, në arkitekturën, veshjet tradicionale dhe jetën shoqërore të kohës. Këto vepra kontribuan ndjeshëm në njohjen dhe përhapjen e imazhit të Shqipërisë në Evropë dhe më gjerë.

Sot, këto tablo ruhen dhe ekspozohen në disa nga institucionet më prestigjioze muzeale dhe koleksionet e artit në botë, si Metropolitan Museum of Art në Nju Jork, Palacio Cousiño në Santiago, Muzeu Bena-



ki në Athinë, Muzeu i Luvrit në Paris, British Museum në Londër, si edhe në shtëpitë e njohura të ankandeve Christie's dhe Sotheby's në Paris, Londër dhe Nju Jork.

Figura e Ali pashë Tepelenës ka vijuar të trajtohet edhe nga artistë shqiptarë bashkëkohorë, ndër të cilët përmenden Nikolla Lako, Agim Sulaj, Qamil Prizreni, Rakip Shabani, Ndue Pepa, Ben Bellaja, Muntaz Dhrami, Euro Rrasa, Sulid Kasem, Bujar Vani dhe Evis Kabilo, duke dëshmuar vazhdimësinë e interesit artistik për këtë personalitet kompleks të historisë shqiptare.

Profesor Luan Tashi është në fund të realizimit të një studimi mbi fustanellën

shqiptare në veprat të ndryshme evropiane, të titulluar "Fustanella në artin botëror".

Libri përmbanë dy recenza të shkruara me shumë kujdesë nga profesor Koçollari dhe profesor Hudhri.

Pjesë nga recenza e Prof. Dr. Irakli Koçollarit

"Ali pashë Tepelena është ndoshta rasti më unik në faqet e historisë sonë, pasi, gjer së fundmi, është shfaqur pak, në raport me dimensionin e tij të vërtetë, madje për fat të keq në shumë raste është anatemuar apo

përfolur me epitetet "rebel", "i pabesë" etj.. Çuditërisht, as më pak dhe as më shumë, të njejtat epitete janë thënë nga ana osmane edhe për heronë tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skenderbeun. Por, si ajzbergu që mbi sipërfaqe nxejrr fare pak nga pesha dhe dimensionin e tij i vertetë, edhe këta të dy nëpër dekada do të na rrëfenin fare pak nga fuqia, rëndësia dhe lavdia e tyre e vërtetë. Pashai për vetë aftësitë e tij shtetformuese, reformat në ekonomi, ushtri, politikë, diplomaci etj., u thirr nga shumë studiues "Napoleoni Musliman". Nëse gjer tani veprat e artit dedikuar Ali pashës ishin pronë vetëm e galerive të artit, arkivave dhe

(Vijon në faqen 7)



Stèles funéraires d'Ali Pacha, de ses deux fils Véli et Moukhter Pachas, et de son petit-fils, dans le cimetière de Silivri-Capou, à Constantinople.

(La stèle d'Ali Pacha est celle de droite.)

Ditari i Drita Çomos është ndoshta ditari më i njohur në Shqipëri nga ata që janë botuar gjer më sot. Është konsideruar edhe një lloj “Ana Franku shqiptare” dhe ditari i saj si një fenomen në dokumentimin e jetës së një të reje shqiptare që pati një jetë të shkurtër në Shqipërinë komuniste për shkak të sëmundjes së tumorit në mushkëri.

Drita Çomo (19 mars 1958-19 shkurt 1981) ishte e bija e vogël e dy ish-funksionarëve komunistë, Liri Belishova dhe Maqo Çomo. Fati i saj ishte fati i të gjithë fëmijëve të prindërve të dënuar dhe persekutuar. Për shkak të burgosjes së babait dhe internimit të nënës, ajo jetoi me të ëmën dhe vëllain në internim në qytezën e Cërrikut. Edhe pse, sipas ligjeve të kohës fëmijët nuk ishin të internuar, afërmendsh mund të jeton të lirë pa prindërit e tyre. Në këto kushte u rrit Drita Çomo, të cilën bashkë me të vëllain, Petritin, e rriti gjyshja, derisa iu bashkua së ëmës kur ajo u internua në Cërrik, pas disa kohësh që qëndroi në Progonat ku u internua si fillim.

Në vitin 1960, kur shteti shqiptar prishi marrëdhëniet me Bashkimin Sovietik, Liri Belishova, ish-anëtare e Byrosë Politike dhe ish-Sekretare e Komitetit Qendror nuk u dënua, nuk pati për të një gjyq, por menjëherë bashkë me të shoqin, Maqo Çomo – ish-Ministër i Bujqësisë - u zhveshën nga funksionet publike dhe politike e u dërguan në Progonat. Pak më vonë Maqoja, i vetëm, u internua në Zvërnec të Vlorës. Fëmijët e martesës së tyre, Petritin dhe Dritën, i mbajti e ëma e Lirisë në fillim në Tiranë pastaj në Elbasan, Bulja. Dy vajzat e Maqo Çomos nga martesa e parë i mbajtën familja e tij. Liria me dy fëmijët e saj u bashkuan në vitin 1968 në Progonat, dhe më 1970 në Cërrik¹.

Drita ndoqi shkollën tetëvjeçare “Qemal Stafa” në Elbasan dhe shkollën e mesme të përgjithshme gjimnazin në Cërrik. Ajo nuk arriti të merrte dëftesën e pjekurisë në vitin 1976 pasi në vitin e fundit të shkollës së mesme asaj i shfaqet sëmundja e kancerit në mushkëri. Në fund të prillit (26 prill 1976) Drita shtrohet në sanatorium dhe në maj transferohet në spitalin onkologjik. Ajo kalon mbi 3 muaj larg familjes dhe nuk arrin të përmbushë detyrimet shkollore për të vijuar me provimet e maturës (Drita nuk kishte kryer punën prodhuese, kusht ky për marrjen e diplomës, edhe pse me raport mjekësor). (Çomo: 2004, botimi i tretë, f. 30). Edhe pse mjeku rekomandon të mos merrej me asnjë punë fizike apo mendore (Çomo:2004, botimi i tretë, f. 27), për të përfituar kempin (pagesën e paaftësinë për punë) asaj i duhej të fillonte marrëdhëniet e punës në ndërmarrjen komunale në Cërrik. Përgjatë 5 vjetëve Drita bën vajtje-ardhje Cërrik-Elbasan-Tiranë e anasjelltas, derisa mbyll sytë në 19 shkurt 1981.

Fati i ditarit të Dritës

Përgjatë gjithë kohës Drita mbante shënime në fletore në formë ditari. Ditari i Dritës përbëhej nga tri fletore të trasha dhe një bllok shënimesh. Fletoret ishin fletoret më të mëdha në tregun e asaj kohe me format më të madh dhe me kapak kartoni, me çmim 6 lekë dhe njiheshin si fletore 60-lekëshe. Sipas asaj që ka thënë Liri Belishova janë rreth 600 faqe të shkruara. Dy fletoret e para humbën në mënyrë të pashpjeguar për familjen.

Nga leximi i dosjes së Drita Çomos², në arkivin e AIDSSH-së, ka pasur një interesim të ditarëve të Dritës nga ish-Sigurimi i Shtetit, nëpërmjet një dy bashkëpunëtorëve

1 Të dhënat janë marrë nga dosja e Liri Belishovës, arkivi i AIDSSH-së

2 AIDSSH, fondi operativ, dosja nr. 3497, Drita Maqo Çomo (Berishova)

Drita Çomo, kronikat e fshehta të një jete - ditari dhe dosja

Nga Elona Baçi

në mjedisin e shkollës: nxënësja me pseudonimin “Flutura” mori detyrën ta lexonte dhe ta kthente përsëri: “Do të synohet që t’i merret sekret ditari personal dhe në rast se ka interes, ta fotografojmë dhe ta kthejmë përsëri.”³ Ditari në dosje përmendet të paktën tri herë (f. 24, f. 38 dhe f.40) dhe ka qenë në shkollë me shumë mundësi që të jenë marrë dy fletoret e para të ditarit. Dhe as nuk gjenden në dosje. Një bllok shënimesh të cilin Drita e merrte kur lëvizte, edhe ai i është grabitur Dritës, por fatmirësisht është kthyer pas botimit të parë të librit (Çomo: 2004, f.17). Është vetë gruaja e një ish-oficerit të sigurimit që e ka gjetur këtë bllok, me siguri pas vdekjes së tij, dhe nga përmbajtja e ka kuptuar se bëhej fjalë për vajzën e Liri Belishovës dhe

3 AIDSSH, fondi operativ, dosja nr. 3497, Drita Maqo Çomo (Berishova). Raport dhënë b.p. “Flutura”, datë 17.06.1975

ia ka dorëzuar kësaj të fundit. Këtu duket se kemi një shkëputje të zinxhirit funksional të ish-Sigurimit, operatori i të cilit nuk e ka dorëzuar në qendrën e punës, por e ka mbajtur atë për vete. Arsytet nuk dihen, por ndoshta këtë fat kanë pasur edhe dy fletoret e para të ditarit që konsiderohen të humbura që nga koha e saj e shkollës. Nga leximi i dosjes kemi arsye të besojmë se, sipas porosisë së lënë në një relacion të dhënë nga bashkëpunëtorja “Flutura” për Dritën, dhënë më datën 17.6.1975, të ketë qenë ajo që ka marrë ditarët e Dritës. Fakti që nuk është raportuar marrja e bllokut as edhe e ditarëve, hedh hipotezën se dy fletoret nuk janë dorëzuar asnjëherë, por mund të gjenden në ndonjë arkiv personal, në rast se nuk janë asgjësuar.

Ditari dhe libri

Ditari është botuar nën titullin “Dritë që vjen nga humnera”, ditar dhe poezi. Sipas Liri Belishovës është botuar një e katërta e gjithë asaj që ka shkruar Drita dhe kjo sipas përzgjedhjes që Ismail Kadare dhe Elena Kadare i kanë bërë ditarit. Shumë shënime në ditar lidhen edhe me pjesë të shkëputura nga autorë të mëdhenj, lista librash që kishte lexuar dhe që donte të lexonte, pjesë shumë intime e personale, listë piktorësh e kompozitorësh që preferonte, etj.⁴ Për fat të keq edhe një pjesë e mirë e poezive kanë humbur në dy vëllimet e para.

Libri njohu ribotime të njëpasnjëshme pas botimit të parë në vitin 1997. Bashkë me përzgjedhjen ditari u shoqërua nga një parathënie prej Ismail Kadaresë. Ai u përkthye në italisht nga Klara Kodra dhe në frëngjisht nga Edmond Tupja. Botimin në frëngjisht familja e ka përjetuar si një kthim në jetë të Dritës: “Sado e çuditshme të duket, ndjeja një ngushëllim të madh, por edhe gëzim. Duket e pabesueshme, por është e vërtetë. Në gjallje Drita e kishte shumë të vështirë të komunikojë me moshatarët e saj, të kishte shok e miq si një fëmijë normal në një vend normal”⁵. Ky botim në tri gjuhë u pa si një mundësi për bashkëbisedim me rininë e sotme, komunikim i cili iu mohua Dritës për shkak të persekutimit të saj familjar. Ditari ka pasur jehonë duke u krahasuar me ditarin e Ana Frankut, duke bërë të mundur që nga izolimi politik, social, intelektual, të mund të nxjerrë një dëshmi të jetës së familjeve të privuara nga jeta normale, një dëshmi të ndjesive, përvojave, forcës rezistencës

Ditari dhe dosja e ish-Sigurimit të Shtetit – Dy kronika të një jete

Ditari i Dritës mund të konsiderohet me të vërtetë një ditar intim dhe i mbajtur në privatësi. Privatësia e ditarit dhe ruajtja e ditarit është e rëndësishme për diaristin jo vetëm sepse e ndihmon të mbushë atë boshllëk përballë të cilit gjendet, por edhe ta ruajë mos ia marrë dikush: “Përsëri vendosa të shkruaj. Uroj që kjo fletore të mos ketë fatin e dy të tjerave.”, nis ditarin Drita pas “humbjes” së dy të tjerave, që në fakt kishte qenë një marrje me qëllim, pjesë e masave të Sigurimit për të.

Ditari synonte të “gjurmonte” jetën e përditshme, ngjarjet, librat, takimet, por edhe jetën e saj të brendshme: frikërat, dashuritë, ndjesitë, dyshimet, dilemat e një adoleshenteje në kohën e komunizmit. Ishte një kronikë e shkruar me vullnetin e saj, vetëdijen, lirinë apo censurën që ajo vetë përzgjedhi për tekstin e saj.

E premte, 7.X.77

Sot morëm letër nga babi. Dy letrat e para që na kish dërguar akoma s’i kemi marrë. Kjo është e treta.

10 vjet. Përsëri nga e para. Akoma nuk e dimë motivacionin e dënimit. Por kjo as që ka rëndësi. Përsëri nga e para. Loja “mos u nxeh”.

Liria është një nga pasuritë më të shtrenjta që mund t’u ketë dhënë qielli njerëzve. Të gjithë thesaret që fshihen në gjirin e tikës dhe në thellësitë e detit nuk mund të krahasohen me të.

Servantes (Çomo: 2004, botimi i tretë, f. 64)

4 Arkivi personal i gazetares Elsa Demo. Intervistë e Liri Belishovës për Drita Çomon

5 Arkivi personal i gazetares Elsa Demo. Intervistë e Liri Belishovës për Drita Çomon



Tekstet e ditarit janë vërtet komplekse lidhur me raportin që kanë me të vërtetën, frikën për të mos u lexuar, nevojën për të shkruar dhe autocensurën. “...disa poezi e shkrime me përmbajtje direkt kundër diktaturës i shkruante në fletë të veçanta dhe i mbante të përziera me shumë fletë të tjera, me shënime e detyra shkollore, me fletoret e librat e shkollës; që të mos binin në sy në rast kontrolli. Fatkeqësisht disa prej këtyre, si një variant i “Dashuri siberiane”, një poezi e gjatë mbi Nako Spirun, disa shënime mbi “Dimrin e vetmisë së madhe”, tre strofat e poezisë “Skifteri” (për diktatorin) etj., nuk i kam. Si duket i ka grisur në momente të acarimit të situatës.”⁶

Nga ana tjetër hapja e dosjes së Drita Çomos ishte në një farë mënyre një tjetër kronikë e jetës së tij. Dosja ka një datë fillimi (24.12.1974), një datë mbarimi (7.4.1977), datë arkivimi (18.3.1983), numër (3497), kategori (2-A). Sipas fletë-kontrollit në kartotekë, ajo rezulton se “figuron e regjistruar si kontingjent lidhje antiparti , me të dhënat përkatëse: emër, atësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, vendi i punës, profesioni, specialiteti, kombësia, shtetësia.

Dosja përbëhet nga një metodologji e zbatuar me përpikëri nga operatorët e ish-Sigurimit ë shtetit nëpërmjet vendimeve, planeve të masave, orientimit (vijë sjelljes) së bashkëpunëtorëve të disa niveleve, dokumenteve relacione të hartuara nga bashkëpunëtorët, raporte, regjistrimeve me teknikë operative (TO), implikimit të strukturave, njerëzve me vullnet të lirë apo të shtrënguar.

I gjithë ky mekanizëm kompleks, në mënyrë të fshehtë, pa dijeninë e personit (por jo pa intuitën se mund të ishte i survejuar),⁷ vihej në lëvizje dhe hartonte një tjetër kronikë të jetës së saj. Çdo dosje niste me një “biografi”, *biografi e mallkuar, tjetër një institucion ndëshkues që sajoi diktatura e Enver Hoxhës, një sindrom* që ajo e përhapte si tumor malinj nga “prindi me faj”, tek “fëmijët reaksionarë”, tek miqtë e të afërmit⁸ Biografia kështu ka të dhëna mbi gjyshin, prindërit dhe vëllanë e Dritës. Vetë Drita në këtë kohë është në vit të dytë dhe vetëm kaq është shkruar për të.

Raportet nuk nisin nga ngjarje të rëndësishme personale, familjare apo të botës së brendshme, që mund të ngacmonim vetëdijen e diaristit, por nga veprime apo fjalë që rezultonin në dëm të sistemit politik: “*Burimi tregon një ditë kur kishin informacion politik se në djalë i klasës, krahas lajmeve të tjera, tha : - Kina hyri në tregun e përbashkët. Në këtë kohë Drita dhe B.M. (vajza e T.M) u hodhën përnjëherë dhe thanë njëkohësisht: jo, krijoi marrëdhënie diplomatike me tregun e përbashkët.*” (raport dhënë nga b.p. Flutura, dosja nr. 3497-A, f.23). Kriteret për hapjen e dosjes së Dritës nisen qysh nga fakti i të qenët asaj kontingjent antiparti, përgjimet që iu bënë nënës së saj ku u tërhoqën disa konsiderata që ajo kishte për letërsinë e realizmit socialist (...*librat shqip flasin për jetën, por ato përëndimore flasin më bukur. Ato kanë vepra të shkrimtarëve të mëdhenj, nuk kanë vepra të shkrimtarëve të vegjël si këtu*), raportimet nga komandantja e sektorit i hekurudhës ku ajo ishte në aksion, konsideratat për luftën ideologjike (...*po gazetat këtu thonë se kjo luftë që bëhet sot në Shqipëri kundër revizionizmit është shumë më tepër heroike se ajo e Skënderbeut –qeshin me ironi*), modernizmat në veshje, shprehje të dala nga letra dërguar të atit në burg (...*të uroj që jeta të mos tregohet aq e ashpër me ty, siç është treguar deri tani, sepse ti je i fortë dhe e ke duruar çdo gjë i qetë, sepse ti megjithatë gjithmonë e ke dashur jetën*), shoqërimet me njerëz me përbërje të keqe politike. Nëpërmjet këtyre informacioneve ne mund të krijojmë një kronikë të jetës së përditshme të Dritës, e cila edhe pse mund të jetë korrekte, nuk është plotësisht e vërtetë. Janë evidentuar ditë dhe ngjarje të përshkruara nga raportimet e Sigurimit dhe ditari njëkohësisht.

Është e habitshme, kur njihesh me dosjet e ish-Sigurimit kur shikon se sa njerëz kontribuojnë në hartimin e kësaj kronike. *Bashkëpunimi i popullatës në denoncimin e kundërshtarëve politikë dhe shërbimi vullnetar si provokatorë nuk janë sigurisht të pashembullt, por në vendet totalitare, ata janë aq mirë të organizuar, saqë puna e specialistëve është pothuaj e tepërt* (Arent:2002, f.541). Kështu në dosjen e Dritës kemi plot 11 bashkëpunëtorë të niveleve të ndryshme (agjentë, rezidentë, bashkëpunëtorë) të cilët në mënyrë të vetëdijshme dhe të palodhur plotësojnë për policinë sekrete jetën e armikes së shtetit.

Në anën tjetër ditari i Dritës është një kronikë jo vetëm ditore por edhe e brendshme, ku diaristi flet me veten dhe për veten. Poezitë që janë pjesë e ditarit dhe që janë shkruar në fletoren e ditarit na japin një dorë në plotësimin e kronikave ditore. Duke bërë një rigrupim të shkrimeve dhe poezive, sipas datave, mund të mësojmë më shumë mbi njerëzit që kanë ndikuar, protagonistë të ngjarjeve të bukura e të hidhura të jetës. Mund të bëjmë një grafik të gjendjes së saj shpirtërore sipas vijueshmërisë së sëmundjes, ndjenjës së vetmisë, mërzisë, dëshirës për jetën, për veten etj.

Ditari dhe kujtesa

Ditari i Drita Çomos, edhe pse ka hyrë në fondin e letërsisë shqipe, të zhanrit të shkrimit për veten/ditarit, përbën edhe një dokument autentik me natyrë autobiografike që na ndihmon në përfytyrimin e përditshmërisë së jetës shqiptare në mesin e periudhës diktatoriale, vitet ’70-’80, sidomos për atë shtresë të popullsisë larg syve të jetës publike për shkak të persekutimit politik. Pasojat e persekutimit shkonin nga prindi te fëmija, apo në rrethin më të gjerë familjar: familja e origjinës, nëna, vëllezërit, fëmijët e tyre. Siç e shpjegon filozofja Hannah Arendt: “*Me qëllim që të shkatërronin të gjitha lidhjet sociale dhe familjare, spastrimet bëheshin në atë mënyrë që të rrezikonin me të njëjtin dënim të pandehurin dhe të gjithë të afërmit të tij të zakonshëm, nga të njohurit e thjeshtë deri te shokët e tij më të afër e fafëfisi*”. Kjo solli krijimin e një shoqërie të shpërbërë e të individualizuar, të ngjashmen e së cilës nuk e kemi ndeshur kurrë më parë, ngjarjet dhe katastrofat e së cilës vështirë se do të ishin shkaktuar pa të. (Arendt: 2002, f.417, 418)

Teksa sheh me imtësi dosjen e Drita Çomos kupton lehtësisht se, nëpërmjet një rrëfimi intim,- edhe pse të autocensuruar, të grabitur, jo të plotë,- ditari i saj është jo vetëm një dëshmi, por edhe një rrëfim me anë të të cilit mund të thellojmë eksplorimin mungesës së lirive nën totalitarizëm si dhe të kuptojmë edhe më qartë shumë nga mekanizmat e veprimtarisë së ish-Sigurimit dhe të mënyrave të rezistencës e të mbijetesës së viktimave.

6 Arkivi personal i gazetares Elsa Demo. *Intervistë e Liri Belishovës*

7 Ledi Bellishova, vajza e dajës së Dritës, një foto e të cilave hap dosjen e saj të Sigurimit, e cila ruan ditarin origjinal, dëshmon se edhe pse në moshë fare të vogël, kur e shoqëronte gjithmonë në Elbasan, thotë se ata e dinin dhe e kuptonin që dikush i ndiqte gjatë gjithë kohës.

8 Demo Elsa. Të lindësh me biografi “të mallkuar”: [Liri Belishova, tregon kalvarin e të bijës Drita Çomo, pas botimit të ditarit të saj “Dritë që vjen nga humnera”] Shekulli, nr. 188, 11 korrik, 2004, f.19.




(Vijon nga faqja 5)

muzeumeve botërore, tanimë studiuesi pasionant, profesor Luan Tashi na i sjell ato aq bukur në një përmbledhje unike në duart tona, të punuara dhe të kuruara me shumë paision dhe dashuri. Por, botimi i këtij albumi ka edhe një vlerë tjetër simbolike, e cila i rrit dimensionet e tij, ai është realizuar nga një shqiptar i viseve të largëta me Tepelenën e Ali pashës, pra nga një shqiptar i Kosovës, çka tregon se gjaku, gjuha dhe shpirti i ynë, kudo qofshin nuk njuh distanca, sepse ne jemi pranë, bashkë dhe brenda shpirtit të madh të shqiptarisë”.

Pjesë nga recenza e Prof. Dr. Ferid Hudhri

“Pas kërkimeve shumëvjeçare nëpër galeri, muze, biblioteka, arkiva, si dhe koleksione të ndryshme publike dhe private nëpër botë, profesor Luan Tashi na ka sjellë koleksionin më të pasur dhe më të plotë të veprave të artit kushtuar njerit prej figurave më të rëndësishme të historisë shqiptare. Përmes këtij botimi

jepet më e plotë figura e Aliut, që tërhoqi vëmendjen e shumë artistëve evropianë në fundshekullin e XVIII dhe fillimshekullin e XIX. Në ato vite, kur orientalizmi në vendet perëndimore ishte në modë, afërsia e Aliut me Evropën ndikoi pozitivisht për t’u hapur rrugën piktorëve dhe artistëve të tjerë, për të udhëtuar lehtësisht dhe për të krijuar më shumë vepra arti mbi shqiptarët dhe viset shqiptare. Pritja që i bëri Lordit Bajron në sarajet e Tepelenës ndikoi më shumë në popullaritetin e pashait, posaçërisht në mesin e artistëve, ku disa prej të cilëve erdhën enkas për të pikturuar portretin e tij dhe vendet ku ai sundonte. Kjo përmbledhje të tërheq me larminë dhe llojet e ndryshme të imazheve, si: piktura, gravura, litografi, akuarele, viza-time, dorëshkrime, medaljone, skulptura, harta, fotografi, relieve si edhe me krijime të tjera artistike kushtuar Aliut. Ky është një nga botimet më të bukura dhe më të çmuara për bibliotekat e shqiptarëve kudo që ndodhen, si edhe për të huajt që interesohen për botën shqiptare”.



Dëshiroj të shpreh disa mendime pas leximit të dy romaneve të Nazmi Rrahmanit, për mua një zbulim i mirë. Romanin “Malësorja” e gjeta në Zym, më tërhoqi titulli dhe thashë të qëmtoj më shumë si e ka trajtuar autori. Librashitësi më tha: ka shkruar për atë kohë që mos u ktheftë kurrë më. E kuptova, për kohën kur zakonet, traditat e kishin ngërthyer keq femrën shqiptare që nuk vendoste asgjë vetë dhe ishte e shtypur, e poshtëruar nga mjedisi, opinioni, familja, fisi, etj. I botuar në vitin 1965, ndër romanet e para të shkrimtarëve shqiptarë të Kosovës më vjen të bëj një paralele me disa romane të Petro Markos, “Hasta la Vista” më 1958 dhe “Qyteti i Fundit” (1960) që bënë diferencën për prozën e mirë dhe hapën siparin e romanit modern shqiptar.

Ndërsa romanin tjetër “Toka e Përgjakur” (1973) e mora më vonë dhe më la mbresa jo më pak se i pari. Unë nuk e kam lexuar prozën e shkrimtarëve të Kosovës, ndryshe nga poezia e këtyre autorëve që mendoj se deri diku e njoh mirë. I kam pasur në shtëpi kur isha fëmijë disa romane të Hivzi Sulejmanit, Ramiz Kelmendit, Zejnullah Rrahmanit por nuk i kam lexuar përveç një përmbledhjeje me tregime të shkrimtarëve nga Kosova që e kishte botuar shtëpia botuese Naim Frashëri në vitet 70, romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të Rexhep Qoses që ishte në programin shkollor të Shqipërisë në vitet 80 dhe nuk mbaj mend gjë tjetër. Më vonë kam lexuar Anton Pashkun, Mehmet Krajën, etj,

Çfarë ka të veçantë proza e Nazmi Rrahmanit?

Ndërtimi i personazhit, karakterit. Shumë nga shkrimtarët shqiptarë mendoj se të shtyrë për të krijuar një simbolikë nuk arrijnë të ndërtojnë mirë dhe të plotë një karakter letrar. Pra krijojnë idenë e përfaqësimit të shtresës që synojnë dhe të simbolikës por personazhi del i zbehtë. Ndërsa në prozën e Nazmi Rrahmanit mendoj se ka një depërtim të thellë në botën e personazheve, këndvështrimin nga shumë aspekte, ndërtimin e shumë linjave, ndërthurjen e tyre, ndërveprimin, etj. Personazhi shihet nga shumë kënde, prerje, dinamika të jetës dhe përballet me realitetin e krijuar,

Një element tjetër që e tërheq lexuesin në prozën e Nazmi Rrahmanit mendoj se është mbajtja e gjendjes së ankthit të lexuesit që e shpallon ngjarjen gradualisht duke e mbajtur gjithnjë gjendjen e ankthit, emocionit, pa e ditur mirë çfarë do të ndodhë në vazhdim por edhe duke mos e lodhur lexuesin në tjerret pa fund të prozës. Besoj se motoja e të shkruarit të këtij shkrimtari është: shkruaj për atë që njeh më mirë. Autori mendoj se i përket më shumë rrymës së realizmit që edhe kur edhe trillon, e bën sa më të besueshme duke e ngërthyer realitetin artistik në shumë plane që të ngjajë sa më i vërtetë. Ky stil të shkruari i shkrimtarit afrohet me dëshminë apo edhe me narrativën dokumentare siç është thënë edhe nga kritikë të tjerë. Në fakt ndër dy kolonat e shkrimit letrar, trillimin dhe dëshminë,

Disa mendime për prozën e Nazmi Rrahmanit

Nga Kujtim Morina



nuk është pak të kesh të fortë, të paktën njëren prej tyre.

Për prozën e Nazmi Rrahmanit shprehet edhe albanologu i njohur Robert Elsie. “Nazmi Rrahmani nga zona e Podujevës një romancier mjaft prodhimtar dhe i njohur që ka shkruar për jetën në fshatin kosovar” - shkruan Elsie në librin e tij “Letërsia shqipe, një histori e shkurtër”. Pra autori shkruan për jetën në fshatin kosovar që nuk është pak. Mendoj se arrin të depërtojë në mentalitetin e brendshëm të shqiptarit të Kosovës me lidhjen e fortë me tokën, gjakmarrjen të cilën

e analizon në shumë plane ashtu siç është e ngulitur për shumë breza në jetën e këtyre banorëve, jetën e femrës shqiptare, zakonet, traditat që janë si në pjesët e tjera të etnosit shqiptar. Autori shkruan për një periudhë mes dy luftërave botërore dhe më pas dhe pasqyron edhe një aspekt pak të njohur me themel, dëbimin e shqiptarëve të Kosovës në Turqi nga makineria shtetërore jugosllave. Mes këtij operacioni dhe manipulimi pothuaj masiv, disa nga personazhet e shkrimtarit arrijnë të kthehen nga mërgimi, nga mosgjetja e vetes atje, nga dashuria e madhe për vendin ku

kanë lindur dhe rindërtojnë jetën prapë në vendlindje.

Gjuha e romaneve është mbreselënëse. Dialogjet përshtaten në dialekt madje edhe përshkrimet me fjalë të gjetura që i përshtaten situatës. Gjithashtu ka edhe shprehje të zonës që qëndrojnë mjaft mirë. Përshkrime të natyrës, të jetës së personazheve janë gjithnjë sa të shtjelluara aq edhe të kursyera që mos ta kalojnë masën. Gjeografia e autorit duket se është pak e kufizuar, kryesisht në Llap e Gollak, por ai e kompenson këtë me një njohje të thellë të psikologjisë së personazheve dhe vëzhgim të mprehtë të jetës. Kam lexuar se autori ka shkruar vetëm romane, jo prozë të shkurtër, pra është përshtatur mirë dhe një kohë relativisht të gjatë me prozën e gjatë Megjithatë është çudi që nuk ka botuar pas vitit 1978. Ndërkohë dihet se që nga fillim i viteve 90 e në vazhdim ka ngritur shtëpinë botuese “Faik Konica”.

Duket se autori përshkruan një periudhë kryesisht të viteve 30 dhe 50 të shekullit të 20. Nuk ka shkruar për shtypjen nga regjimi serb në Kosovë dhe gjithë pasojat që ka lënë ai regjim shtypës e diskriminues. Kjo është e kuptueshme nga censura e kohës kur janë botuar romanet. Nuk mund të luftosh njëkohësisht në të gjitha drejtimet. Disa nga romanet janë botuar edhe në Shqipëri në vitet 70. Nuk e di sa kanë arritur të lexohen apo çfarë ndikimi kanë pasur. Ndërkohë në Kosovë, me sa kam dëgjuar disa nga romanet e tij kanë qenë të përfshira për një kohë të gjatë në programin shkollor, s’po them në lekturën shkollore se s’po më pëlqen si term.



Kosova, lufta e heshtur e Zef Mazit knuk është thjesht një rrëfim personal, as një mozaik kujtimesh të shpërndara nëpër vite. Ky libër është testament diplomatik, i shkruar nga një njeri që jo vetëm i pa ngjarjet nga brenda, por i parashikoi, i paralajmëroi dhe aq sa i lejohej, u përpoq t'i ndryshonte me këmbëngulje dhe me një punë të jashtëzakonshme politike e diplomatike. Çdo faqe e tij rrëfen se sa e mundimshme ishte të arrije një sukses të vogël në një terren të madh fuqish, ku zëri i Shqipërisë shpesh humbte mes kalkulimeve të të tjerëve.

Zef Mazi i përket brezit të parë të diplomatëve shqiptarë që u dërguan në arenën ndërkombëtare pa manual, pa busull dhe shpesh pa mbështetje politike. Një brez që u detyrua të mësonte rregullat e lojës brenda vetë lojës, në një kohë kur pak ishin ata që dëgjonin zërin shqiptar dhe edhe më të paktë ata që e merrnin seriozisht. Për këtë arsye, rrëfimi i tij është i çmuar dhe i pazëvendësueshëm. Ai tregon se diplomacia e asaj dekade ishte shumë më e vështirë dhe komplekse se çdo ndërhyrje e mëvonshme ushtarake nga qielli. Kjo konfirmohet edhe nga vlerësimet e kolegëve të tij ndërkombëtarë, që e quajnë kontributin e tij “remarkable”, “major diplomatic performance”, “exceptionally clear”, “perfectly delivered”, “working with very little, you have added honor to the image of Albania in the world. This is no small accomplishment” etj.

Nga Helsinki në Berlin, nga Vjena në Londër, Zef Mazi ka qenë aktor i tre kapitujve themelorë: ringritjes së diplomacisë shqiptare (futja në KSBE dhe kontaktet e para me SHBA-në), përballjes me realpolitikën europiane dhe serbe, si dhe menaxhimit të shpërthimit të krizës në ish-Jugosllavi. Në çdo tryezë ndërkombëtare ai përfaqësoi një Shqipëri që duhej të kishte qartësi për çështjen më të ndjeshme e thelbësore të kohës: Kosovën.

Një nga fijet më interesante të këtij libri, edhe pse jo gjithnjë e dukshme në histori, është marrëdhënia profesionale dhe njerëzore e autorit me personalitetet kryesore të Kosovës, sidomos me Bujar Bukoshin, kryeministrin e qeverisë në mërgim. Si këshilltar i padeklaruar, marrëdhënia mes tyre ishte themeli i një strategjie të përbashkët, e ndërtuar mbi besimin, qartësinë dhe kuptimin e kristaltë të rreziqeve të kohës.

Mazi e kuptoi që herët se kriza jugosllave kishte zemrën në Kosovë, se aty kishte filluar dhe aty do të përfundonte. Se çdo përkëdhelje ndaj Millosheviçit ishte rruga më e shpejtë drejt katastrofës. Bukoshi, nga ana e tij, vlerësoi te Mazi profesionalizmin, qartësinë dhe guximin për të sfiduar interesat

Kosova, lufta e heshtur e Zef Mazit

nga Lutfi Dervishi

Zef Mazi është një nga diplomatët më me përvojë dhe më me ndikim të Shqipërisë në dekadat e fundit. Libri i tij *Kosova, lufta e heshtur, diplomacia e padukshme që ndryshoi lojën (1991-1999)* mbështetet pikërisht mbi këtë përvojë të jashtëzakonshme. Me një karrierë që shtrihet nga misionet diplomatike në Vjenë, Bernë, Londër, Dublin, OKB dhe në organizatat kryesore ndërkombëtare, deri te poste si drejtues i strategjisë në IAEA dhe i negociatave të Shqipërisë për integrimin europian, Mazi ka qenë dëshmitar dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në proceset që formësuan fatin e Kosovës në vitet vendimtare të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Përmes këtij rrëfimi, Mazi vendos në qendër rolin e Shqipërisë për Kosovën, sfidat e një shteti të vogël në një krizë të madhe, përplasjet mes realpolitikës dhe së drejtës ndërkombëtare, si dhe peshën e vendimeve që shpesh merren pas dyerve të mbyllura. Ai ofron jo vetëm kujtime reale mbi bazë arkivore, por edhe analiza të sakta të mekanizmave të diplomacisë, të vështirësive dhe të proceseve që çuan drejt pavarësisë së Kosovës. Ky libër është një testament i qartë i kontributit të tij intelektual dhe diplomatik, si dhe një udhëzues për të kuptuar se si zhvillohet në realitet diplomacia kur përballë është fati i një populli.

e kalkulimet e ditës, madje edhe kur këto vinin nga Brukseli, Uashingtoni apo vetë Tirana.

Ky libër e dokumenton qartë se sa shumë e ka vuajtur Shqipëria dhe sa shtrenjtë e ka paguar Kosova çmimin e heshtjes europiane. Në vitet kur vëmendja ndërkombëtare ishte përqendruar në Bosnjë, diplomacia shqiptare dhe qeveria në mërgim e Kosovës kërkonin të hapnin çdo derë për ta bërë të dukshëm një realitet që shumë refuzonin ta shihnin. Zef Mazi ishte ndër të paktët që këmbënguli dhe paralajmëroi se Kosova nuk ishte çështje e brendshme e Serbisë, as e një pakice kombëtare, por ishte çështje madhore identitare kombëtare, një vatër krize që do të shpërthente. Ai e pa rrezikun përpara se të nisnin krismat, në një kohë kur askush nuk donte ta dëgjonte. Dhe koha i dha të drejtë.

Përtej dokumenteve dhe dëshmive, që janë në themel, ky libër është pasqyrë e integritetit të autorit. Mënyra si reagon një diplomat në momentet e pasigurta tregon kush është njeriu. Mazi nuk fsheh tensionin midis asaj që mendonte dhe asaj që i kërkohej të thoshte. Ai ruajti linjën e tij profesionale edhe kur udhëzimet nga Tirana i kërkonin vetëm “të lexonte qëndrimin zyrtar”. Këmbëngulja e tij për një fjalë, një nuancë apo një formulim të saktë, edhe kur të gjithë të tjerët mendonin se “deklarata u mbyll”, nuk ishte kokëfortësi. Ishte qartësi strategjike. Pikërisht këtu qëndron vlera e këtij rrëfimi.

Kosova, lufta e heshtur është një pasqyrë e një realiteti që pak veta e panë dhe akoma më pak e kuptuan. Ai rrëfen një dekadë pune intensive, shpesh të padukshme, nga një brez i vogël diplomatësh që morën mbi supe një barrë shumë më të madhe se vetja, me bindjen se Kosova duhej, me çdo çmim, të kishte zë dhe tagër në arenën ndërkombëtare.

Në këtë libër, Zef Mazi rindërton me saktësi rolin e diplomacisë shqiptare në “luftën e heshtur” për Kosovën. Ai demonstroi se diplomacia krijoi themelet që më pas bënë të mundur ndryshimin gradual të qëndrimeve ndërkombëtare. Libri dëshmon se asgjë në diplomaci nuk arrihet lehtë dhe shpejt, veçanërisht kur je i vogël dhe me peshë të kufizuar. Duhet muaj dhe shpesh vite këmbënguljeje. Ai jo vetëm ia ka arritur, por na e ka bërë më të kuptueshme atë që dukej e pamundur, luftën dhe përpjekjet për suksesin historik: Kosova shtet i pavarur.

Lutfi Dervishi

Lektor/ Pedagog

Lënda: Gazetaria investigative

Departamenti i Gazetarisë dhe i

Komunikimit

Fakulteti Histori-Filologji,

Universiteti i Tiranës

Tiranë, nëntor 2025



Mes hulumtimit të historisë së një familjeje mesjetare dhe rivlerësimit të rolit të individit në histori

Për t'i dhënë një kuptim titullit sibilik të këtij studimi të thellë e të mprehtë të studiuesit Thomas Frashëri, po e themi që në fillim se bëhet fjalë për një vepër, të shkruar sipas postulateve të heuristikës moderne, e cila vë në fokus historinë e një familjeje emblematike të mesjetës shqiptare, familjes Topia, në kohën e ndryshimeve epokale që sollën në Shqipëri posaçërisht shekujt XIV-XV. Kur zgjodhi të trajtojë këtë subjekt, Frashëri me siguri e ka llogaritur se do të ndeshet me vështirësitë specifike që një subjekt i tillë bart për studiuesin. Topiajt kanë sunduar në territoret e përfshira, grosso modo, mes rrjedhjes së lumit Mat e asaj të lumit Shkumbin. Në një kohë, si ajo e shekujve XIV-XV, kur historia vërtitej rreth idesë së universalizmit politik e fetar në emër të bashkimit të Romës së Vjetër me Romën e Re, në atë fashë qëndrore të Shqipërisë mesjetare u realizuan kontakte njerëzish e kulturash të ndryshme të cilat, siç thotë autori i këtij libri, sollën ndryshime modelesh, institucionesh e deri identitetesh më së pari tek elita drejtuese, që në këtë territor gjen shprehjen më të lartë e më të qëndrueshme tek familja Topia.

Duhet thënë se në planin metodik studimi i Frashërit shënon një ndarje të prerë nga koncepti marksist i ekzaltimit të rolit të masave dhe i mohimit të rolit të individit në histori, i cili për gati pesëdhjet vjet ishte filli i kuq i studimeve historike në Shqipëri. Qëllimi i tij në këtë studim është të veçojë e të gdhëndë në një relief sa më të thellë e të vërtetë faktorin Topia, në korrelacion me kohën dhe mjedisin e afërt e të largët të tij. Për rrjedhojë, studimi i Frashërit ka rezultuar një histori prozopografike e Topiajve e ndërthurur me atë të Balshëve, të Arianitëve, Muzakëve dhe sigurisht të Kastriotëve dhe, më tej, me historinë e Anzhuinëve të Francës, të Napolit, të Tarentit e të Budës, të Nemanjiçëve, Mërnjaçeviçëve, Lazareviçëve e Brankoviçëve serbë, të mbretërorëve bosnjakë e, sigurisht, të dinastisë perandorake osmane. Në kërkim të heureka-s finale të Arkimedit, autori ka ndjekur rrugën e gjatë e të mundimshme të qëmtimit të thellë e të imët heuristik, duke analizuar me kujdes një lëndë të pasur të grumbulluar nga arkivat, nga kronikat e kohës, nga regjistra kadastrale e kishtarë, nga burime letrare, gjenealogjike, prozopografike, epigrafike dhe, për herë të parë në historinë e studimeve shqiptare, të atyre heraldike.

Pikërisht, leximi profesional i emblemes së Karl Topisë, të inkastruar në murin e kishës së manastirit të Shën Gjon Vladimirit (Elbasan), shënon pikënisjen e linjës kërkimore të autorit. Ndryshe nga trajtimet e përcipta të deritashme, Frashëri ka bërë një analizë profesionale prej heraldisti të formuar të monumentit. Ai sheh aty një shqyt heraldik të ndarë vertikalisht në dy pjesë, ku pjesa e djathtë shpalos stemën e familjes de Courtenay, titullare e perandorisë latine të Kostandinopojës: fushë e kuqe me një kryq të artë qëndror që ndan në katër pjesë gjysmefushën e skudit. Në qendër të çdonjerës nga katër hapësirat qëndron nga një disk i pruar me kryq të brendashkruar,



Libri i studiuesit Thomas Frashëri

Princa të Lilit, bij të Arbërit, familjarë të Sulltanit

Nga prof. dr. Pëllumb Xhufi



ku çdo kryq i brendashkruar rrethohet nga katër kryqe të vogla të lira, gjithashtu të pruarara. Gjysmefusha e majtë e shqytit përfaqëson stemën e Anzhuinëve Tarentinë, një fushë të kaltër me lila të artë të përshkuar diagonalisht nga një fash i argjentë, që nënvizon nënrenditjen hierarkike të tyre në raport me mbretërorët e Napolit. E ndërtuar kështu, stema e Karl Topisë duket identike me stemën e pasardhësve të Filipit I të Tarentit prej martesës së tij me Catherine de Valois Courtenay, perandoreshë titullare e Kostandinopojës. Por Frashëri shkon edhe më tej. Ai dallon një përmbysje në renditjen e gjysmefushave të skudit të Topisë në raport me ato të skudit heraldik të Filipit të Tarentit. Në stemën e Karlit, në krahun e preferuar, atë të djathtë, qëndron gjysmefusha e skudit me simbolet perandorake të Kostandinopojës latine. Ky detaj i rëndësishëm e tërheq Frashërin të shohë aty një mesazh të caktuar të Karl Topisë, i cili nëpërmjet simbolikës nënvizon një lidhje gjaku të tij me shtëpinë mbretërore të Francës, gjë që shprehet me fjalë edhe nga mbishkrimet në latinisht e në

greqisht të inkuorporuar në murin e kishës së manastirit të Shën Gjon Vladimirit.


Frashëri sheh të njëjtën këmbëngulje të Karl Topisë për të evidentuar prejardhjen nga dinastia e mbretërve të Francës e të perandorëve latinë të Kostandinopojës, si ajo e perandoreshës titullare Catherine de Courtenay, e cila si në skulpturën e saj e të të shoqit, Filip Anzhu i Tarentit në kishën San Domenico Maggiore të Napolit, ashtu edhe në mbishkrimin që shoqëron ato, shpërfaq epërsinë hierarkike në raport me bashkëshortin, duke u paraqitur vetë me kurorën perandorake dhe duke e prezantuar Filipin si “burrë i Katerinës, prej gjakut mbretëror të Francës”. Me interes është qëmtimi i kujdesshëm nga Frashëri i një fraze lakonike të Dhimitër Frëngut, i cili, bazuar edhe në romanin kalorësiak të Barberinos “Guerin il Meschino” (1410), mbron idenë e prejardhjes së Karl Topisë nga linja e Karlit të Madh dhe e mbretërve pasardhës të Francës. Shënojmë kalimthi këtu që Frashëri i ka dhënë vlerën e një dokumenti historik një tjetër monumenti, sarkofagut

të dukës Giovanni Anzhu të Durrsit, duke lexuar e interpretuar drejt, sipas nesh, grupin skulpturor bashkë me mbishkrimin përkatës, për çka do të flitet më poshtë.

Duke ndërtuar kuadrin e vet historik të lidhjeve dinastike të Karl Topisë me mbretërorët e Francës e me degën e tyre të mbretërisë së Napolit, Frashëri normalizon në një farë mënyre marrëdhënien e Topiajve me Anzhuinët e çautorizon versionin e rrëmbimit nga Andrea Topia të një bije ilegjitime Anzhu, të destinuar për një princ latin të Moresë, version i dhënë mëse pesë shekuj më parë nga kronisti Gjon Muzaka. Në funksion të këtij kuadri historik duket se flasin edhe qëndrime të gjata të Tanush Topisë, e pas tij, edhe të Karl Topisë e të Dominik Topisë në oborret anzhuine të Napolit e të Hungarisë, gjë që, bashkë me elementë të tjerë, siç është ai i stemës së Karl Topisë, krijon perceptimin e një raporti të ngushtë të Topiajve me dinastinë franceze, çka i diferencon ata nga mjedisi shqiptar, i privilegjon e i vendos në krye të hierarkisë së patriciatit shqiptar të shek. XIV-XV.

Autorit i është dashur mund i madh për të mbështetur këtë primat të pretenduar të Topiajve, që ridhte natyrshëm nga lidhjet preferenciale që ata kishin me linjën dinastike Valois-Anzhu. Në këtë vështrim, përveç se qëmton me kujdes çdo element që lidh historinë e Topiajve me ta, ai i ka kushtuar shumë vend zhvillimeve brenda asaj dinastie. Të dhënat dokumentare janë tepër të rralla për të thënë diçka të sigurt lidhur me vijimësinë e lidhjeve mes Topiajve me Anzhu të franko-hungaro-napoletanë, ose për të provuar ndikimin e tyre në zhvillimet historike në Shqipërinë e shek. XIV-XV. Por këmbëngulja e autorit për ta hetuar marrëdhënien me shtëpinë mbretërore të Francës jo vetëm nga poshtë lart, por edhe nga lart poshtë, fut në mendime edhe më skeptikun e lexuesve të kësaj pune të mundimshme të Frashërit.

Për të provuar se ato marrëdhënie kanë patur luhatjet e tyre, Frashëri ka kapur një moment të hershëm, atë të vitit 1329, kur konti Tanush Topia shfaqet në mbretërinë e Napolit e kërkon të faleshin e t'i viheshin në dispozicion 300 shqiptarë të burgosur, sigurisht si besëthyer ose kundërshtarë të Anzhuinëve, të cilët do t'i shërbenin atij për të përballuar “disa rivalë e armiq që përpiqeshin të pushtonin tokat e tij”. Në atë rast Mbreti Robert e quan kontin e zotin e Arbërit, Tanush Topinë, si “njeriun e tij besnik”. Pranoi t'i falë fajtorët, urdhëroi t'i jepeshin në dorëzim Topisë 300 të burgosurit shqiptarë, që padyshim nuk ishin subjekte dosido, por persona të një farë niveli e të njohur personalë të Tanushit. Nëntë vjet më vonë, vetë Tanush Topia nënshkroi një traktat me Anzhuinët e Durrësit. Teksti i traktatit sqaron se ai dokument ishte bërë i nevojshëm pas një periudhe konflikti mes tyre, kur Topia kishte zënë rob edhe një komandant anzhuin, Guljelmin e San Severinos. Me traktatin në fjalë, Anzhuinët i falnin atij fajet e gabimet e bëra dhe e pranonin përsëri në besë të tyre. Pra, si në rastin e Karlit I Anzhu, të Karlit II apo edhe të mbretit Robert, burimet anzhuine





Karl Topia

ofrojnë edhe momente paqëndrueshmërie në marrëdhëniet e anzhuinëve me krerët shqiptarë, e posaçërisht me Topiajt.

Leximi bindës - në ff. 263-268 të librit - që vetë Frashëri i bën sarkofagut të Giovanni Anzhu Durrsakut në San Domenico Maggiore të Napolit (1337), ku ky është skulpturuar në një qëndrim prej sovranit përballë një grupi zotërish shqiptarë, që shprehin pendim e bindje ndaj tij - përveç një personazhi të vetëm, që të sjell ndërmend Tanush Topinë, i cili në mënyrë sfiduese e hedh vështrimin anash si për shmangur vështrimin e Anzhuinit - ilustron në mënyrë lapidare thelbin e marrëdhënieve shpesh herë të tensionuara të fisnikëve shqiptarë me zotërit e përtejdetit. Jo më kot - edhe ky është një konstatim i vëmendshëm i Frashërit - mbishkrimi e cilëson Giovannin e Durrësit “zot e korrigjues i Arbërve”, duke shprehur në



Stema e Topiajve



mënyrë të përmbledhur atë që vetë Anzhuinët e pohojnë vazhdimisht në aktet e tyre, ku flitet gjithashtu për rekuperimin e tërheqjen prej tyre në rrugën e drejtë të krerëve Arbër. Pra, që Topiajt, njëloj si krerë të tjerë, nuk patën marrëdhënie idilike me anzhuinët, ky është një fakt mjaftueshëm i dëshmuar. Në 1372 Luigji i Navarrës e përfshin Karl Topinë mes njëzet krerëve shqiptarë kundërshtarë të Anzhuinëve, madje ai dhe Balsha I cilësohen “armi q të hershëm” të tyre, aq sa për kapjen rob të tyre u vu një shpërblim prej një mijë dukatësh.

Për sa i përket periudhës kulmore, asaj të Karl Topisë, Frashëri mendon se, pas një qëndrimi të tij të supozuar në oborrin e Hungarisë, Karli u kthye në krye të principatës së tij si aleat i mbretit Luigji Madh. Edhe njëherë, një shënim historik në gjuhën sllave nga Muzeu Historik i Ohrit i jep mbështetje Frashërit për të potencuar qëndrimin e tij se Topia ishte kundërshtar i carit serb Stefan Dushan, dhe pas vdekjes së këtij të fundit, ai punoi për të zhdukur çdo gjurmë të sundimit të tij, siç veproi edhe me veprën restauruese në kishën e Shën Klementit të Ohrit.

Në fund të këtij studimi të thellë e të mprehtë, autori Thomas Frashëri i rikthehet personazhit të cilit i ka kushtuar faqet e para të tij, Karloğlu Ali beut. Emri i tij gjendet në mbishkrimin e xhamisë Kurshumlie në qytetin Karlovo në Bullgari, ndërtuar pikërisht prej tij në vitin 1485. Ai është identifikuar si kujdestari (lalà) i pestë i Cem Sulltanit, dalit fatkeq të Mehmetit II. Ka qenë Franz Babinger ai që një shekull më parë hodhi idenë se Ali beu ishte një djalë i islamizuar i Carlo Toccas, kont i Qefalonisë, dukë i Leukadës dhe despot i Janinës në kapërcyell të shekujve XIV-XV. Ide që vetë Babinger e vuri në dyshim në vitet e mëvonshme. Nga ana e tij, Halil Inalçik sinjalizon praninë e një familjeje me prona të shumta në zonën e Krujës, të përfaqësuar nga i jati, Karli, dhe nga bijtë e tij (Karli-oğulari) Aliu, Andrea e Muzaku. Regjistrat osmanë të shekullit XVI i regjistrojnë territoret në fjalë nën emrin “vendi i Karlit” (Karli-ili). Pas një analize të gjatë e të mundimshme të të gjitha burimeve të disponueshme, Frashëri arrin në përfundimin se pasardhësit e Karl Topisë shfaqen ndonjëherë (Pal Engjëlli, Dhimitër Frëngu, Du Cange) me epitetin, tashmë mbiemër, Karlovich (sll. djemtë e Karlit), që është versioni sllav i turqishtes Karloğlu. Të kthyer si mbiemër, Frashëri e sheh të mbajtur atë nga bijtë e islamizuar të çiftit Karl Muzak Topia dhe Mamica Kastrioti, motër e Skënderbeut, për të cilët bëhet fjalë në kronika të kohës. Pikërisht njeri nga djemtë duhet të jetë, sipas Frashërit, ndërtuesi i xhamisë Kurshumlie në qytetin Karlovo në Bullgari, Aliu bir i Karlit (Karlovich=Karli-oğlu).

Ritheksojmë se ky i studiuesit Thomas Frashëri është një studim në front të gjerë, që ka kërkuar njohuri të thella, gjuhë të huaja, këmbëngulje e durim prej murgu. Frashëri i ka të gjitha këto e falë tyre ka guxuar të trajtojë e të hedhë dritë mbi çështje pak e aspak të trajtuara në të kaluarën. Me një qasje gjithpërfshirëse, me argumenta e me një frymë të fortë analize, ai ka arritur të ravijëzojë madje edhe të gdhendë personazhe, ngjarje, marrëdhënie të fshehura ose të humbura në atë epokë transformimesh të mëdha, edhe identitare, siç ishin shekujt XIV-XV.

BOTIM I RI NGA MINERVA

KAMAL RAVIKANT

Duaje veten sikur prej saj varet jeta jote,

LIBRI FENOMENAL
I ZHVILLIMIT PERSONAL

“Përvoja më transformuese ka qenë thjesht të dua veten...”

Kur kompania që kishte ndërtuar për mbi një dekadë falimentoi, CEO-ja i Silicon Valley-t, Kamal Ravikant, u gjend në një periudhë depresioni të thellë.

Pasi preku fundin, e vetmja dritë që gjeti erdhi në formën e një meditimi të thjeshtë: E dua veten.

Kjo u shndërrua në një praktikë mendore që i ndryshoi jetën, përmes së cilës ai filloi të zbulonte një sistem mjetesh për të qëndruar pozitiv, i balancuar dhe për të ecur përpara.

Shumë prej nesh nuk mësojmë kurrë si ta duam veten, dhe në *Duaje veten sikur prej saj varet jeta jote*, Kamal ndan gjithçka që ka mësuar. Një libër praktik dhe fuqizues që do t’ju transformojë dhe do t’ju japë dhuratën e paçmueshme të dashurisë jetëgjatë për veten.

SEKRETI I VETËBESIMIT

DUAJE
VETEN
SIKUR PREJ SAJ
VARET
JETA JOTE

KAMAL RAVIKANT

Minerva

Librin e parë të Dine Dines ma dha një bashkëvuajtës i tij, Shefqet Dobra, i cili më ftoi një ditë të shkonim në Gjazë, atje ku kish kaluar vite internimi bashkë me autorin e librit. Takuam një bashkëvuajtësin e tyre, i cili na ftoi në shtëpi. Kur erdhi e ëma, na tha: “Nënë time pyeteni nga `90-ta e këndeje, se nga `90-ta e poshtë i është fshirë memoria.” Çuditërisht, shiriti ishte fshirë në vitet e vuajtjeve. (Kabinat elektrike digjen në mot të ftohtë dhe pajisjet elektronike, kur bien rrufe.) Pikërisht vitet e fshira nga serveri i kujtesës së saj i gjen të pasqyruara në librat e Dine Dines: “Mbi varkën e Karontit”, “Gjyqi i Shopenhauerit” dhe “Burgu i Spaçit”. Dy librat e fundit m`i dha miku i tij i hershëm, Tahsin Demiraj, ish regjisor i estradës së Lushnjes. Siç shihet, kam lexuar libra të dhuruara të një autori të dënuar, kaluar dorë më dorë mes miqësh. Një rreth vicioz ky ku vegjetojnë sa e sa libra e autorë. (Ato me përdorim të brendshëm, dikur quheshin “broshura”.) Në këtë “vdekje klinike”, por fat të keq ndodh të bienë autorë dhe libra me vlerë, të cilët duhen shpëtuar. Do e quaja më shumë se mëkat, që libri i Dine Dines “Burgu i Spaçit”, të dënohej me heshtje, vetëm e vetëm se autori i tij s`është personazh mediatik, s`përfshihet në lista që lakohen rëndomë. I mësuar të presë prangat në duar dhe jo gjerdanin në qafë. (Për “Burgun e Spaçit”, i botuar në vitin 2021, gjej vetëm një shkrim modest të Lek Mirakajt, botuar në gazetën “Dielli” më 18 janar 2023, i cili shkruan: “Për ne që kemi pasur fatin e keq dhe të mirë njëkohësisht, me i jetu në vetë të parë shumë nga episodet dhe karakteret që Dine na i sjell në kujtesë, mund të them se na vijnë të freskëta, sikur të kishin ndodhur djë.”) Ky pohim vlen për të kuptuar se para bashkëvuajtësve autori e ka kryer detyrën, po ndaj lexuesit: a e ka përmbushur misionin? Tek besueshmëria e shoqëruar me fuqinë e fjalës, unë shoh arsyen e pahijshme, pse ky libër është rrethuar me heshtje, pavarësisht modestisë së autorit: “Nuk kam filluar të shkruaj që të bëhem shkrimtar, por që të ruhet kujtesa për rrugën që kemi kaluar.” Detyrimet në ruajtjen e kujtesës i kemi të gjithë, ndaj s`duhen rrethuar me “komplotin e heshtjes” rrëfime, ku dëshmohet historia e pamanipuluar për qëllime politike. Mos Dine Dine vuan veten, kur shprehet: “Njerëzit kryelart pothuaj e vuajnë krenarinë e tyre”, duke e konkretizuar këtë me një nga bashkëvuajtësit e tij: “Qemali duke qenë armik i betuar i komunizmit ishte shumë krenar e mburrej sa herë që t`i paraqitej rasti. Kjo lloj krenarie përbënte tërë jetën e tij.” S`është një armik i bërë me zor, apo imagjinari, që në të shkuarën deklaroheshin pas çdo akuze. Pyetjes së hetuesit, se a njihje ndonjë person nga vendlindja, ai i përgjigjet: “Kurrë s`e kam parë vendlindjen time, ndërsa ti me pyet se kë njoh në Bllatë, kur unë për fat të keq as e di nga bie kjo Bllata?!” I detyruar të njohë vetëm vendet e internimit, si: kampin e Tepelenës, Gjazën, Savrën, burgun e Spaçit e të Qafë Barit, vendlindja i është fshirë nga kujtesa. “Ne jemi viktimë të emrit, të familjeve tona. Më kanë internuar 5 vjeç. Tani jam 36.”-do i thotë hetuesit. “Të kam lënë kalama ti qënke bërë burrë?!”-regon i afërmi i tij, kur e sheh pas shumë vitesh tek dera e burgut. Nëse do mbetej burgjeve: do i fshihej ndoshta dhe ideja e atdheut, por jo identiteti, që ia formëson forca e karakterit, rezistenca. (Edhe pse asnjëri prej të dënuarëve s`ishte nga Lushnja, në burg do njiheshin si “lushnjarët”.) Vetvetiu të mbetet në mendje thënia e tij: “Kur e keqja nisët për rrugë do të arrijë në destinacion.” Po e mira, mos po bën sehir? “Është e çuditshme se si në rrethana të veçanta, edhe një njeri i thjeshtë që dihet se s`ka asgjë në dorë, me një fjalë, a thjesht me një shenjë mund të shkundë a të ta largojë si me magji moralin e rënë.” Ky njeri i thjeshtë “me një fjalë” e “me një shenjë” i shfaqur në të gjithë librin, ushtron një fuqi magjike, duke i dhënë kurajo. Dhe “ky i thjeshti” s`është nga radhët e familjes, fisit, “armiqtë të klasës”, por nga “popull i thjeshtë”, që shfaqte solidaritet larg syve të hafijeve. Neveria ndaj keqbërësve kompesohet me mirënjohjen ndaj atyre, që iu gjendën në jetë.

Autori i librit s`ofron ushqim për politikën, as për fanatikët e saj, po për lexuesin, duke thënë të vërteta që të tjerët u kanë kaluar anash. Duke lexuar librat e Dine Dines sheh se “armiqtë e popullit”, ku ai bënte pjesë, s`ishin të popullit, sikurse i arrestonin

Libri “Burgu i Spaçit”, i autorit Dine Dine

Burgu i Spaçit në një libër që duhet lexuar

Nga Fatbardh Amursi

në emër të tij, pasi populli u bën vend me bujari në të përditshmen, duke u larguar moralin e rënë. Duke qenë mendjehapur shkon përtej skematizmit të ri bardhezi, i shfaqur si një zgjatim i së shkuarës, ku frazat politizuese janë po ato, veçse fjala e mallkuar “reaksionar” ndërron vend me atë të urryerën: “revolucionar”. Sikurse nuk fal persekutorët, autori nuk toleron as veset e të dënuarëve.

Të persekutuarit ndenjnë në ato banga, ku u ulën të gjithë, përjashtojë të lartën, ku nuk shkonin të gjithë. Lexonin të njëjta libra që botoheshin, edhe në burg, përfshi dhe veprat e Enver Hoxhës me detyrim. Po ato gazeta, po ajo radio, përjashtojë tek-tuk ndonjë “libër të verdhë” të mbetur nga e shkuara, ndërsa të tjerët lexonin libra me izma e influenca të huaja, kësisoj: formimi kulturor ishte thuajse i përbashkët, sikurse kazma e punëtorit dhe mistria e ustait dhe palët i ndante vetëm propaganda, e cila hapte hendekun midis armiqëve të regjimit dhe mbështetësve të tij, ku dallohen militantët, gardistët, të zellshmit. Të parët shtërngonin radhët duke thënë: “ky është i sërës sonë”, ndërsa të dytët: “ky është i yni”. Më keq e kishin ata, që s`i pranonte as sëra dhe as pala tjetër, që s`i njihje si të vetët, përngjashëm me fatin e Grigor Melekovit tek “Doni i qetë” i Shollohovit, i cili, kur ishte tek “të kuqtë” e quanin “të bardhë” dhe kur shkoi tek “të bardhët” e merrnin për “të kuq”.


Ç`mund ta shtynte një vëlla, që ta harronte përjetë vëllanë e tij, shtron autori pyetjen, duke iu referuar një të burgosuri me vëllanë prokuror në kryeqytet? (Përngjashëm me rastin e Kasëm Trebeshinës.) Sikurse në të kundërtën: ku e gjente forcën “i harruar nga të gjithë, që besonte se regjimit do të rrëzohej”? Në këto kontraste, autori zbulon karaktere reale, duke mos bërë aludime dhe insinuata, ku fshihet persekutori dhe i bihet në qafë atij iu gjend në ditë të keqe. “Drejtori i burgut Jovan Ziu ishte nga Gorreja e Lushnjes. Atë s`e njihja, por dy nipat e tij vëllezërit Uan Ziu dhe Andrea Ziu i kisha patur dikur shokë klase e kisha patur kujtime të paharruara me ta. Megjithëse i përkisnim dy poleve të kundërta, dy klasave të ndryshme, ata kishin pasur ndjenja të veçanta për mua, sidomos Andrea që ishte më i ri, moshatar me mua dhe punonte si arsimtar.” Nëse ai do spekulonte me vuajtjen duke përdorur një gjuhë diabolike, bashkë me drejtorin e burgut do penalizonte dhe nipat e tij, pra, bashkë me të thatin do digjte dhe të njomin, në një farë kuptimi do rikthente “luftën e klasave”.

Sikurse dihet Lushnja mban rekord përsa i përket qendrave të internimit, ndaj dhe një shkollë, ajo e Plukut: mban emrin e Lek Previzit. Të internuarit mes tyre: Savrën e mbanin si kryeqytet të Lushnjes. (Në demokraci këtë rol do e luante Karbunara.) Ndërsa Lushnja caktoi



Tiranën si kryeqytet. Një shoku ynë na thoshte dikur, kur ata bënë ndeshje futbollit me të internuarit, duke mos i fshehur emocionet klasore dhe fitore mbi ta i gëzoheshin si një fitore politike. Më pas, ai bëri shumë shokë prej tyre. Meqë fola për dallimin tek propaganda, nga pala “pro regjimit” poetë e shkrimtarë të qytetit të Lushnjes do të përfundonin në burg, do çoheshin për riedukim në kooperativë, do u hiqej e drejta e botimit, do shiheshin me dyshim. Një shkrimtar nga Lushnja e kishte më të lehtë të përfundonte në Savër, se sa e kundërta, sikurse provoi Dinia të bëhej aktor apo muzikant dhe u refuzua, sepse nuk ua duronin inteligjencën. “Ahmet Kolgjini ishte i urtë, i zgjuar, ndaj u vriste sytë.”-shprehet autori. Ndiqni këtë episod interesant në burgun e Spaçit: “Shoku im i vuajtjeve që e kish ngrysur tërë jetën internimeve e tani së fundi në burg, bënte të njëjtën gjë. E shihja çdo ditë ose së paku çdo dy ditë tek parakalonte me një “vepër” të re të diktatorit...E rëndësishmja ishte që atje në bibliotekë shënohej firma e tij për aq e kaq vepër të lexuara. Kuptohej, si rregull, sa më shumë të lexoje aq më shumë riedukohesh me frymën e tyre.” Me gjithë kritikën e bashkëvuajtësve: “Duke vënë firmën se ke lexuar një libër në dy ditë i ke bindur ata se vërtetë ky njeri ka vendosur të riedukohet?”, ai u përgjigjet: “I bini dauilleve sa të doni se unë kam planet e mia e s`dua t`i di se ç`mendoni ju.” (Driteroi, anëtar i komitetit qendror, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, i thotë librarit të njohur gjirokastrit Alizoti: si shumë libra të Enverit e të Marksit kishte në rafte?! Ai i përgjigjet se kishte edhe më shumë, por: “kam vajtur në Komitetin e Partisë dhe i kam vënë mbi tavolinë çdo instruktori dhe punonjësi të partisë, dhe iu kam thënë: këto janë ato librat, që duhet t`i dini ju, se jeni marksistë dhe ju duhet t`ia shpjegoni popullit. Ju nuk merrni asnjë libër nga këto.”) I bashkoni të dy episodet: të burgosurit politik me veprën e diktatorit në sjetull dhe të instruktorëve të partisë, ç`paradoks me të cilët qe e mbushur ajo kohë groteske?! Ish koloneli Iljaz Ahmeti, sa herë që hynte komisari në kamp, i kërkon me insistim t`i sjellin një njeri kompetent, që të diskutojë për marksizmin, shkruan Dinia në libër. Qemal Murri, fshatar nga Shëne Premtja, dikur kishte qenë kryetar kooperative e që kishte patur nderin të priste e të shoqëronte Beqir Ballukun dhe e kishte pësuar për shkak të miqësisë me të.

Në librin me regjime “Gjyqi i Shopenhauerit” Dinia përmend një episod, që për pak desh i kushtoi. E caktojnë të shkruajë parrulla dhe të pikturonte portretin e Enver Hoxhës. Shkon dhe i merr një format të gatshëm Lek Previzit, i cili e udhëzon: “Ky është më i miri që kam, është bërë me projektion, por duhet të kesh kujdes kur ta stamposh, sepse këtu syri i majtë është grisur pak e duhet mbajtur me kujdes.” Për mos t`u dukur i paditur në sy të Lekës, e injoroi kujdesin që duhej të tregonte me syrin e majtë. (Thuhej se Enver Hoxhës e kishte pëlqyer portretin e vet të vendosur në qendër të Lushnjes nga i deklasuari Lek Previzi dhe i kënaqur paskish thënë: “Pikërisht për piktor të tillë kemi nevojë ne.”) Pasi përfundoi stampimin në prani të përgjegjës të sektorit dhe veterinerit, ata e pëlqejnë duke shprehur entuziazëm dhe ai ikën me mendje të fjetur. Por, vonë i vijnë në shtëpi të shqetësuar, pasi operativi vigjilent e kishte kapur defektin e syrit të majtë të bërë me projektion dhe u bënë namin se ua kishte hedhur armiku. Nëse ata nuk do e kishim marrë përsipër përgjegjësinë, dezinjatorit do i viheshin prangat. Veterineri i flet për reagimin kërcënues të operativit: “A e kuptoni se po mbronin një armik?!” Bënte sikur mbante shënime, që të na friksonte. Ndoshta



se zë gjumi se i iku nga dora një zog i majmë.” Në këtë mozaik episodesh dhe karakteresh ti përjeton dramacitetin e vazhdueshëm, që të ndjek në libër, ku tabloja para teje shfaqet me të gjithë të vërtetat, ndaj të cilave jemi të gjithë dëshimtarë.

Shihni se sa i singertë është rrëfimi i tij: “Kur i dënonin shokët e mi me radhë, një e nga një, gjithmonë i thoja vetes, si është e mundur? Pastaj i kthehesha anës tjetër, është e pamundur, me siguri do të kenë llototitur diçka. Pse s’ më dënojnë mua?” Kur e pësoi vetë, bindet. Nëse paragrafin e mëposhtëm do e publikoja pa emrin e autorit, zor se e gjente kush sekëto radhë i ka shkruar një i persekutuar, i cili jetonte në barakat e internimit në Savër: “Gjithçka dukej frymëzuese; dielli vezullues, një fllad i ëmbël që të mbushte me frymë, lulet shumëgjyrshë në oborr dhe flutura nga më të ndryshme në madhësi e ngjyra. Që të jem i singertë, shkak i këtij frymëzimi, ishte bërë një arsimitare e hijshme, e cila një ditë papritur erdhi dhe u ul pranë karriges sime, ndërsa haja drekë në mencën e sektorit, pasi atë ditë nënën s’ e kisha aty..Kur e pyeta nëse vërtetë dëshironte të më shihte sa më shpesh, ajo tundi kokën me një buzëqeshje të ëmbël dhe u zhduk si një krijesë ere.” Ah, kjo krijesa prej ere, që duket e zhduket si një mirazh?! Mosha djaloshare aq do, që të hidhet në aventurë. I kujtohet fëmijëria, kur pa dashur kishte vvarë një bilbil, ndërkohë që kënga e tij dukej sikur po i jepte hov vërshimit pranveror. S’ është fjala për pranverën socialiste dhe ai i pikëlluar i bën copë e çikë llastiqet. Në dallditë e moshës, kur një buzëqeshje e ëmbël femrore po e ftonte për aventurë rinore, nga maja e një bunkeri shfaqet përgjegjësi i sektorit dhe i thotë të paraqitej në polici prej nga do të hapej porta e ferrit. Do e gjykonin për mëkate, që s’ i kish bërë kurrë. “S’ kisha parë minierë me sy në jetën time dhe tani duhej të punoja në të 8-10 orë.” Në fund të këtij ferri ai shkroi libra, por më parë ishte nisur të bëhej muzikant dhe aktor. Kish provuar të konkuronte për aktor në Lushnjë para një komisioni, ku i pranishëm ishte dhe një i ardhur nga Tirana. Interpreton një fragment nga “Fati i njeriut” të Shollohovit. Komisioni e miraton, por, një i afërt i tij, i regjyr në vuajtje do i thotë t’ i largojë skenës. “Është ndryshe, kur ata të thërasin, e ndryshe kur ti u paraqitesh vetë dhe u kërkon favore. Do ta shohësh edhe vetë se sa të sjellshëm e të gatshëm janë ata, kur ndodhesh përballë.” Po sikur komanda të propozojë që të futesh në estradë, i thonë bashkëvuajtësit. Ai refuzon, pasi vendet e privileguara i zinin spiunët.

Ardhur nga barakat me lagështi të Savrës, sapo zbret nga autoburgu sheh: “Përballë sheshit ku bëhej apeli qendronin madhështore dy ndërtesa tre katëshe. Kurrë në jetën time nuk kisha banuar në pallate... Gjatë gjithë kohës që je brenda je i detyruar ta shohësh tjetrin, qoftë ky ish ministër i kabinetit Hoxha qoftë gjeneralin 90 vjeçar të kohës së Duçes apo ndonjë fshatar të varfër nga të cilët kishte me shumicë.” Ky ishte Spaçi i tmerrshëm, që në sytë e atij që jetonte në barakë shfaqet befasues. Kur hyn në qeli syri i kap një merimangë. “Merimangës çdo ushqim që t’ i japësh e kthen në helm.” -thotë një i urtë, përkundër xixëllonjës që ai shihte në fushë, të cilat e kanë dritën veti të qënies së tyre, sikurse dhe autori i librit. Si të ishte një Spidermen zë e kqyrë merimangën se si ajo thurte rrjetën, ku binin në kurth insektet. (Kur e arrestuan Spartak Ngjelën i thanë: “Tani s’ do të derdhësh më helm nëpër Tiranë!” Të gjithë mund të nxirrnin helm nga goja veç diktatorit, që i kishte “buzët me sheqer”). “Ndërsa hanin shegët, të gjithë bënin nga një çikë humor e bisedonin më lirshëm se në shtëpinë e tyre. “A, ma ky qënka burgu?”-mendoja me vete. Kur isha në internim, në shtëpinë time edhe kur flisnim me njëri-tjetrin brenda katër mureve të shtëpisë, e ulnim zërin, sepse, thoshim edhe muret kanë vesh, apo dikush mund të vinte e të përgjonte jashtë dritares.” Kur del nga biruca, ku e dënojnë pse kishte përshëndetur një njeriun e tij, bashkëvuajtësit e presin duke ia shtruar me të ngrëna: “Ajo javë (në burgun e Spaçit) pa ekzagjerim kaloi si në ditë dasmash.” Mos po e zbukuron realitetin, duke shfaqur

reminishenca të realizmit socialist? Kur dikush dilte nga burgu, hapeshin fjalët: “Ishte bërë si poç!” (Nëse lexon dy librat e Remarkut “Tre shokët” dhe “Shkëndija jete”, tek i pari ndjen pesimizmin e “brezit të humbur”, ndërsa tek i dyti që i zhvillon ngjarjet në kampet e shfarrosjes ka nota optimiste.)

Si të gjithë ata, që kanë neveri për skematizmin, që socrealizmi i mediokërve po e zyrtarizonte si mënyrë të të menduarit, Dinia i largohet shablloneve, klisheve, që për fat të keq riciklohen në të gjitha kohërat. “Kur ndonjëri vinte të më takonte thjesht si i burgosur, sapo largohej Qemali vinte gishtin tregues: “Ky është spiun, ky tjetri është njeri i mirë, ai me kurrizin e dalë nuk është njeri i keq veçse është tepër fukara e sillet mirë me ne se i japim ndonjë kafe.” Në librat me temë nga burgjet e diktaturës s’ më ka ndodhur që të flitet kaq shumë për spiunët, duke i kategorizuar dhe në tipa, se sa në librin, që duhet lexuar: “Burgu i Spaçit”. “I përgjigjesha secilit shkurt e me kujdes, sepse kudo të rrethonin spiunët.”, “Samiu më tha se të gjithë të burgosurëve që u jepen poste ishin spiuna.” Ja dhe një skenë dramatike, si në filmat e Hollivudit: “Unë që e shihja për herë të parë atë skenë të tmerrshme s’ mu durua e tentova që t’ i ndaja, por dy duar të fuqishme më kapën nga të dy krahët e njeri prej tyre më tha që të mos përzihesha në të tilla raste, sepse ai që po godiste i kishte nja gjashtë shokë nga pas që e ruanin dhe e mbronin...Daja i cili s’ ma lëshonte krahun, më tha se ai që ndëshkohej ishte spiun, ndërsa ai që e ndëshkonte ishte njeri i ndershëm.” Dhe ky dallim bëhet midis dy vetave të të njëjtit fat. “Gjak, gjak, gjak, ja ky është komunizmi. Ne këtu në burg po e aplikojmë me spiunat.”-thërret një i indinjuar.

“Kishte dhe spiuna “të moralshëm” që ruheshin të mos binin në kontakt me njerëz që sipas tyre i donin...S’ e mbaj mend se përse e akuzuan, por, me siguri si agent të Malazezëve sepse andej kish ardhur. “Po ç’ t’ i bësh,-thoshte ai,-po të më shohin që shoqërohem me ju një herë ose dy, dhe fap, më tërheqin prej mënge. Pa hajde këtu do më thonë! Ku njihesh ti me ta, ç’ flasin, ç’ thonë? Edhe sikur ju të mos e keni hapur gojën kurrë, unë duhet të shpif diçka. Se ndryshe më heqin kotheren... me presin kokën! Kjo është arsyeja që unë ju shmangem.” Tronditëse. Ja dhe një tip tjetër: “Kam firmosur, por gjer më sot s’ i kam bërë keq njeriut”, ndërsa unë e përktheva: “Kam firmosur, por deri tani s’ më kanë kërkuar gjë, që t’ mund t’ i bëjë keq njeriut.” Spiunëve u jepeshin punët më të lehta. Kur u dilte boja i përdornin si dëshimtarë. Shpesh binin viktima të poshtërsive të tyre, duke përfunduar në burg. “Dajë Veliu shkonte në takim me mikun që i kish dalë dëshimtar, sepse njeri kishte të birin tjetri të bijën që kishin bërë krushqi.”, “Kisha dëgjuar që arkitektit e piktorit Maks Velo i kish dalë dëshimtar piktori dhe shoku i tij i ngushtë Edison Gjergo. Pastaj kishte hyrë në burg vetë. Edhe në burg ai shoqërohej me të.” Në fillimet e burgjeve të diktaturës kishte më pak spiuna. “E vure re atë që më përshëndeti, është spiun. Kur më vijnë nga shtëpia e qeras me ndonjë ushqim. E di si më tha një ditë: “Si e shpjegon këtë që po të them. Po të mos bëjë dy-tre raporte në ditë e t’ i postoj në komandë, s’ më zë gjumi.”?! Mos vallë heshtja ndaj librit duhet marr dhe si një ndëshkim i personazhëve në fjalë?

Të njëjtit regjim i shërben oficer Pjetri bashkë me nënoficer Zefin, por pse dallojnë aq shumë? “Oficer Pjetri, i ashpri, njeriu strikt që s’ i thyente kurrë rregullat, njeriu serioz dhe i palëkundur ishte thyer për ca çaste dhe po ëndërronte me sy hapur. Lindur e rritur nëpër shkrepat e Spaçit të Mirëditës, që s’ kishte parë veçse gra të stërmunduara e të rrudhosura, të veshura me brekushe ishte e natyrshme që të mahnitej tek shihte një femër krejt tjetër nga ato që i kish zënë syri tërë jetën.”-shkruan ai, teksa po takohet me të shoqen, Adrianën, të cilën e ka dhe bashkautore në librin “Gjyqi i Shopenhauerit”. Ja dhe një skenë tjetër ku figura e oficer Pjetrit del e plotë: “Bixhozçinjtë sapo hynë, pa asnjë zhurmë si të ishin të komanduar bënë një rreth të madh dhe filluan të luanin...Loja ecte me një qetësi shembullore. Paketat vërtiteshin sa tek njëri tek tjetri...Deri në ato çaste as e kisha imagjinuar një oficer komande, sido



Dine Dine duke folur për Report Tv

që të ishte ai, të maskohej me uniformë të burgosuri.” I kap të burgosurit duke luajtur bixhos dhe në një thes ua mbledh të gjitha paketat e cigareve. “Pastaj, me një buzëqeshje të lehtë ironie, si njeriu që ngadhënjën mbi të tjerët, iu drejtua krevatëve që heshtnin, si t’ iu drejtohej varreve: “Ama trima jeni! Po si ore u zhdukët për dy sekonda?! Pa çohuni, çohuni njëherë!...Deshët të ma hidhnit, ë? Akoma s’ e keni mësuar ju që, kur jam unë në detyrë nuk bëhen kësi lojrash. Unë kam përshtypjen se më njihni ashtu siç ju njoh edhe unë...Sikur të rrinit këtu në shesh të burrave do të kishit ca lehtësira, por tash që u fshehët si minjtë nëpër biruca s’ është faji im.” Kur drejtori e dënon me 10 ditë në birucë, vetëm se përshëndeti familjarët në ikje, me nënoficer Zefin mund të flisje ç’ të doje dhe të shaje. Asnjë i burgosur s’ kishte pësuar ndonjë zarar prej tij. “Më ka porosit baba kushedi sa herë qi mos t’ iu baj keq të burgosurëve se nuk do ma falë mundin sa të jetë gjallë! Amaneti i babës asht ligj për mue.”

Syrit të autorit nuk i shpëton as korrupsioni i administradës së burgut, duke përfshirë dhe mjekët. Kush bënte pjesë në grupin e shkarkimit të ushqimeve, shtonin xhepat të fshehura të robave si e si të vidhnin ndonjë send. Asllan Balla tek Klubi i Shoferit në Lushnje ishte i zoti të bënte para, por, pjesën më të madhe të fitimeve ia merrnin sigurimsat, në formën e borxhit dhe, nuk ia kthenin. Në fund vendosën ta burgosnin. Dine Dine guxon të përshkrojë dhe një skenë të tillë: “Kur zbrita në katin e mesëm të ndërtesës së burgut tek pushimi i shkallëve, më goditi pamja e dy burrave që putheshin buzë më buzë...Një kureshtje instiktive më bëri të kthej kokën. Ç’ të shoh! Tellalli i burgut, Grigor Xarxalla bënte dashuri me një të burgosur tjetër, që me siguri flinte në katin e mesëm.” Sa më gjatë të rrish këtu i thonë, do mësohesh me këto skena dhe do i kalosh me indiferencë. Ja dhe një tip tjetër: “Fallxhiu po i përmendëte ca emra, atij të panjohurit e i bënte ca parashikime që e dehën fare...Më pas i tha se tellalli Grigor Xarxalla do t’ i sillte një telegram ku do ta njoftonin për një takim me familjen, brenda tre ditësh...Pasi u gëlltit nja dy-tre herë i tha troç se e fejuara e kishte tradhëtuar e nuk dukeshin shenja se do t’ i vinte në takim.” Tjetri u turr ta rrihte.

Në burgun e Spacit, pa qenë i burgosur, në mesin e tyre ishte dhe Ismail Kadare, ndaj një ditë, komandanti i burgut do i thotë: “T’ martën kur t’ vinë autoburgu bash po ta sjellin itu Kadarenë.” Nuk mund të mos bëjë përshtypje dhe mënyrë se si ai sheh shkrimtarin: “Më ka ndodhur të dëgjoj lëvdata të shkallës sipërore nga individë të njohur rastësisht për veprimtarinë e Ismail Kadaresë, por gjatë bisedës kam zbuluar me keqardhje se nuk kishin lexuar as dhe një shkrim të tij; ashtu si të tjerë, për shembull këtu, në burg, pa e njohur veprën e tij, ndoshta edhe pa lexuar ndonjë novelë apo roman të autorit, i përmbysin lëvdatat e të parëve, i shndërronin

në mohim dhe jo rrallë në fyerje. Për një gjë jam i sigurt; Kadareja është nga të paktët shkrimtarë kudo që të ndodhen, vepra e të cilit do të jetojë gjatë...shumë gjatë. Dhe kjo falë talentit dhe mënçurisë së tij. I sulmuar nga shkrimtarë mediokër rë realizmit socialist jo rrallë është rrezikuar ta sillnin, aty ku ndodheshja dhe unë, në Spaç, apo dhe më keq siç kanë bërë dhe me shumë të tjerë, dhe kjo do të ishte një goditje, një humbje e dhimbëshme për kombin. Enver Hoxha ishte një liliput para emrit Kadare...Në Spaç ndaheshim sa i përket vlerësimit të Kadaresë. Një pjesë, ku isha dhe unë, Visar Zhiti, etj., që e vlerësonim, thuajse e adhuronim, e shihnim si lëvruesin më të mirë të gjuhës artistike, më të madhin e të gjithë kohërave. Të tjerë e cilësonin si “shkrimtar oborri” dhe nuk i njihnin asnjë meritë. Kur atje në burg erdhi “Nëpunësi i Pallatit të ëndrrave”, na dha shpresë, madje na bindi se kohërat e lavdishme të diktaturës po mbaronin. E lexuam me një frymë dhe për mjaft kohë e diskutonim me njeri-tjetrin. Mbas shtypjes së revoltës së Qafë Barit, komandanti i burgut në një fjalim, të mbushur me kërcënime, në mes të tjerash tha: “Ne Kadarenë do t’ ua sjellim këtu pas 48 orësh!” Uroja sinqerisht që Kadareja ta fitonte çmimin Nobël. Nuk ishte vetëm në të mirë të tij, por në radhë të parë të Shqipërisë. Në fund të fundit ai e meritonte atë.”

Nuk ngurron të shkruaj se burgu është një hambar gjigand thashethemesh ku të burgosurit ushqehen papushim çdo ditë. (Në një bisedë me Kadarenë, për “hambar gjigand thashethemesh” ai mbante: kinostudjon, shkollave e arteve dhe RTVSH-ën.) Dhe më tej, Dinia shkruan: “Burgu bëhet dyfish i vështirë se dominojnë orderinët, shpifësit, hajdutët, spiunët, të korrptuarit.” Me sa duket, pikërisht këta, kur prekën lirinë u bënë edhe më ndotës. Kur ishte në internim qëllimisht nuk e përshëndetën përgjegjësin të hipur mbi kalë. Ai i fyer desh të hakmerrej, duke shpifur kundër tyre. “Si është e mundur që të shpif përgjegjësi?”-ndërhyn një servil i tij, ndërsa sekretari i partisë e tërheq mënjanë duke e këshilluar: “Baje një farë autokritike si të dush ti dhe ne do ta pranojmë.” (M’ u kujtua autokritika vrastare e Kadaresë, mbyllur me fjalët: “Arma dhe kur shrep padashje, të vretë.”) Pranon të bëjë një autokritikë formale dhe sekretari e mbyll mbledhjen i kënaqur: “-Po ja qo ish! Qy e bari autokritikën, me kaq mledhja maron.” Sa e sa shkrimtarë e dramaturgë e patën personazh pozitiv sekretarin e partisë dhe të gjithë dështuan. Ja një sekretar partie i përshkruar nga një i deklaruar me kaq vërtetësi dhe orgjinalitet, se fesnikëria nuk e ka për zakon që ta manipulojë të vërtetën. Mediokrit e djeshëm gjithë të këqijat i shihnin tek personazhët negativë, aq sa komunistët shmangeshin t’ i luanin në skenë, ndërsa skematikët e sotëm e përdorin bojën e zezë ndaj “heroit pozitiv” të rënë nga vakti. Jeta është me ngjyra, përtej furçës me të cilën lyen propaganda. Një autor me personalitet e sheh botën me sytë e tij, pa ia patur nevojën syrit me projeksion “të largpamësit”...

Poema “*Lumi im*” e Ilirian Zhupës, të duket sikur është shkruar në një kohë tjetër dhe jo në vitin 1988, kur u publikua si pjesë e librit “*Mos më pyet ku kam qenë*”. E lexuar nga perspektiva e të sotshmes, ku e shkuara totalitare shpesh vjen përmes narrativave esencialiste, apo, thënë figurativisht, si skeleti i peshkut të plakut Santiagos në novelën *Plaku dhe deti* të Heminguejt – për dikë të painformuar, poema krijon iluzionin se diktatura, me mekanizmat e saj të censurës, nuk përbënte më kërcënim për poetët dhe shkrimtarët.

Në të vërtetë, soc-realizmi vazhdonte të rëndonte si çati e rëndë mbi krijuesit. Censura ishte ende vigjëluese dhe, sikurse shprehet autori në parathënien e botitmit të dytë (Toena-2016), në ato kushte “*duhej të manovronte, të bënte lëshime ...me qëllim që poezia e njëmendtë të mund të kapërcente me sa më pak gërvishtje e deformime, barrierat penguese të censurës*”.

Falë vetëdijes estetike të autorit, poema *Lumi im* vjen si një rrjedhë poetike, përtej sinoreve kohore dhe stinëve politike, e zhveshur nga gjurmët dhe ambalazhet ideologjike të kohës kur u shkrua.

Ilirian Zhupa i përket brezit të poetëve të cilët, nga fundi viteve shtatëdhjetë e deri në rënien e regjimit komunist, përtej presionit dhe shtërngesave ideologjike, ja mbritën të kultivojnë një poetikë të re, më personale dhe intime, larg fanfarave dhe patetizmit gërthitës të kanonit të socrealizmit.

Lumi poetik i Ilirian Zhupës lexohet si një rrjedhë shpirtërore, pa brigje fizike, si një metaforë gjithëkohësie, ku takohen historia, vetëdija dhe kujtesa. Lumin real –Vjosën- si referencë paratekstore dhe shtysë frymëzimi-autori e transfiguron dhe transformon në simbol të kërkimit ontologjik për kuptimin e qenies identitare, të rrënjëzuar në historinë e vet dhe të hedhur në rrjedhat e kohës.

Fernando Pessoa në një nga poezitë e tij thotë se “*detare është jeta*”, duke na përcjellë idenë për jetën si udhëtim të pasigurt, të hapur dhe të pafund, ku njeriu përballet me sfida, pasiguri dhe rrezik, por edhe si hapsirë ku gjen liri dhe mundësi vetë-zhvillimi. Deti për Pessoa është horizont i pafund, aventurë ekzistenciale dhe reflektim mbi kufijtë dhe guximin e njeriut.

Në mënyrë të ngjashme, Ilirian Zhupa në poemën e tij duket sikur na thotë se “*lumore është jeta*”, pra një rrjedhë e pandërprerë, si energji, kërkim, ndryshim dhe ringjallje shpirtërore. Ndryshe nga deti i Pessoa, lumi i Zhupës thekson lëvizjen e natyrshme dhe përballjen e subjektit lirik me sfidat që sjell rrjedha e kohës dhe jetës.

Poema *Lumi im* përfaqson një qasje refleksive fenomenologjike të përvojës dhe meditimit, me diskurs poetik ku kërkimi ontologjik, harmonizohet me lirin me frymë ekzistenciale. Edhe pse poema është shkruar në vitin 1988, autori me vetëdije dhe mjeshtëri artistike ka shmangur qasjen epike dhe teleologjinë triumfaliste të imponuar nga kanoni i relizmit socialist, duke e trajtuar kohën, kujtesën dhe historinë, jo si narrativë progresi, por si rrjedhë e përjetuar dhe e reflektuar nga subjekti lirik. Teksti poetik çideologjizon diskursin historik dhe e çvendos atë në planin fenomenologjik të përjetimit individual.

Poema bart frymë refleksive fenomenologjike sepse realiteti në pamjet e tij të shumëfishta trajtohet si përjetim dhe koha shpaloset si përvojë ekzistenciale e të jetuarit në rrjedhë. Diskursi poetik merr thellësi ontologjike sepse autori mediton mbi rrjedhën si modelim i qenies, trajton rrjedhën si proces ndryshimi, ku përkohshmëria ushqen vazhdimësinë dhe subjekti është pjesë e rrjedhës kohore.

Poema *Lumi im* përcjell një vizion filozofik por autori nuk operon me nocionet abstrakte filozofike të kohës, kujtesës, qenies, identitetit etj. Filozofia e tekstit zbulohet si frymë dhe përvojë e mishëruar e rrjedhës së lumit të kohës, historisë dhe vetëdijes. Kërkimi dhe meditimi subjektit lirik shpaloset përmes rrjetit të gjërë të figuracionit artistik, imazheve vizuale, përjetimeve subjektive dhe figurave sonore.

Falë kësaj teknike poetike, lumin poetik e shikojmë me pamjet e tij të ndërrueshme, plot ngjyra dhe nuanca nëpër stinët e motit, e dëgjojmë dhe ndjejmë rrjedhën e tij si mërmërimë, gurgullimë, si rënkim dhe gulçimë në shtratin e kohës historike dhe sociale. Lumi rrjedh jashtë dhe brenda subjektit lirik, duke

Vështrim rreth poemës “Lumi im”, pjesë e librit “Mos më pyet ku kam qenë”

Lumi poetik i Ilirian Zhupës

Nga Sadedin Mezuraj

lidhur përvojën personale me kujtesën dhe historinë kolektive.

Kërkimi i burimit të lumit merr kuptime simbolike, si kërkim i burimeve të jetës dhe kuptimit të identitetit dhe vetë ekzistencës. Kërkimi – i cili nisat nga jashtë dhe përfundon brenda subjektit lirik, pra “Te vetja”- është një zgjidhje e bukur poetike dhe ekzistenciale. Burimi ekzistencës nuk është gjeografik por ontologjik.

E strukturuar si një triptik, si rrjedhë e kohës, e jetës dhe vetëdijes, arkitektura e poemës ka në epiqëndër subjektin lirik, i cili dialogon me *Lumin simbolik* dhe njëkohësisht monologon me vetveten, duke i folur lumit dhe duke na folur për *lumin e tij*, si për një entitet që bart në vorbullat e tij jetën me të gjitha dimensionet -gëzimet, dhimbjet, shpresat, dëshirat, përvojën individuale dhe kujtesën kolektive.

Në krye të çdo kënge autori parashtron pyetjen apostrofike mbi lumin, duke e paraqitur atë si entitet që komunikon energji dhe reflektim: “Ç’më thua ashtu me zhurmë, lumi im, ç’më thua ashtu me heshtje...”. Zhurma dhe heshtja janë dy forma të ekzistencës së *Lumit*, të cilat alternohen, transkriptohen dhe konkretizohen në rrafshet shumështrësore simbolike dhe semantike të poemës.

Rrjedhën e jetës dhe flukset e kohës, të kujtesës dhe vetëdijes poetike, autori e ka strukturuar me vargje të shtrira, figuracion të pasur, personifikime dhe kontraste, duke krijuar ndjesinë e frymemarrjes së gjërë të një lumi që rrjedh jo vetëm jashtë, si kohë objektive por edhe brenda vetëdijes, si kohë

e subjektivizuar emocionale, meditative dhe reflektuese e heroit lirik.

Poema *Lumi im* operon mbi simbolikën polisemike të lumit, i cili funksionon si metaforë e *konceptit heraklitian të kohës*: gjithçka rrjedh, gjithçka është në lëvizje, natyra, jeta individuale dhe koha historike. Lumi mban brenda të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen: e shkuara si kujtesë historike, e tashmja si përvojë intime dhe vetëreflektim identitar, e ardhmja si shpresë për ringjallje dhe ripërtëritje të pandalshme. Dialektika e ndryshimit është ligji i jetës dhe historisë.

Njeriu –ose Daisen sipas Haidegger-është qenia e shtrirë në kohë dhe i ndërtuar prej kohës si rrjedhë ndryshimesh. Ndryshe nga guri, tryeza apo pema, njeriu është qenie që mendon dhe kohën, historike dhe sociale, e përjeton dhe subjektivizon si vetëdije, njohje, kujtesë dhe kërkim të kuptimit. Koha në pomën *Lumi im* formëson kujtesën kolektive dhe individuale. Nga ky ndërveprim formësohet identiteti, jo si esencë e fiksuar por si proces i vazhdueshëm njohjeje dhe kërimi i burimeve ontologjike të vetes.

Prej lashtësisë vjen thirrja filozofike: *Njeri-njih vetveten!* Dhe njohja e vetvetes nuk mund të realizohet jashtë lidhjeve të shumëfishta të subjektit me kohën e jetuar, historinë, kujtesën dhe trashëgimninë. Prandaj poeti shkruan: *Lumi im, që më rrjedh e më mbledh larg e pranë,/E i kthjellët më rrëmben mes shtjellës,/E i turbullt më lë mënjanë./Gjysh stërgjyshi qenke, qenke ati dhe nëna...*

Poema ndërthuret si një *strukturë rizomatike* (sipas konceptit të Deleuze dhe



Gauttari- *A Thousand Plateaus*-1980), pra një rrjet fleksibël, i degëzuar dhe i ndërlidhur, ndryshe nga struktura lineare apo hierarkike e një peme. Tre rizomat bazë mbi të cilat ndërtohet rrjeti kuptimor i poemës janë *koha, kujtesa dhe identiteti*. Ato nuk funksionojnë si kategori abstrakte por si fusha semantike të ndërthurura, ku rrjedha historike, përjetimi personal dhe reflektimi subjektit lirik ndërveprojnë në mënyrë dinamike. Falë lumit si simbol polisemik dhe strukturës rizomatike, poemës mund t'i qasemi përmes leximeve të ndryshme dhe të ndërtojmë rrjetin e kuptimeve brenda strukturës së shumëfishtë të lumit.

Lumi poetik shpaloset si:

- metaforë e kohës të trupëzuar si kujtesë historike dhe gjenealogjike, e jetës dhe përvojës, ku subjekti lirik ndjehet i rrënjëzuar;
- simbol i identitetit, vetëdijes dhe botës shpirtërore, e cila pasurohet në rrjedhat e kohës, të jetës dhe përvojës historike.
- fluks i energjive ekzistenciale, në rrafshin meditativ dhe të reflektimit filozofik për kohën, kujtesën, qenien, ekzistencën, jetën, dashurinë, dhimbjen dhe vdekjen.

Le të shikojmë të tri këngët e poemës *Lumi im*, me një qasje më të detajuar në rrafshin strukturor, simbolik, semantik dhe ideor :

i.Kënga e parë- Lumi i kohës historike dhe kujtesës

Në këngën e parë *Lumi* shpërfaqet si forcë e natyrës dhe energji që sfidon dhe trondit pengesat, si rrjedhë e kohës historike me vrulle e tronditje, si kujtesë kolektive dhe si udhërrëfyes për reflektimin ekzistencial. Në këtë ndërthurje të ndjenjës personale dhe historike, lumi plazmohet si simbol i vuajtjes dhe tragjedisë, si burim dashurie dhe energjie jetësore.

Lumi rrjedh si personifikim i historisë me dhimbjet, tragjeditë dhe tensionet e saj: “*Turbull – turbull vije, lumi im, turbull – turbull.../ Shkuleshin gurët e maleve dhe prishnin një urë dashurie,/ Një kasolle të mjerë, një dushk të sapo ngritur në këmbë,/ Një jelek nuseje, një djep të vogël fëmije...*”

Ashtu sikurse lumi natyror, edhe rrjedha e kohës historike, herë është e qetë dhe hera herës dallgëzohet e shungullon me përmbytje, lufta e katastrofa. Vargu “*Turbull-turbull, vije lumi im*”të sjell në kujtesë këngën polifonike labe për lumin e turbullt, me kufomën e një djali të mbytur dhe klithën vajtimtare të nënës në breg. Mjafton kjo referencë intertekstuale dhe lumi bëhet simbol i vuajtjeve historike dhe dhimbjeve kolektive. *Dimrat që qeshin me bubullima* simbolizojnë forcat iracionale, natyrore dhe historike, që sfidojnë jetën dhe strukturat e shoqërisë.

Lumi nuk është më vetëm kujtesë apo histori; ai është vetë identiteti dhe vetëdija, një pjesë e pandashme e qenies së poetit. Përmes këtij identifikimi, subjekti lirik përjeton bashkimin e brendshëm me rrjedhën e jetës, ku emocionet dhe reflektimi filozofik janë të bashkuara në një fluks të pandërprerë.

Subjekti lirik zbulon identitetin e tij, si vetëdije e të qënurit pjesë e kësaj rrjedhe historike me martirë, qëndresë, gjak dhe dashuri për jetën. Në këtë përjasje, subjekti lirik zbulon ngjashmërinë e tij me lumin si entitet kompleks, dinamik dhe në lëvizje: *Ngjasokam fort me ty në gëzime e dhimbje,/Në dashuri e besë, vdekje e lindje,Lumi im – jeta ime*. Në vargjet “*Kam dëshiruar gjithë jetën,/ Zgjuar, në gjumë, / Të jem rrjedhë, Të jem lumë*”, poeti e koncepton qenien e tij dhe identitetin si fluks i përhershëm i njohjes dhe vetënjohjes, pjesë integrale e rrjedhës së historisë dhe jetës.



ii.Kënga e dytë-
Lumi i Dashurisë dhe Vetëdijes

Në këngën e dytë subjekti lirik identifikohet me lumin, ku lumi shfaqet si simbol i jetës dhe i përvojës ekzistenciale. Boshti tematik i këngës së dytë përqendrohet në rrjedhën e brendshme dhe lidhjen intime të subjektit me veten, dashurinë dhe jetën. Lumi nuk është më vetëm histori dhe vuajtje, por bëhet rrjedhë e brendshme që harmonizon emocionet personale me **përjetimet** intime të subjektit lirik. Dashuria shfaqet si vatra e energjisë shpirtërore dhe si forcë që mbush me dritë rrjedhën e jetës. Edhe dashuria është rrjedhë, kërkim, pritje, prani dhe mungesë: *“E kam pritur një vajzë, E ke pritur një përrua, Ti atë e bën dritë, Unë atë e bëj grua.”*

Kënga e dytë është strukturuar mbi pesë pjesë që mund të perceptohen si etapa të rrjedhës së ndërgjegjes poetike: fillimi me pyetjen retorike për lumin, identifikimi me të, perceptimi i tij si energji dhe forcë, përjetimi i marrëdhënieve intime dashurore dhe reflektimi mbi prapavijën historike dhe sociale.

Vargjet janë të shtrira, me ritëm të lirë dhe pulsues, që krijojnë ndjesinë e rrjedhës së pandërprerë, që imiton rrjedhën e lumit dhe të mendimeve. Strukturimi i vargjeve të gjata, me muzikalitetin e përfutur prej aliteracioneve, onomatopeve, figurave stilistike tingullore, simulon rrjedhën e pandërprerë të lumit dhe mendimeve poetike, ndërsa personifikimi, antiteza dhe metaforat e shumta, krijojnë puls emocional, kontraste dhe thellësi semantike.

iii.Kënga e tretë-
Lumi i ripërtëritjes dhe ardhmërisë

Boshti tematik i Këngës së tretë është harmonizimi i individit me natyrën dhe universin, ku lumi simbolizon ripërtëritjen, energjinë ekzistenciale dhe ciklin e përvetshëm të jetës.

Pjesa e parë e kësaj kënge përcjell iniciimin e frymës ripërtëritëse, ardhjen e pranverës dhe shpërthimin e energjisë së natyrës: *“Behari vjen ngadalë nëpër grykat e maleve dhe ujërave...”*. Përdorimi i elementeve natyrore (grykat, ujërat, pemët,) krijojnë kontekstin e një lumi që **rigjeneron** natyrën dhe bëhet vendi ku subjekti lirik përjeton harmoninë e brendshme dhe të jashtme.



Strukturimi i vargjeve dhe imazheve naimiane të natyrës (thatësira, njerzit e punës, fushat, shpendët dhe kafshët) krijojnë fluksin meditativ, duke lehtësuar kalimin nga përjetimet intime, drejt reflektimeve ekzistenciale dhe imazheve për jetën.

Kënga e tretë e zhvendos lumin nga identiteti dhe përvoja historike, drejt një simboli të ripërtëritjes dhe harmonisë me natyrën dhe universin. Dashuria, e paraqitur më parë si vatër e dëshirës dhe përjetimit të subjektit lirik, bëhet forcë krijuese dhe energji jetësore, e cila rrjedh nëpër të gjitha hapsirat fizike të natyrës dhe jetës njerzore.

Anafora *“Atje tej”* e përsëritur, krijojnë ndjesi të thellë largësie fizike dhe shpirtërore. Përsëritja e vazhdueshme e kësaj shprehjeje përcjell një ton mallëngjyes dhe sugjeron për diçka të pa mbritshme. Ajo i jep poezisë ritëm dhe tonalitete të veçantë emocional, ndërsa ndërton një lëvizje kuptimore nga përshkrimi i peizazhit të jashtëm, drejt zbrërthimit të botës së brendshme të poetit.

Në këtë mënyrë, largësia shndërrohet në simbol të një gjendjeje ekzistenciale të papërbushur. *“Atje tej janë njerëzit, qytetet, fshatrat, Të etura për pikën e ujit. Atje tej je ti, lumi im, që humbet...”* Këtu subjekti lirik reflekton mbi bashkëjetesën e natyrës, njerëzve dhe rrjedhës së lumit, ku energjia e dashurisë dhe e jetës përhapen tek çdo genie.

Në fund poeti identifikohet me lumin kur shprehet *“Atje tej është lumi, jam unë vetë, Si ai vdeksha në jetë”*, duke njëjtësuar rrjedhën e lumit me jetën dhe fatin e njeriut. Lumi humbet para se të arrijë në det, pra jeta shuhet pa e përmbushur plotësisht qëllimin e saj. Por ndërkohë, vargjet sugjerojnë se jeta nuk shuhet, ajo vetëm transformohet, duke u derdhur në detin e madh të gjithësisë. Lumi nuk është më thjesht identitet individual apo histori kolektive, por merr trajtat e simbolit të përjetësisë, ripërtëritjes dhe energjisë krijuese.

Ankthi i frikës së humbjes, kujtesa e plagëve dhe thirrja e lumit për të vepruar (Mos fli!) bashkohen në një fluks të pandërprerë të lumit poetik, jetësor, emocional dhe filozofik.

Në qëndër të gjithësisë, të ripërtëritjes dhe sinteza e këtij përshndërrimi të pandalshëm është subjekti lirik-njeriu pra- *pema më e bukur e pemëve: “E unë rritem i ndjeshëm si degët e shelgjeve, E unë bëhem pema më e bukur e pemëve, Me mijëra lastarë e mijëra çerdhe. E ti nxjerr avuj të lehtë nga buzët e tua të dridhshme...”*

Subjekti lirik e brendëson rrjedhën e lumit si identitet dhe ekzistencë të tij: *“Kam ndërre se rrjedhin thellë qenies sime”*. Lumi nuk është vetëm natyrë ose kujtesë, por vetë rrjedha e qenies, ku identiteti dhe koha bëhen të njëjta me rrjedhën universale. Lumi, dashuria dhe natyra bashkohen në një simbol të përbashkët të jetës, ku çdo përvojë personale gjen vendin e saj brenda rrjedhës universale.

Pjesa e fundit e këngës së tretë ka një ton që përngjason me psalmet biblike, ku çdo element i natyrës dhe vetë lumi shndërrohet në një lloj hymni për bukurinë e jetës. Optimizmi lirik shfaqet në mënyrë delikate dhe ekzistenciale: subjekti lirik bashkëjeton dhe lulëzon bashkë me natyrën e ripërtërirë, duke reflektuar rritje, zgjerim dhe frymëzim të brendshëm.

Subjekti lirik nuk shfaqet si bartës i domosdoshmërisë historike, por si meditues i lumit të kohës, me rrjedhat e saj historike, sociale, si përvojë dhe kujtesë e akumuluar. Edhe pse autori krijojnë një perspektivë shprese rigjeneruese, optimizmi zhvishet nga fryma triumfaliste dhe rigjenerimi paraqitet si cikël natyror dhe ekzistencial.Konceptimi i rrjedhës kohore të zhveshur nga determinizmi historik, shënon një formë emancipimi estetik dhe e çliron progresin nga dogmatizmi doktrinar.

Optimizmi me të cilin mbyllet poema, përtej klisheve që impononte ideologjia e kohës, buron nga vetë dialektika e brëndëshme e poemës lumore – e vetë lumit, si simbol polisemik i jetës dhe rrjedhës së pandalshme të kohës. Në këtë kuptim, poezia jo vetëm feston bukurinë e natyrës, por përcjell te lexuesit edhe një ndjesi paqeje, frymëzimi dhe shprese ekzistenciale.

Të tre këngët e poemës bashkohen në një vizion të plotë: Lumi është energjia e jetës, rrjedha e kohës,vetëdija dhe reflektimi filozofik mbi ekzistencën. Në përfundim, poema *“Lumi im”* është një rrjedhë e integruar, ku pathosi emocional, ethosi moral dhe reflektimi filozofik ndërthuren me mjeshtëri.



Mes kohës që ikën dhe mallit që djeg

Tregim nga Delvina KËRLUKU

Sa çel agimi nata i thotë lamtumirë mbretërimit të saj, duke pritur me durimin epik, gremisjen e rrezeve të fundit të ditës. Atëherë shtëpia ime nis të frymojë me një heshtje të rëndë që la njeriu i zemrës, me të kthyer shpinën derës, dhomës bashkë me mua. Eh, sikur të ishte hera e parë! Dritarja drejt lindjes, lejon dritën të hyjë ngadalë në dhomën time, si të kishte frikë të më zgjonte nga një ëndërr që nuk dua të mos e ëndërroj. U zgjova dhe thashë: Sa hap e mbyll sytë, treten ditët pa ty. Janë bërë si fletë kalendari zverdhak që i rrëzon edhe puhiza, pa zhurmë, pa më pyetur.

Duket sikur koha ka krahë të padukshëm. Kalon pranë mendimeve të mia, e ndiej paqe në vete. Më vjen si vegim, dhe ti aty. Aq afër sa më duket se, nëse shtrij dorën, do të prek, të shoh buzëqeshjen tënde të mbetur pezull, pa mua, filxhanin e kafesë që s’e mbarove kurrë, fjalën e fundit që ma le përgjysmë.

Kujtimet janë bërë ngushëllimi im i heshtur. Vijnë pa trokitur, ulen pranë meje dhe më flasin me zërin tënd. Më tregojnë për të qeshurat që ende jehojnë në muret e kësaj shtëpie, për hapat tanë në rrugën tona, për ditët kur ëndrrat i kishim aq të mëdha sa bashkë i preknim me dorë. Kishte ikje dhe fillime, pengesa që i kalonim si ura të drunjta mbi një lumë të trazuar, dhe fitore që i festonim si mrekulli.

Por, kështu të ndarë, jetojmë mes kohës që ikën dhe mallit që nuk shuhet kurrë!

Ora nuk fal. As jeta. Ato ecin përpara me një ritëm që s’e ndalin as lotët, as lutjet. E ndezur nga flaka -mall, i lajmërova Zhanit, se durimi im po shpërthente, si një qelq, gati të thyhej në mijëra fjalë të pathëna. Dhe i thashë vetëm këtë: - Unë do vij, tek ti. Meqë në qytetin e tij kishin ardhur vizitorë nga bota, për të parë veprën e Zhanit, se siç u kam thënë, ai ndërtonte nga hiçi, vepra të mëdha. Kësaj here kishte bërë një vepër, e cila do të prezantohej nga krerët e shtetit, para botës. Por, Zhani nuk do të merrte pjesë. Ai bënte vepra dhe nuk dukej. Vepra e bënte të gjallë në heshtje dhe “zhdukjen” e tij. Kështu vepronte edhe me dashurinë, të dashurën e tij, që mua më shfaqeshin – halucinacion dhe me mua, që më thoshte: E vetmja, e imja Dashuri.

Ai më ndalonte me një heshtje që peshonte më shumë se çdo fjalë, sikur frika e tij të ishte mur mes nesh dhe dëshira ime të përplasej pareshtur në të. Kësaj here, si shkak u gjet edhe ceremonia madhështore, këmbëngula: Do vij! Zhani e kuptoi se këtë here nuk fliste thjesht dëshira, por një shpërthim i një mllef grumbulluar prej kohësh, një vendim që nuk kërkonte leje dhe në zemrën e tij u përplasën frika për të më humbur dhe pafuqia për të më ndalur. Atëherë, ai më përcolli një fotografi nga varrezat, përcillte për në banesën e fundit burrin e motrës, dhe mbi atë imazh të ftohtë, mes dheut të sapo hapur e qiellit të rëndë, ndjeva se jeta na kujtonte me ashpërsi sa e brishtë është çdo pritje dhe sa i kotë bëhet çdo dyshim.

Unë mora rrugë drejt Zhanit. Pimë kafe dhe u pamë, sa shikimi të na çmallte e të na mbushte boshllëqet e heshtjes, në praninë e kryetarit që rrinte si dëshmitar, herë i qetë, herë i trazuar nga “ndarja jonë”. (Kryetarin e thirrën në telefon se ish vonuar për ceremoninë madhështore). I uruam njëri – tjetrit forcë e dritë, me besën se do të takoheshim sërish, për ta derdhur mallin si shi i vonuar mbi shpirtrat tanë të etur.

Po kërkoja një libër për t'u rikthyer te zëri i Shqipërisë. Dita ishte e zymtë, me atë lagështinë e butë që i paraprin dimrit. Dora më ndaloi mbi Kukulla — libri i kujtimeve të Ismail Kadaresë për nënën, për vajzat, për gratë e jetës së tij, për Shqipërinë. E hapa dhe zura ta shfletoja. Diku pas faqes së parë u ndesha me të papriturën që ma mbajti frymën pezull: lexova me një frymë autografin që më dedikoej:

Burbuqes, gruas që i shkon dimri,
Ismail Kadare

Një fjali e shkruar me dorën e tij, si një shenjë personale, si një kujtim që priste të rizgjohej.

U ula. E kapa librin me të dyja duart, sikur të mbaja diçka të shenjtë. U ndala në atë fjali që ishte më shumë se një autograf. Ishte një vështrim i kthyer pas në kohë, një portë që më çeli kujtimin e asaj buzëmbremjeje dhjetori në Tiranë që shkëlqente në prag të festave.

Atëherë kishim ardhur nga larg. Jetonim prej vitesh në Pekin, në një botë tjetër, të ftohtë, të madhe, ku edhe kujtimet bëhen të heshtura. Por Shqipëria na thërriste përherë.

Endieja që në aeroport, por goditjen e merrja fort kur avioni kalonte mbi detin Adriatik. Sapo avioni i afrohej Tiranës, e sodisja qytetin tim të shtrirë poshtë si një fëmijë që fle, dhe diçka brenda meje dridhej. Më kishte munguar qielli i saj blu — ai blu i thellë, i pastër, që në mëngjes duket sikur të flet pa zë. Në Kinë qielli është i zhurmshëm, me ngjyra që s'i njihja dhe me një shpejtësi që s'më linte të merrja frymë. Tirana, në mënyrën e saj të qetë, pa pretendime, të linte hapësirë të ndieje, të mendosh... të jetosh. Më kishin munguar netët me yje.

Dhe ajo mbrëmje kishte diçka magjike: Tirana ishte zbukuruar me drita të arta, pemë shumëgjyrëshe, yje plastike që lëkundeshin lehtë mbi rrugë. Qyteti shkëlqente me një ngrohtësi fëmijërore.

Në një buzëmbremje dhjetori, pak

Një kujtim me Kadarenë, një mbrëmje dhjetori në Tiranë

Gruas që i shkon dimri

Nga Burbuqe Spahiu Lukacevic

ditë para festave të fundvitit, Tirana na priti me drita shumëgjyrëshe dhe me një ajër të njohur që na përqafoi si një mik i vjetër e i dashur. Kishte pak ditë që kishim ardhur nga larg — nga Pekini, ku jetonim prej vitesh — të mbushur me mall për gjuhën tonë, për zhurmat e qytetit, për dritat dhe për njerëzit tanë. Na mungonte çdo gjë që lidhej me Tiranën, por në veçanti na mungonte qielli ynë blu, që ashtu siç e ka Tirana, nuk gjendet në asnjë vend të botës. Sa herë ktheheshim në shtëpi — se kështu do ta quaj Tiranën, që ne e duam aq shumë — kishim mall dhe nostalgji për çdo gjë: për qiellin blu, yjet që ndriçonin natën me hënë, ditët me diell, shiun e butë.

Atë mbrëmje, bashkë me Ilin, bashkëshortin tim, vendosëm të shëtisnim në këmbë përgjatë bulevardit të madh, përballë Kryeministrit. Tirana ishte veshur si për festë: dritat vezullonin në pemë e ndërtesa, ndërsa kalimtarët lëviznin ngadalë, sikur donin të mos i humbnin ato çaste të ndritshme e të buta. Ne përpiqeshim të thithnim me të gjithë qenien tonë gjithçka — pamjet, zërat, aromat — si të donim t'i

ruanim brenda nesh, për t'i rikthyer shpirtit pjesën që i mungonte.

Por dua të rrëfej për një takim të papritur, që ka mbetur i gjallë në kujtesën time.

Pikërisht aty, në atë mbrëmje të qetë e magjike, përballë nesh, duke ecur ngadalë, u shfaq figura e njohur e Ismail Kadaresë. Krah tij, si përherë, ishte Bujar Hudhri, miku ynë i vjetër dhe botuesi i shtëpisë "Onufri".

Nuk ishte hera e parë që e takonim Kadarenë. Disa vite më parë ai na kishte ftuar me shumë përzemërsi në shtëpinë e tij në Malin e Robit, në Qerret — një pasdite e paharruar, mes librash, deti dhe heshtjes së tij fisnike. Përmes bisedash të këndshme, më dukej sikur nga emocioni flisja vetëm unë. Tregoja se me veprat e Kadaresë jam njohur shumë herët, kur isha vajzë e vogël dhe jetoja në Shkodër. Në revistën që botohej asokohe me titull Nëntori kam lexuar me një frymë tregimin e famshëm "Përbindëshi". Tregimi më pas u ndalua, por unë pata fatin ta lexoja në kohët e hershme. Tregoja se me poemën "Përse mendohen këto male" kam fituar çmimin e parë si recituese.

I tregonim histori nga Kina e antikitetit dhe më pas i dhuruam librat e tij që ishin botuar për herë të parë në Kinë: *Kronikë në gur*, *Aksidenti*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*.

Në Kinë Kadarenë e duan shumë, madje edhe brezi i ri. Ne ia përcollëm këtë mirënjohje, respekt dhe dashuri që kinezët kishin për të.

Në vilën buzë plazhit, ku ajri mbante aromën e kripur të detit dhe rrezet e diellit sikur loznin mbi tavolinë, Elena — zonja e shtëpisë — na priti me një buzëqeshje të ngrohtë dhe na qerasi me fruta të freskëta, sikur t'i kishte mbledhur vetë nga kopshti i ëndrrave. U krijua një atmosferë e ngrohtë dhe miqësore; kërkonin të dinin gjëra të reja nga Azia e largët. Tregonim për mrekullitë e botës aziatike: gastronominë e veçantë, jetën e perandorëve të lashtë kinezë, perandorëshën ekstravagante Sisi (Cixi) që qeveriste pas perdes, enigmat që mban brenda vetes Muri i Madh Kinez, sharmin e Pallatit të Verës, misteret e Qytetit të Ndalar, ku kanë jetuar për shekuj me radhë perandorët e Kinës së lashtë. Perandori quhej "Biri i Qiellit" dhe, sipas legjendës, kur mbaronte misionin në tokë, hynte në një dhomë të fshehtë pa dritare e pa çati dhe fluturonte drejt qiellit.

Por ajo mbrëmje në bulevard ishte ndryshe.

Isha veshur me një peliçe të shkurtër të zezë dhe në kokë mbaja një kapuç të bardhë. Bënte pak ftohtë. U takuam me shumë dashuri e përzemërsi. Kadareja më pa me atë vështrimin e tij të thellë e të qetë, që sikur sheh përtej çastit. U afrua dhe më përqafoi. Ishte një përqafim i ngrohtë, i njerëzishëm — nga ata që nuk të përqafojnë vetëm me trupin, por me shpirtin.

U tërhoq pak, më pa në sy dhe tha me një zë të ulët:

— Je gruaja që i shkon dimri.

Një fjali që ma ndali frymën. Nuk ishte thjesht kompliment. Ishte një përjetim i butë, një mendim poetik i lindur aty për aty, por që u ngulit në kujtesë si një gur i çmuar.

Ai buzëqeshi dhe tha:

— Pse nuk takohemi më shpesh?

Unë qesha

— Sepse Ili, bashkëshorti im dhe Bujari janë pak xhelozë

Kadareja u përgjigj menjëherë:


— Jo... ata janë xhelozë të sëmurë!

Qeshëm të tre. Ishte një e qeshur e singertë, e papërmbajtur, që shpërtheu në mes të bulevardit si një dritë tjetër, përtej atyre që ndriçonin pemët.

Kanë kaluar disa vite, por vazhdoj ta mbaj të gjallë në kujtesën time atë takim të paharruar në trotuar.

Sepse ndonjëherë nuk të mbetet në zemër një fjalim i gjatë, një darkë zyrtare apo një takim i planifikuar. Të mbetet një fjali që të prek telat e shpirtit. Një përqafim. Një vështrim që flet më shumë se fjalët. Dhe, së fundmi, një kompliment që, në heshtjen e tij të butë, mbart një dashuri të rrallë e të heshtur — si një kujtim që nuk plaket kurrë.

Mali i Robit
Qerret
Gusht 2025



Kapëdhecun skej oxhakut fërkojnë duert
ma t’rurdhuna se ftyra. T’mpita, gjithsesi.
Tuj kqyrë prushin e shymun t’votrës. Drutë gati
e asnji gacë zjerme n’shkarpa t’thata
tuj mos guxue me e dhezë.
Se shihet tymi e vinë Ata...

Dimër, ftoht’ i madh, acar. Kallnori
gjithmonë egër ka marrë n’këto anë. Gjithë
i ka zhvesh e kërcellue dhambët. Ka kërcënue...
Bora s’ka t’ndalun.
Fërflazë.
Kallkanosun pleqtë, t’gërmuqun ngjiten
njani n’tjetrin si thue n’mish.

- *Do Zoti e kanë mrri,
pa i nalë kush udhës!*

Rrëqethun shpirtnash,
djegun malli,
luten për reja e fmi.
Për djemtë n’mal.

- *A thue, a janë dekë a gjallë?*

Kreshtbardhët s’kishin pasë gajret me e lshue shpinë.
S’kishin mujtë. S’jau kish bajtë zemra.

Ai e kish marue me duer t’veta atë konak.
N’t’ri t’vet. Hala pa i ra brisk mjekrës.
N’za ish për trina t’thurrueme me purteka. Nganjiher’ deri n’avlli.
Kish pas punue gjithë, si dem. Deri n’pleqni. Kurrë pa ndalë.
“Ma kadal, he burrë se do me lanë shpirtin...”, e ngucnin
akrobatë at’ vakt. Por, s’ndalej. Trupi ia donte punën.
Ia lypte... I bante mirë. E kishte ba ma t’mirë. Babaxhan.

Plakut i shndriti një fije buzëqeshje musteqeve,
tek ish përumbë n’mejtime.
- *A t’kujtohet...?* e pveti plakën, sikur me ditë
që anejpari turbullueshëm edhe ajo kish fluturue.
Ofshau...mallëngjye kujtimesh moti t’pandërmenduna,
kujtimesh t’rinisë s’kahmotshme, ditëve t’kahershme.
Nji e rrëqethun e ftohtë ia përshkoi trupin.

Sa shpejt ikin motet.
Sa shpejt kalon jeta!

Prej syve n’sy lulzoi një urë. Nji urë dashnie e moçme.
E mblatueme fort. Me bedena t’pashembuna vitesh.
S’e kish lëkund asgja. Edhe pse e ndryeme. E shtypun thellë.
Furtunat, rrebeshet, shtrëngatat, acari.
Krajatat e jetës.
As lufta!

Ajo kish hi aty nuse s’pari. N’atë kullë.
E re. Pehri e bukur. E marrshme. Ftyrë e saj si drandofille
e posaçelun, kuq all i baheshin faqet kur i thurnnin lavd...
Ish kanë e zoja, fort e zoja, kallxojsin. Sabah e aksham
kish rangue, pa ju ni kurr’ një fjalë. Druhej. Gojë ka gojë s’ka,
thojshin. E kur fliste, gojë e saj rridhte nektar.
Kish miklue ambël fmi e nipa, n’djepa gdhendun hollë,
bojna- bojnash lulue, me aromë trumzash tuj spërkatë për fat,
mos me qenë t’pau dhë, mos me qenë udhëpremë...

DONIKA
DABISHEVCI

Ngjitun si thue n’mish

poezi

Bashkë kishin pritë miq e dashamirë.
Derë e tyne gjithë çelë, për t’njofshëm
e t’panjofshëm. Për akraballëk e jabanxhi.
N’za për mikpritje. Familje bujare. Shpirtna t’fismë.
Sa dasma, sa deka...Kurrë t’lëkundun. Kurrë t’dorëzuem.

Kur u ngushtue rrethi, kur lufta ia mbërrini n’prag t’shpisë,
krejt u banën gati me ikë. Plakun e plakën i lutën n’be e rrfe.
N’zot e gjithçka, po s’mun’ i morën me vete.

Mbshtjell me aurën e t’parëve, t’shejntnueme
e kishin tokën, kullën, dheun...

- *Ikni ju, ju priftë e mara, rune veten, runi këta thmi,
se na pleq jem! Pak pa dekë. E ma e mire se deka n’shpi s’ka!,
kishin pasë thanë flokëborët.*

S’kish pasë gja që i nxjerrë prej shpisë.
S’kishin livritë.
Nji ndajnate t’krahneztë, dikush prej djemve i kish ra anej pari
dhe e kish pas pa që shpija ish djegë me themel.

Prej pleqve,
nji grusht eshtna.
Aq kish mbetë!



Gëzohu që të harruan ...!

Epoka jonë i është dorëzuar demonit të shpejtësisë.

Kur gjërat ndodhin tepër shpejt, askush nuk është i sigurt për asgjë, për asgjë fare, as për veten e vet.

Epoka jonë është fiksuar për të harruar, ndihet e lodhur nga vetvetja, e neveritur dhe kërkon ta shuajë atë flakëzën e kujtesës.

Mik i dashur mos e torturo veten!

Dil nga pellgu i mundimit, sakrificës, mos mendo për të qeshurat që të lënduan, mbështillu me shallin e ëmbël, të ngrohtë të amnezës.

Gëzohu që të harruan!

Merr frymë thellë, dhe kështu e harron kollaj vetveten...

Amanete guri ...

Dëgjoj gjuhën e bekuar që mbrojnë zogjtë bredharakë, drurëve, kambanave, riteve, përrenjve, lumit, përposh në luginë, gjuhën që flasin gurët e kështjellës kur ikin ujërave të nëndheshëm, përtej kufijve të një ëndrrë amtare, që arratiset në perëndim.

Koha i ka gdhendur gjurmë e plagë, shenja të qarta ilirike, mundime e dritë, kodikë, libra të shenjtë që i mbaj mend. Violina e valltarë, bozhur Kosove, dhe një marathonomak, nisur të kapërcejë terrin pesëqindvjeçar, që ende më tremb.

Pyesni tokën, rrënjët, pastaj të vdekurit, ngjyrat në festa pjellorie, qiellin kuarcë që ulet poshtë, sikur kërkon të preket me dorë. Kthimin e pelikanëve, legjenda të thinjura, fjali të motmotshme, me hartën e mikpritjes në çdo portë.

Një poet syngulur në vija - guri, rri dritares nga vjen dielli, për të folur gjuhën e bekuar me ëngjëjt apo me diçka tjetër ...


N'ato kodra vetmitare ...

N'ato kodra vetmitare, ku fryn erë e bardhë Kolonje, vrapon dielli çdo mëngjes dhe krijon me dritë të pastër gjithë gjërat e thjeshta të botës.

Bredh që ikën horizontesh, ku janë lisat dhe ahet, bredhat, qiparisat, dushqet që i afrohen gjithnjë e më shumë qiellit.

Rrotullohen në rodon, fjetet e fatit të jetës, pemët ngarkuar me mollë të gjelbra, pemë nën peshën e arrave të rumbullta, rrafshnalta të mbuluara me kallëza graniti, ku delet blegërojnë nga thithkat plot qumësht, në pyjet me përrenj që kërcejnë si kaproj pa u ndalur, nëpër ujëra të kulluar mes shkrepash.

Nën hije gështenjash, lulet që fërgëllojnë, erëmojnë, si një kaba madhështore, në çdo lëvizje ajri dëgjohen, kuaj nusesh, avaze dasme, gjinkalla që këlthasin, bulktha që qajnë, bretkosa që gjëmojnë, buaj të mëdhenj, të bardhë, që mbushin me bulërimën e tyre luginën, tinguj që shpirti i njeriut shijon veç një herë.



N'ato kodra vetmitare, ku fryn erë e bardhë Kolonje, pak para perëndimit, dielli merr një sy gjumë, mbi një gjethe luleshtrydheje ose një rrëfanë qershie ...!

Rregulla të thyera ...

Ka kohë që i besoj rregullave të thyera, si një dhurate zoti mbështjellë me ëndrra. Dashuria dhe urrejtja kanë stinët e veta, fjalët: janë si gurët, pesha të rënda.

Asgjë e kësaj bote s'u zbulua paqësisht, Amerika, universi, nano - lënda, graviteti. Këmbëzbathur përgjatë boshtit të dyshimit, dituri e imagjinatës triumfon mbi rregullin.

Ty të jap çdo gjë, por ti bëhu Ajnshtajn, filozof po deshe, në gjëra teorie. Plan kërkimi pafund e paanë, kur flasin engjëj terri me engjëj drite.

Një dorë tek vijë e lakuar e arkitekt Gaudi, tjetrën tek puls i yjeve të largët e simetria. A ka një hartë ku shterohet fantazia? Kjo botë mer formë nga rregulla të thyera.

Ka kohë që besoj tek rregullat e thyera, kapriçiot, ndryshimet, gjithësia. Besoj tek mendja e njeriut, ekuacioni: kaos, mjegull e pastaj: kthjelltësia ...

Shpërfillanët ...

Shpërfillanë provincialë, në krye të kiçit, kokzbrazur, artific, elegancë e tredhur. Fluridhë e asgjësë, bujtur prej hiçit, drejtoresha e shefa, papagaj të egër.

Shpërfillanë, ky soj, qelb - administrate, me CV të blera, universitet lart e poshtë. Zhgun prej zhgunit, terr, lakuriq - nate, krejt analfabetë, kapardisur si kaposhë.

Shpërfillanë arrogantë, pa drojë, pa turp, pa kujtesë, shpërfillsa që s'njohin askënd. Grabitqarë postesh, të etur, pushtues, rikthim primitiv që trëmb e të ç'mend.

Shpërfillanë makutër që bien dhe vdesin, shpatullat të ngrohën në karrige pushteti. E dinë fare mirë, karrigia pa mund, të çon direkt tek arka e shtetit.

Çyrykë kotësish, krimba të tokës, racë mediokre, shpërfillanë funksionalë. Ju jeni rreziku zjarrvënës i botës, mjerë kë kap e përvëlön të gjallë ...

Në kërkim të varrit të saj ...

Asnjë varr nuk do ta merrte përsipër, të burgoste bukurinë tënde...

Trilli gjeti prehje atë ditë vjeshte, në vizatimet e çuditshme të shiut.

Mbi një pllakë mermeri data e lindjes, dhe e vdekjes, (mungon data e dashurisë së parë).

Datat nuk gënjejnë, janë të sinqerta, pafjalë, nuk përmbajnë asnjë mister.

Nuk ka rëndësi sa larg kishe shkuar, përsëri të gjeta në pikën e fillimit.

Kishe ikur prej varrit, për t'u bërë pemë, mushmollë e kuqe.

Ti e di pse më dërgove pastaj ca fjalë gjethesh:

«Ngrije gurin e rëndë të durimit dhe shpërndahen vetë buburecët ...!»

Lindëm në Atdheun me mungesa të mëdha ...

Ëndrrat tona duhet të kapërcenin çdo ditë, mungesat e mëdha të kohës dhe vendit, por pas çdo hapi që hidhnim, toka rrëshqiste poshtë me fuqi rrënuese, në venomin as kështu, as ashtu ...

Pavarësisht marrëzive, befasive të kësaj bote, shpresat linin pas, parandjenjat pikëlluese, ngatërresat, mosbesimin si formë të sprapsjes, mitet dhe çdo tabu ...

Ëndrrat tona kishin prirjen e natyrshme, për t'i zvogëluar mungesat, xanxën e një gjendjeje qartësimi e njëherësh verbimi të padurueshëm.

Atdheu ynë ndërkaq tkurrej, bëhej gjithnjë e më i urritur, shitur për një euro, i raskapitur, trembur prej fatit a mallkimit, paspjegueshëm ...

E pabesueshme ngjan joshja prej së keqes, një kotni, një gabim, një mos i pafund... pjellë e një brengje të gjatë, shqyrtim sflitës i ndërgjegjes, kërkim i kohës së humbur, normalitetit, lodhur prej shumë e shumë jetëve ...

Atdheu ynë ende përtyp rrënjë të egra, në mjegullnajë, tej mugëtirës, mëmë e kërrusur, në shpresa të thyera ngeli. Duke pritur një yll të ri të ndriç, duke vështruar agimin e çdo dite të re, si kapërcim ylberi, me admirim rrebeli.

E vetmja gjë që ka rëndësi tani Atdheu im, është të shohim sytë tanë në pasqyrë dhe t'i pyesim: a i kanë qëndruar besnik vetes?

Ti që nuk e ke frikë kohën ...

Ti që nuk e ke aspak frikë kohën, vërtitesh si gjethet e thara, pa shpirt. Kujton: të presin. Ke një jetë tjetër, me iluzionin e vjetër narcist.

Rrotullohesh në dredhore dergjë - ferri, asnjë aksident s'vjen kot, rastësisht. Del nga shtrati një lumë i tërbuar, dhe i rrëmben të gjitha tragjikisht.

Diku në memorie një çelës rri fshehur, për ditë të mbrapshta, ato të errësirës. Të mëson të ndash nga byku, vlerën, në kufi kotësie, të keqen - të mirën.

Ti që nuk e ke aspak frikë kohën, pa cekur skajin të kuptosh ekzistencën. Vërtitesh si gjethet e thara pa shpirt, në tornado dimrash të egër ...

Atje përposh ...

Atje përposh nënvetëdijës time, rri i fshehur një ajsberg i stërmadh. Brenda ajsbergut Njeriu - pezull, as vdekur, as gjallë.

Në «shtëpinë» prej akulli, Njeriu - shumë dashuri të para të jetës. Disa mbeten, bëhen të përjetshme, të tjerat: shkrihen e rrëshqasin rrjedhës ...

Ato që mbeten luajne symbylltas, kundërshti dyshuese, hollake vija. Mardhënien direkte të dritës, me hije - driten, dhe atë brendësinë që i rrëmben të dyja.

Atje përposh nënvetëdijës time, rri i fshehur një ajsberg i stërmadh ...

Lutja e harruar ...

Tinguj të çuditshtëm ranë, lutja tha: det të urdhëroj të qetësohesh! Era ndërroi kahjen dhe u bë e butë, dallgët llokoçisnin vetësi e pafajësi, drita mori ngjyrë diellore, të bruztë, u rregullua direku anijes, bukuri.

Si lundroi ajo, në erë dhe ajër, a thua kish ndodhur ndonjë mrekulli?

Bregu s'e dëgjoi botën fjalëtare.

Qetësuar dallgë, mbërrin në port anija. Lutja ritual nuk qenka harruar... Sekret dëshire, mbrojtëse përndryshe, kod vjetrar marinarësh apo vetëpërbushje ...?

Ata që na ndjekin, nuk lodhen kurrë. Disa thonë se janë një ushtri e rregullt: me uniforma, me pushkë, me komandë. Ndjekin strategji dhe bëjnë plane ditë e natë, për të na zënë në çark. Edhe ne harxhojmë mjaft energji për t'u shpëtuar ndjekjeve. Fushojmë në buza përrrensh, flemë jashtë dhe ndonjëherë bëhemi njësh me pyllin. Qëndrojmë aty pa lëvizur dhe përgjojmë.

- Dëgjo, - i them Aurorës, - a nuk të duket sikur kjo ndjekje zgjati ca si tepër? - Jo, mendoj se ky është vetëm fillimi, - përgjigjet ajo. - Krimi që kemi bërë ne, është i tillë që nuk falet. Por edhe kur falet, nuk harrohet. Ndaj kjo ndjekje do të vazhdojë gjatë.

Thellë në pyll dëgjohen ca të lehura qeni.

- Janë ata, - i them, - ndaj forca, lëviz, duhet të largohemi!

- Jo, nuk janë ata, - më thotë ajo, - këto janë të lehura të thata langoi, jo të lehura qeni. Me siguri është ndonjë gjahtar.

- Njësoj është, - i them unë, - nëse ai na shikon, mund të na kallëzojë.

- Po, - thotë ajo, - por tashmë ata e dinë që jemi të arratisur dhe, derisa ai të shkojë për të lajmëruar ata, ne kemi ikur nga këtu.

- Po, ke të drejtë, - i them.

Megjithatë vendosim të lëvizim sepse nuk kemi dëshirë të rrimë aty. Tani të lehurat dëgjohen të dobëta. Pastaj vjen një moment që nuk dëgjohen më.

Nata po bie. I ftohti ndihet më shumë. Ecja na ka lodhur dhe ne kemi uri.

- Shiko mos ka mbetur ende pak pastërma në çantë, - i them, - sepse jam i uritur.

- Jo, nuk ka.

- Shiko mirë, - i them, - sepse po më këndojnë zorrët!

- Jo, nuk ka. Por kam me vete disa kallëza misri. I gjeta në një kapule, në një arë përfund fshatit.

- Ata nuk na duhen për gjë, Aurora, - i them, - janë të fortë dhe dhëmbët nuk i bluajnë dot.

- Mund t'i ziejmë, - thotë ajo. - Sikur të kishim një enë.

- Këtu nuk ka enë.

- E di, por duhet sajuar.

- Dëgjo, - i them, - kjo punë është e kotë. Duhet gjetur diçka tjetër për të ngrënë.

- Të gjesh diçka tjetër për të ngrënë është më e vështirë sesa të gjejmë një enë për të zier misrin.

- Ku ta gjejmë enën?

- Kutia e mishit qe perfekte për këtë punë, prej llamarine të trashë, - thotë ajo, - por ne u treguam të pakujdesshëm që e hodhëm.

- Mos ke ndër mend...

- Nuk janë shumë, - thotë, - disa kilometra, 7 apo 8. Gati një orë e gjysmë rrugë.


- Të kthehemi pas është e rrezikshme, - i them unë, - mund të shkojmë me këmbët tona te patrullat. Ose mund t'i hasim rrugës.

- Por edhe të ikim para, pa ngrënë asgjë, është po kaq e rrezikshme. Kjo rrafshnaltë është pa anë.

- Atëherë, si do bëjmë, - i them?

- Kthehemi të gjejmë kutinë e mishit, - më thotë. Ajo ka të drejtë, të gjejmë kutinë është varianti më i thjeshtë.

Tani nata ka rënë plotësisht. Por duket sikur është mëngjes, ngaqë drita e hënës reflekton mbi dëborën që ka



mbuluar pllajata e rrafshnaltës. Ne ecim në heshtje një copë herë. Pastaj ajo flet.

- E di ç'mendoj?

- Nuk e di, - i them.

- Dikur ëndërroja që sapo të më jepej mundësia për të ndenjtur vetëm për vetëm me ty, do bënim dashuri.

- Ashtu? - i them.

-Po, - thotë, - por kemi shumë kohë që shtegtojmë, fshihemi dhe tani kërkojmë një kanoçe mishi, për të zier misrat. Qesharake. Ndërsa dashuri nuk bëjmë dot.

- Edhe unë kam menduar të njëjtën gjë, - them.

- Po tani nuk mendon më për këtë?

- Jo, - i them, - nuk ankohe. Ti e di që të dua. Kaq është mjaft.

- Edhe unë të dua, - thotë ajo, - por më duket se dikur të doja më tepër.

- Po tani?

- Tani mendoj se kaq të kam dashur edhe atëherë, por më është dukur mua se të doja më tepër.

- Kurse mua më duket sikur tani më do më shumë.

- Po pse?

- Sepse jemi bashkë. Gjithmonë bashkë.

Vazhdojmë të ecim. Diku këmba pengohet. Dhe rrëzohem.

- Mos e ndrydhe këmbën, - më thotë?

- Jo, jam mirë. Pse mendon se e kam ndrydhur?

- Sepse në raste të tilla, fatkeqësitë ndjellin njëra-tjetrën.

- Ah, jo, - i them, - shiko mund të eci për bukuri.

- Sa mirë!

Dëgjojmë zhurmën e përroit. Jemi afër mbërritjes. Lodhja është e madhe

dhe një sy gjumë po na vardiset vençe.

Gjejmë gjurmët e zjarrit që patëm ndezur. Kanë mbetur vetëm ca thëngjij dhe hiri. Kutia e mishit është aty, ku e kemi hedhur çrregullt. Për fat nuk e kemi hedhur në përrua. Ndryshe mundi do na kishte shkuar kot.

Aurora ndez zjarrin. Unë sjell dru të tjera. Mbushim kanoçen me ujë dhe vendosim brenda saj dy copa misri. Zjarri na ngroh mirë.

- A mund të afrohesh ca, - më thotë, - sepse kam ftohtë?

Afrohem. I marr duart dhe ia ngroh me frymën time. Qëndrojmë ashtu, ajo mbështetur në gjoksin tim. Asnjëri nuk flet për pak kohë.

- Po sikur të na gjejnë, - më thotë?

- Ke frikë?

- Jo, nuk kam frikë, por nuk dua të shikoj kënaqësinë e fytyrave të tyre, kur të na arrestojnë.

- Po pse?

- Sepse ndiej poshtërim.

- Tani merre njërin misër, - i them, - mos i mendo këto.

Përtypemi të dy. Shija e misrit të zier është e keqe. I mungon frika.

Zjarri po bie, ndaj dal të mbledh dru. Fusha e qiellit është plot me yje. Diku larg një dhelpër kuis. Sjell drutë. Atë e ka marrë gjumi. Duket mjaft e dobët. Sidomos kohët e fundit.

Befas hap sytë dhe më thotë.

- Po shihja një ëndërr të keqe.

- Ma trego.

- Ishte një ëndërr që nuk ia vlen ta rrëfesh.

- E po mirë, - i them, - lëre fare.

Ndërkohë tutje larg vëmë re drita. Shumë drita, të vëna varg.

I hedhim ujë zjarrit. Ngrihemi dhe lëvizim.

- Janë ata, apo jo? - më thotë.

- Nuk e di, por me shumë mundësi, janë ata.

- Kjo ndjekje po më lodh. Nervat nuk më mbajnë më.

- Edhe mua.

- Po sikur të dorëzohemi?

Unë shtang. Kjo më ka shkuar në mend kohët e fundit, por nuk kam guxuar t'ia them asaj.

- Vërtet do që të dorëzohemi, Aurora?

- Nuk e di, ndoshta po, sepse me siguri një ditë ata do të na gjejnë. Nuk mund të fshihemi për tërë jetën. Ndoshta po të dorëzohemi, do tregohen më të butë me ne.

- Nëse ti mendon kështu... - i them,

- merakun tënd kam... Më beson?

- Po, të besoj.

- Atëherë dorëzohemi!

- Po.

Kaq ishte. Mori fund. Ndjekim dritat që lëvizin. Ato nuk janë larg. Janë nga ana tjetër e përroit. Kemi vendosur të dorëzohemi. Ndaj afrohemi. Dëgjojmë zëra. Pastaj vendosim të qëndrojmë. Ata që po vijnë i ndajnë vetëm dhjetë metra nga ne. Ndoshta tani na kanë parë. Bërtasim të dy, njëherazi nga frika se ata mund të qëllojnë me plumba.

- Ne dorëzohemi. Nuk ka asnjë kuptim të na ndiqni më. Dorëzohemi pa asnjë kusht. A na kuptoni? Bëni ç'të doni me ne!

Ata kalojnë aty pranë. Na shquajnë në dritën e elektrikut dhe na thonë.

- Po ju, ç'bëni në këtë rrafsh të egër?

A jeni në terezi që bridhni kështu natën në të ftohtë?!

Ne mbesim të turpëruar. Nuk janë ata që na ndjekin. Janë një tufë druvarësh që i ngjiten malit me natë për të prerë dru. - Dëgjoni, - u themi ne, - e dini si është puna? Ne po na ndjek një ushtri e madhe. Dhe kemi vendosur të dorëzohemi!

- Ç'ushtri, - thonë ata, - lufta e fundit ka dhjetë vjet që ka mbaruar?!

- Si, - themi ne?

- Mblidhni mendjen dhe kthehuni nga erdhët, atë bëni! - na thotë i pari i tyre.

- Domethënë ne nuk kemi ku të dorëzohemi?

- More shokë, - na thotë njëri prej tyre, - bëni si themi ne! Nuk keni më ku të dorëzoheni, tani kjo nuk ka më kuptim, ndaj kthehuni në vendet tuaja. Mos kërkon qiqra në hell, ç'ushtri thoni?!

Ne ngrijmë nga habia.

Ata këqyrin edhe një herë fytyrat tona me dritën e elektrikut, pastaj largohen. Duket sikur nëpër dhëmbë thonë:

- Ju e keni në terezi! Nuk ju kërkon hesap askush!

Dhe largohen dy nga dy drejt pyllit. Pasi dëgjojmë fjalët e tyre krejt pa kuptim. Ne nuk lëvizim dot më se dita po zbardh. Koha ka ngrirë. Edhe gjaku ynë ka ngrirë. Jemi veç dy shtatore që u kujtojnë të tjerëve luftën dhe historinë tonë të lavdishme të arratisjes. Por vetëm kaq. Ndaj, të ftohtë edhe të ngurtë, nuk mund të bëjmë dashuri, nuk mundemi as ta puthim kurrë njëri-tjetrin, siç patëm shpresuar. Por, të paktën, edhe prej bronzit qëndrojmë aty, ngjitur, unë dhe Aurora ime. Ndërsa mbrëmjeve shpirtrat tanë arratisen.

Për ditëlindjen time të dhjetë, më dhuruan për herë të parë këpucë të reja. Këto nuk ishin këpucë që mbathnim zakonisht ne, fëmijët, nga vëllai apo motra e madhe dhe që, në pamje të parë, e kishim të qartë se ishin të reja. Këpucët ishin prej lëkure të butë, me mbërthecka të bukura, të cilat, posa ndalova për një çast në mes të rrugës, shkëlqyen në diell. Edhe babai, që gjatë jetës së vet kishte pasur këpucë të panumërta ndër duar, ishte magjepsur: i studioi gjatë, prej së afërmi, e kontrolloi qepjen në skaje dhe me një të gishtit trokiti në pjesën e poshtme të tyre. Këpucët m'i kishte dhuruar tezja ime që tërë jetën kishte jetuar në Argjentinë, dhe të gjithëve që dëshironin të dëgjonin, u tregoja se këto këpucë e kanë kapërcyer oqeanin. Shumë shpejt pas kësaj, në vendin tonë kishte qenë një dasmë. Këpucët kishin fituar po aq simpati te dasmorët, sa edhe nusja m'i kishte lakmi, e më së shumti i lakmonte motra ime. Që nga ajo kohë, e dija se motra ime një vit më e vogël do të bëhej bukuroshe. Kishte flokë të gjata, në të cilat rrezet e diellit krijonin ylberin, ndërsa kur i shikoja sytë e saj, gjithmonë më dukej se po i shikoja majat e bredhave të gjelëbr. Pastaj, kur nusen, sipas zakonit të vjetër, e kishin grabitur dasmorët dhe kur bashkëshorti shkoi ta kërkonte, ndërsa të tjerët prisnim të ktheheshin së bashku, babai më luti t'ia huazoja motrës sime këpucët, së paku për disa minuta, që t'i provonte edhe ajo. Nuk desha. Qëkur i mbatha për herë të parë, nuk i admirova vetëm këpucët, por edhe bukurinë time të zbuluar për herë të parë dhe në atë rast mendova se dashurisë nuk i duhen fytyrat dhe se si një fije e pafundme mund të zgjatet përtej tokës dhe oqeanit. Të gjitha këto ia thashë babait, sikur dëshiroja t'ia shpjegoja kundërshtimin tim, e në fund shtova se, sipas meje, dashuria mund të jetojë edhe në këpucë. Zëri im ishte shuar nga klithjet e gëzuara të dasmorëve që lajmëruan kthimin e bashkëshortit dhe nuses së gjetur, ndërsa motra ime, sikur ta kishte dhimbje gëzimin e të tjerëve, e kishte ulur shikimin, kështu që flokët e gjata ia kishin mbuluar fytyrën si perde.

Vetëm disa ditë pas kësaj, ajo u sëmur keq. Orët, gjatë të cilave babai, me një përparëse të gjelbër, i kaloi duke provuar t'i arnonte këpucët e mbartura, që mbatheshin gjeneratë pas gjenerate në vendin tonë, i përjetova vetë pranë shtratit të saj, ku i lexoja, e krahja, e ushqeja dhe e pastroja. Natën, në dhomën e saj bëja një gjumë të lehtë dhe zgjohesha në çdo lëvizje të saj, sikur të më nxirrnin papritmas në sipërfaqe. Gjatë sëmundjes së saj, babai e kishte vendosur mbi hyrjen e këpucëtarisë shkrimin me fjalët e mia: *"Dashuria mund të jetojë edhe në këpucë"*, gjë që nuk më kishte gëzuar, por kishte nxitur brenda meje një ndjenjë therëse të fajit, i cili, së paku ashtu më dukej, ritmiksht përputhej me frymëmarrjen e cekët të motrës. Kur, pas një muaji, më në fund doli nga dhoma e saj, e shkrirë dhe e zbehtë në fytyrë, babai u gëzua aq shumë, saqë m'i mori këpucët e reja dhe ia dha asaj.

*

U dashurova atëherë, kur edhe motra, edhe unë ishim rritur dhe i tejkaluam këpucët që kishin kapërcyer oqeanin. Babai nuk kishte djem dhe ishte e qartë se punën e tij do ta merrte njëra prej nesh. U mësova ta prekja mallin dhe t'i ndieja nën gisht të gjitha thellimet apo gungat. Zbulova se asnjë këpucë nuk është e barabartë me një këpucë tjetër; për shembull, këpucën e majtë më duhej ta zgjeroja, të djathtën ta shkurtoja. Vërejta edhe gjëra të tjera: se dimrit ka shumë më tepër punë, ngase atëherë duheshin përmirësuar shollat dhe thembrat në këpucë, ndërkohë që këpucëtaria në pranverë dhe në verë ishte

ANJA MUGERLI

Këpucët

Përktheu nga origjinali në sllovenisht:
Nikollë Berishaj



e vetmuar. Zbulova se si do të mund ta zgjeroja punën, dhe së shpejti filluam të qepim edhe çanta, kuleta, krahëse, e madje edhe shalle kuajsh. Zëri për këpucëtarinë me mbishkrimin për dashurinë dhe këpucët kapërceu kufijtë e vendeve tona dhe së shpejti aty filluan të vinin njerëz nga larg.

Ishte fundi i qershorit, kur në këpucëtari erdhi ai. Në gjoksin tim, diçka u zhvendos me fuqi aq të madhe, sa gati më iku toka nën këmbë. Duart e mia u mpinë, gjuha në gojën time u bë vetëm një copë mishi e papërdorshme. Ai i hoqi këpucët dhe i ngriti në ajër. Sholla e këpucëve mbahej vetëm në thembër, ndërsa përpara varej drejt truallit si gjuhë e tharë. "Aq nxehtë është, sa edhe ngjitësi shkrihet." U ngrita pas tryeze dhe fatmirësisht konstatova se këmbët më mbanin. Bëra disa hapa drejt tij dhe disi ndjeva se fundi im dhe shikimi i tij më ngjiteshin në trupin e djersitur. Atë ditë zbulova se dashuria mund të jetonte edhe në shuplakën me të cilën u bëjmë hije syve nga dielli pranveror, në guaskën e veshit të skuqur nga nxehtësia dhe në këmbët e zbathura. Kur u largua me këpucë të përmirësuar në këmbë dhe me buzëqeshje në fytyrë, unë ia afrova fytyrës sime shuplakat me të cilat pak përpara po mbaja këpucët e tij dhe mora frymë thellë.

Ishte njëri nga punëtorët e pyllit, që gjatë tërë pranverës prisnin dru, ndërsa në vjeshtë i ngarkonin drutë në kamionë dhe i dërgonin në kryeqendër ose përtej kufirit. Në krahasim me punëtorët e tjerë të pyllit, ai ishte i moshës sime. Të rinjtë, që nuk kishim shkuar në studime apo në punë në kryeqytet apo në Itali, por kishim qëndruar në shtëpi, mund t'i numëroje me gishtat e dy duarve dhe në mbrëmje, kur e përfundonte punën, zakonisht i bashkëngjitej grupit tonë të vogël. Ai i radhiste tregimet nga kryeqyteti si të ishin margaritarë, e ne e shikonim gojëhapur, ndërsa disa edhe me shije të hidhur në gjuhë, që nuk mund ta lante as vera e ëmbël. Për mua tregimet e tij ishin të shenjta, por ishin edhe të tilla që, porsa na e kthente shpinën, thoshim se s'ishin gjë tjetër veç trillime. Një mbrëmje, kur ishte atmosferë veçanërisht argëtuese dhe tryeza jonë ishte përplot me gota të zbrazura,

pas një tregimi, u ngrit të shkonte, por u ngatërrua dhe u rrëzua, gjë që tek ata më inatçinjtë shkaktoi një qeshje të fuqishme. Para se t'i qetësoja, diçka u përplas rëndë dhe qeshja u shua, si ta kishe prerë me thikë. Vetëm një hap larg nga karrigia e motrës sime ishte një shishe vere si gastare.

Ndërkohë që disa miq e kritikuan se e kishte derdhur gati një gjysmë shisheje pije të mirë, unë e vërejta se si u takuan shikimet e tyre. Prania e atyre të dyve e përmbushi tërë hapësirën dhe më shtyu në vrimën më të vogël, ku kisha aq hapësirë sa të thithja ajrin e ngrohtë të mbrëmjes.

*

Pasi gjatë pasditeve të nxehta të verës, në këpucëtari ishte e pamundur të punohej, babai ma kishte zhvendosur tryezën e punës në rrugë, nën hijen e kurorës së qershisë. Prej aty, shikimi kapte një pamje në rrugën plot pluhur, në fushat e lulediellit dhe në bredhat e lartë, që shpërthyen në qiellin e zbardhur nga nxehtësia. Por për sytë e mi kjo ishte një skenë pa asnjë vlerë, nëse para saj nuk paraqitej ai. Jetoja për ato çaste të vjedhura, kur ndaloi në këpucëtarinë time jashtë dhe shkëmbeu me mua disa fjalë: pasi u përshëndetëm, shikova gjatë pas tij, derisa u humb pas qoshes, duke shpresuar deri në fund se do të kthehej edhe ndonjëherë. Njëherë, gjatë një çasti të tillë, erdhi babai tek unë. Ishim nën mbishkrimin e vjetër, prej të cilit shiu i viteve të kaluara e kishte shpëlarë ngjyrën, kur më tha: "Vetëm një herë e kam parë këtë shkëlqim në sytë e tu: atëherë kur tezja t'i dhuroi këpucët. Asnjëherë nuk të kërkova falje që ia dhashë motrës tënde." E ngriti shikimin drejt mbishkrimit dhe buzëqeshi. "Ende beson se dashuria jeton në këpucë?"

Një ditë gjatë fëmijërisë, kur motra u kthye nga shkolla në shtëpi duke qarë, babai më vuri në karrigen e tij me tri këmbë dhe më pyeti: a thua kisha ndonjë ide ku ishin këpucët e motrës? E ngulita shikimin në shabllonin mbi të cilin e kishte vendosur lëkurën dhe desha t'i thosha se ato nuk ishin këpucët e saj, por të miat. Nuk i tregova se gjatë mësimit

gënjeva se më duhej të shkoja në banjë, pastaj shkova një kat më poshtë, në gardërobë, ku, nën varësen me emrin e motrës i nxora këpucët dhe me to nën xhup vrapova jashtë. Në stadiumin e asfaltuar, ku gjatë pushimeve luanim lojën "mes dy zjarresh", ishte një pjesë e tokës së papërpunuar. Me duar, hapa një gropë nën një pemë. Heshta rreth faktit se këpucët që e kishin kapërcyer oqeanin, ishin tani të shtrira nën dhë dhe shuplakat e mia, ende të ndotura me baltë, si në ngjerc, i futa ndër xhepa.

Edhe këtë herç vetëm buzëqesha për pyetjen e babait dhe e lashë në besim të verbër, se ende besoja, ndonëse tani besoja vetëm në dashurinë time ndaj punëtorit të pyllit. Çdo natë ëndërroja për të, ndërsa ditën mendoja si në ethe, se si do të më merrte me vete në kryeqytet dhe si prej atij momenti të gjitha tregimet e tij do të flisnin vetëm për mua.

*

Punëtorët e pyjeve kishin organizuar vallëzim në një pjesë të pastruar pranë pyllit. Në mesin e pirgjeve të trungjeve që i jepnin aromë ajrit, kishin vendosur tryezat dhe bankat, ndërsa ne sollëm ushqimin dhe pijet. Së shpejti u bë aq terr, sa na u desh të ndiznim llambat që shndrisnin vetëm këmbët tona gjatë vallëzimit, ndërkohë që fytyrat tona – edhe fytyra e tij – kishin mbetur në terr, kur papritmas më shtrëngoi për beli dhe vallëzoi me mua. Nëpër vena m'u tërbua gjaku i egër nga dashuria dhe vera.

Pak pas mesnate, ajri ende dridhej nga nxehtësia. U futa ndërmjet drurëve të afërt. Ndërkohë që e ngrita fundin në bel, dikush i fiku llambat dhe uli volumin e muzikës, kështu që e dëgjova qartë currilin që e përpiu trualli i pyllit. U ktheva në terr; rrugën ma tregoi vetëm drita e yjeve dhe siluetat e zbehta që rrinin në tokë në çifte apo në grupe të vogla. Në mesin e tyre nuk e gjeta. Përcolla aromën e dërrasave dhe u solla përreth pirgjeve të trungjeve. Ndieja secilën prekje që e bënte gardëroba ime verore në trup. Lëkura më kishte lulëzuar nga malli për preken e tij të sërishme. Syve të mi iu deshën disa sekonda që të shihnin konturet: pargun e trungjeve, përkrenaren që e kishte harruar njëri nga punëtorët e pyjeve në tokë, batanijen me katrora dhe dy trupa të ngërthyer në të. Në mërmëritjen që mezi dëgjohej, njoha zërin e tij. Si flladitëse, nëpër batanije ishin shpërndarë flokët e motrës sime. Nxehtësia e verës humbi dhe trupin tim të djersitur si me brymë e mbështolli ngrica.

*

U martuan ditën e parë të vjeshtës. Kamionët e ngarkuar me trungje, njëri pas tjetrit e braktisën vendin tonë. Pas martesës do të duhej të shkonin edhe ata të dy. Një ditë më parë e kalova tërë ditën e përlotur në shtrat duke përgjuar zërat gjithnjë e më të dehur të miqve tanë që kishin krijuar kolonën para shtëpisë sonë dhe, mesa duket, e kishin harruar tërësisht se bashkëshorti i ardhshëm, disa muaj përpara, kishte qenë vetëm një i huaj për to. Kur sytë e mi ishin krejtësisht të mbufatur dhe të thatë, e mbulova fytyrën me duar dhe mora frymë thellë. M'u duk sikur të kishte qenë dje, kur në duar i mbajta këpucët e tij, vazhdimësinë e trupit të tij. Në vend që të kishin aromën e tij, shuplakat e mia tani kishin aromën e dheut të lagësht. Me gishta rrëshqita poshtë nëpër trup ndërmjet këmbëve, në pjesën e vetme që nuk e kishte mbërthyer bryma e dimrit. Kur të gjithë shkuan në kishë dhe shtëpinë e mbuloi heshtja, zbulova se dashuria mund të ketë aromën e dheut të zi dhe se ajo ishte vetëm një pëllëmbë larg nga urrejtja.

Me rastin e martesës, babai ia fali motrës një palë këpucë krejtësisht të reja,

ANJA MUGERLI

Përktheu nga origjinali: Nikollë Berishaj



familja e bletëve

Onufri Tregime

*Fitues i Çmimit European të Letërsisë 2021.
“Familja e bletëve” është një nga veprat më të rëndësishme
bashkëkohore të letërsisë slovene.*

Shtatë tregimet e shkurtra të “Familja e Bletëve” lidhen nga ritualet, zakonet e lashta dhe traditat e kulturës slovene, të cilat përshtaten në një kontekst të ndryshëm ose në një mjedis bashkëkohor, ku marrin një rol dhe formë të re. Tema e familjes është në plan të parë: lexojmë për një familje të përcaktuar, një familje të bashkuar dhe të ndarë nga rrethanat e jetës, një familje që mund të bëhet e vërtetë në një rrethanë tjetër. Të gjitha tregimet zhvillohen në kohën e tashme, me përjashtim të tregimit titullar, i cili vendoset në një kohë historike të caktuar, por megjithatë duken pa kohë për shkak të pranisë së ritualit dhe atmosferës që përcjellin.

Përdorimi virtuoz i gjuhës nga autorja na përfshin në një botë që nuk e njohim, megjithëse jetojmë në të. Gjatë leximit të këtyre tregimeve, ne kalojmë vazhdimisht kufij – gjuhësorë, kulturorë, politikë, gjeografikë – si dhe ato midis realitetit dhe të pandërgjegjshmes.

me lëkurë të hollë dhe të lehta si pendë. Dola në oborr pikërisht atëherë kur ajo i mbathi. Porsa më pa, i shkëlqeu fytyra dhe në faqet e saj gjithmonë të zbehta, fshehurazi, ishte futur ngjyra e kuqe. Flokët e gjata i kishte lidhur në majë të kokës dhe kurrë nuk kishte qenë më e bukur. Me durim, prita që dasmorët e zgjedhur t'i ngrinin dollitë e tyre dhe ata të vallëzonin në mes të oborrit. Pastaj, kur atë e rrethoi një grup i punëtorëve të pyllit me dëshirat më të mira, e kapa për dore motrën. Ndërsa ecte pas meje, këpucët e saj të reja thuajse nuk bënë fare zhurmë. Pa na vënë re askush, u larguam fshehurazi nga oborri dhe dolëm në rrugë. Në vend që ta çoja drejt kafenesë së afërt, ku ai do ta gjente dhe do ta paguante një pije, siç është zakoni, mora drejtimin tjetër. Kur e tërhoqa

buzë shtëpisë së fundit në mbarim të rrugës, nuk kundërshtoi dhe kur para nesh u shfaq pylli, nuk tha asgjë. E ndieja vetëm shuplakën e saj që ishte shtrirë butësisht në shuplakën time, ashtu siç përputhet lehtësisht këmba në këpucën e punuar mjeshtërisht. E shikova vetëm një herë: kur ndaluam para njërit prej kamionëve që ende nuk ishte nisur në rrugë dhe e ndihmova të hipte. Sytë e saj ishin më të zinj se pylli më i errët.

Në heshtje, ndenjëm në trungjet e prera tërthorazi, prej të cilëve dilte rrëshira që na ngjitej në këmbë. Menjëherë pasi motori u drodh dhe kamioni u nis për rrugë, motra ime i zbathe këpucët e veta të reja dhe i vendosi para meje.

Roman i Ri nga "Ombra GVG" "Zonjusha mbresëlënëse Kesidi" nga Meihan Boey

Përktheu: Hedera Ceni

Meihan Boey, e lindur në Singapor, është shkrimtare e njohur dhe fituese e shumë çmimeve të rëndësishme letrare, në Singapor. Është autore edhe e romaneve The Messiah Virus, The Enigmatic Madam Ingram dhe The Mystical Mr. Kay. Ajo është një nga shkrimtaret më të njohura sot në Singapor.

Në Singaporin e viteve 1890, ka shumë mënyra se si mund t'a humbasësh jetën. Nëse nuk sëmuresh nga malaria, jetën mundet do të t'a marrin fantazmat hantu. Por as njëra dhe as tjetra nuk përbën problem për flokëkuqen Leda Kesidi, një nxënëse me rezultate shumë të mira që, të gjitha sfidat e jetës, i ka zgjidhur falë cilësive të saj të veçanta. Kur ajo mbërrin në Singapor nga Skocia për të shërbyer si kujdestare për Sara Xhejnin, fëmija e fundit e mbijetuar e familjes së madhe Bendemir, zbulon se pinjollët e kësaj familje nuk janë zhdukur nga ethet tropikale, por nga pontianaku që prej kohësh përndjek kopshtin e tyre. Në këtë rast asaj i duhet që të gjejë një zgjidhje.

Por, ka kohë që ajo ka tërhequr vëmendjen e vejanit të pasur Kai Uing Tong, familja e të cilit vuan nga një mallkim i tmerrshëm. Ai ka dy vajza binjake dhe është i shqetësuar sa për edukimin po aq edhe për martesën e tyre.

Kesidi pranon me kënaqësi të punojë për të, duke besuar se mund të ofrojë sadopak qetësi. Kur mbërrin në shtëpinë e punëdhënësit të ri, zbulon se ajo familje është e sulmuar nga shpirti i fantazmave, prandaj përpiket që ta rregullojë situatën pa asnjë vonesë. Sapo e çon në prehje një krijesë të mbinatyrshme, një

tjetër i zë vendin shumë shpejt. Asaj i duhet të përballet me forca shumë më të lashta e më të fuqishme se çdo gjë që ka hasur më parë... për të mos përmendur ngacmimet e papritura që ndjen brenda shpirtit të saj...

Zonjusha e mrekullueshme Kesidi, që i zgjidh të gjitha problemet me qetësi, të sjell në mend Meri Popinsin, arkeologjen detektive Amelia Peabadi, madje edhe aventurierin austriake Ida Pfeiffer, e cila ka vizituar Singaporin në shekullin e XIX.



ODE TË SHKURTRA PËR DRURËT E SHEKUJVE

Midis hithrave të përbindshme përqëndrohet
pranvera kryeneçe, pa gji ende dhe pa menopauzë,
prej menstruacioneve të hershme që pikojnë
lule kamomili atje në pjerrësitë e brinjes
me polenin e varur
nga skajet e reve.
Katër pemë që dua t'i himnizoj,
me katër tingujt e tyre
prej drurit dhe prej erës.

I. Ode për rrapin e barinjve

Mitet që grumbullohen kokë me kokë
si shushuritje
rreth zjarrit
të Katarsit të Kohës,
ndalojnë memorjen e tyre
dhe kërkojnë një përligje sado të vogël.

Urëmbimi prej Centaurëve
i vajzave të lumit
që kriheshin të trembura,
ende më thonë:
-Mos e lini rrapin!
Mos pini pijen e harresës! më thonë...

Të linjtat e tyre lahen në lumë
dhe skuqet lumi,
skuqet gjithashtu perëndimi.
Si një vajtim kumbon kënga e tyre
deri sa shiu
e fshin, e fshin, e fshin...
pikat e tij pikojnë
larje mëkatesh.

Centaurët rrëshqasin dhe ikin
nga ballina e mermertë,
kalorësit e pasionit,
duke i braktisur ato
leshleshuara
me shënja dhune pasdite.
Barinjtë ziejnë qumështin
rreth zjarrit të heshtur, dhe
ndonse e dine ndodhinë, këndojnë,
dhe ndonse janë të pikëlluar,
veshin palltot dhe këndojnë
në karrocën e hënës
që u ledhaton kryet.

-Mos e harroni rrapin!

II. Odë për lisin e Heronjve të vdekur

Ata pushojnë pa hije
poshtë degëve të tua
të vdekurit e revoltave
duke renditur fushatat e tyre,
bëmat e tyre,
vdekjet,
dhe shokët e humbur,

dhe pastaj ndodhitë e tyre
gjatë kthimit në atdhe:
anija që ishte mbytur
gratë që i kishin joshur
stuhitë që i kishin mbytur
gjarpërinjtë që i kishin kafshuar
shkëmbinjtë e rëzuara udhës së tyre,
kisarët që u ndeshen,
historitë që dëgjuan
qytetet që takuan...

qeshin pa zë,
këndojnë pa muzikë
epose të harruara.
Askush nuk u afrohet
askush nuk u hedh sytë.
Presin damaret e tyre
pa dalë gjak
trokasin kupat duke pirë
dhe vetëm trokitja kumbon
sikur kërcasin kockat e natës.
Luten vetëm atëhere
kur shikojnë ndonjë poet kalimtar,
të shkruajë një varg dhe për ta.
Zgjojen herët në të aguar

Nikos Vlahakis
Ode të shkurtra
për pemët e
shekujve

Përktheu nga greqishtja
Niko Kacalidha



dhe shndërrohen lagështirë
që mbështjell muret e kështjellës
avuj uji që kurorëzojnë detin....

Kalorës të Agimit i kanë quajtur
për t'i dalluar nga të vdekurit e tjerë
që nuk kanë lis,
ku rrënja e drurit të tyre
nuk ka të vdekur...

III. Odë për ullirin e qetësisë

Lutje,
Vështrimi yt drejt qiellit
dhe degët e tua argjend rrezatojnë
gjatë ledhatimit të dritës.

Lënë veglat e tyre
të punës fshatarët,
fusha lëshon farën e saj,
përgjegjësinë e një qetësie universale,
ty ta ka ngarkuar
një zot kalimtar,
bashkë me orakullin e kohës si shenje
mirënjohje për mirëseardhjen tënde.
Atje ku Kronosi i vogël luan shkujdesur
para se të vrasë atin e tij.
Dhe milingonat dëshirojnë të bëhen
Engjëj mikroskopikë
mbi trungun tend,
që e përshkojnë lëngje mistike dhe viskoze.
Nën mbrojtjen tënde lindë një grua,
nën pëshpëritjen tënde
dy trubadurë venecianë
rrefejnen me mandolinë dashuritë e tyre,
poshtë dheut tënd
rrjedhin botë të padukshme.
Nën hijen tënde
ëndrron udhëtari
udhët që ende nuk ka shkelur.

U prehsh në paqe...

IV. Ode për pishën me minjtë

- Lërmë të vij me ty sonte në mbrëmje,
deri në fund të sternës që llomotit historitë e ujit
dhe pranë manastirit
të mbyllur në devotshmërinë e tij.
Lërmë të të ndjek
deri atje lart ku ngjitet pisha
duke skicuar premtime dashurie
të çifteve që e rrethojnë përnatë.

Lërmë të kaloj pranë lutjes
që bën çdo ditë horizontit,
ta kuptoj dhe ta gdhend
në një gur.

Lërmë të dëgjoj minjtë që kacavaren
në degët e tua buzëmbremjes,
dhe luajnë të pacipa skena dashurie,
duke trembur lakuriqët e natës
dhe orakujt e tyre të padeshifrueshme
dale nga rropullitë e shpellave rreth tyre.

Lërmë të të puth
duke shtrënguar në duar dehjen e hurmes
dhe duhmën e fijes së barit të egër
si shtroje që na vë në gjumë.

Lërmë të kujtoj në krahët e tua
kohën kur muajt mbanin kurora dredhke
duke u kacavarur në trupin tënd...

-Lërmë të të puth sonte,

Lirika tristike

Degët e ftohta të bajames
mbajnë një kryeneçësi
thuaje të pandjeshme.

Rreze diellore ngrohin rrënojat e lashta,
një ndjenjë sakrilegji
e shtangur zgjohet.

Lirizmi kalëron
si kalorës stolisur
me gjerdane e kordele.

Fantastike vareshin
në ballkone,
degët e çelura të jaseminit.

Në bordura trotuaresh
kundërmon ende
era e harruar e trëndafilut.

Banoja në gjuhë të huaja
duke ushqyer pëllumba
në ballkonet e tyre.

Dita e Fitores
me fytyrën e disfatës së lashtë
flamur në qepalla.

Lejlekët si trombonet
kumbonin oshtimën e detit
deri në brendësitë e dheut.

E gjelbra ngulë në sy
reflekse buthtimi
të mureve urbane.

Kërkova detin,
në mëngjes të porsalindur
dhe dashnor në mbrëmje.

Në brigjet e Adriatikut
jipnin shpirt kohrat e një historie
prej porcelani dhe panje.

Jambe, daulle dhe psherëtima
dëgjoheshin në brigjet e Eolisë
nga barkat e refugjatëve.

Rishikoja heshtjet e horizontit
në bunacën e deteve jugore.
Si jehonë përjetësie, mendoja...

Kupa të purpurta zbardhëllimi
mbushnin durimin tim të pritjes.

Nikolaos Vlahakis është një poet grek, veprat e të cilit janë përkthyer në anglisht, spanjisht, frëngjisht, bullgarisht dhe gjermanisht. Ai ka shkruar gjithashtu artikuj mbi letërsinë, politikën ndërkombëtare dhe teorinë sociale, të cilët janë botuar në gazeta dhe revista, në Greqi dhe jashtë saj. Ka qenë poet i ftuar në Festivalin e 27-të Ndërkombëtar të Poezisë në Medellín, Kolumbi; pjesë nga përmbledhja e tij e parë poetike janë përkthyer në anglisht dhe bullgarisht dhe janë botuar në revistën “Literaturni Balkani”, ndërsa disa nga poezitë e tij janë botuar së fundmi në revistën franko-kanadeze “Le Crachoir de Flaubert” dhe në “Variations”, revistën letrare të Universitetit të Cyrihut.

Vlahakis ka lindur në Kretë në vitin 1967 dhe ka studiuar filozofi në Universitetin e Sofjes, Bullgari. Ai ka studiuar gjithashtu administratë publike në Shkollën Kombëtare të Administratës Publike në Athinë dhe ka marrë një diplomë master në marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime strategjike në Qendrën Evropiane për Kërkime Ndërkombëtare dhe Strategjike në Bruksel. Ka shërbyer si Këshilltar për Shtypin dhe Komunikimin në disa ambasada greke, mes të cilave edhe në Tiranë.

Ju keni botuar tashmë tre përmbledhje poetike dhe shumë nga poezitë tuaja konsiderohen si të ndikuara nga poeti i madh grek Kavafis. A keni burime të tjera frymëzimi?

Zakonisht kemi ndikime të ndryshme, madje edhe ata që nuk shkruajnë, por janë thjesht lexues të poezisë. Është e vërtetë që disa kritikë kanë vërejtur një ndikim të Kavafit, kryesisht në përmbledhjen time të dytë poetike “Ura e Shqiponjave”. Të tjerë kanë dalluar ndikimin e Odiseas Elitisit ose, në përgjithësi, të të ashtuquajturës “brezi i viteve ’30”. Kjo është pjesërisht e saktë, megjithatë mund të them se shqetësimi im është të shoh përtej këndvështrimit të këtij brezi.

Shpesh jam kthyer te autorët klasikë të poezisë moderne greke, nga Solomos te Palamas, Kavafis, Seferis, Elitis, Ricos etj. Kjo ishte e pashmangshme në përpjekjen time për të krijuar një stil më personal. Në këtë përpjekje kam pasur edhe dëshirën për të hyrë në një dialog me këta poetë të mëdhenj. Megjithatë, gjatë këtij procesi, njeriu duhet të zbulojë shprehjen e vet.

E njëjta gjë ndodh edhe sa i përket ndikimeve të huaja, veçanërisht në gjuhët që përmendët: Pablo Neruda dhe Lorka ishin ata që më tërhoqën më shumë në poezinë spanjolle, ndërsa simbolizmi francez është, sipas mendimit tim, një model i pakapërcyeshëm i poezisë. Dikur kam qenë i pasionuar pas Mallarmé-së, Paul-Marie Verlaine-it, si dhe Arthur Rimbaud-it.

Sa i përket poetëve anglishtfolës, mund të pranoj se kur zbulova Allen Ginsberg-un, kjo ishte arsyeja që fillova të shkruaj sërish poezi pas një periudhe të gjatë ndërprerjeje. Poezia e tij më dha shtysën për të rifilluar, duke bërë disa ushtrime përkthimi. Më vonë u mahnita edhe nga William Butler Yeats. Megjithatë, takimi me shumë poetë të tjerë nga vende të ndryshme e pasuroi rrugëtimin tim poetik. Thelbi, sigurisht, është që të gjitha këto ndikime të ndryshme t’i shndërrosh në “idiomën” tënde poetike, dhe kjo mund të bëhet vetëm në “punishten” tënde poetike.

Cili ishte kontakti juaj i parë me poezinë? Cila nevojë e brendshme ju shtyu të shpreheni në mënyrë poetike dhe cilat janë burimet e frymëzimit tuaj?

Prirja ime për të shkruar, veçanërisht poezi, u zhvillua që në moshë të hershme. Tradita familjare tregon se shaxhai im, vëllai i nënës sime, botoi disa përmbledhje poetike shumë të spikatura, të cilat na i dhuronte. Në ishullin e Kretës, ku jetoja në atë kohë, mora pjesë në disa konkurse letrare lokale në moshën 16–17 vjeç, ku u vlerësova me çmime dhe veprat e mia u botuan. Kjo ishte një shtysë e fortë që e mbajti gjallë interesin tim për poezinë.



Niko Vlahakis *flet për poezinë*

Kur miku im Niko Kacalidha, poeti i shquar i letërsisë shqipe dhe asaj greke, më foli për të botuar disa poezi që i kishte përkthyer nga greqishtja, nuk do ta kisha menduar kurrë se bëhej fjalë për ish atasheun e shtypit të ambasadës së Geqisë, Niko Vlahakisin, që e kisha njohur vite të shkuara në Tiranë.

Isha botues i ri atëherë dhe problemet me viza për të udhëtuar në vendet e BE për panaiet ndërkombëtare të librit apo për çështje pune, ishte, pak të thuash, një vuajtje e madhe. Sidomos, interesi ishte për fqinjnin tonë jugor, ku na lidhnin përveç kulturës së pasur, por edhe biznesi i shtypshkronjës.

Ajo që më ka mbetur në mendje sot e kësaj dite, ka qenë sikleti im, se si pas gjitha atyre bisedave të çmuara me atasheun e ri të shtypit në ambasadën greke, për letërsinë dhe botimet, për Homerin, Elitisin, Seferisin, dhe sidomos Kadarenë (unë sapo e kisha nëshkruar kontratën me gjenium tonë), do të vinte ai moment kur më duhej të zbrisja nga Olimpi i artit dhe të kërkoja ... një vizë për të hyrë në Greqi. Sidomos, kur shihja nga dritarja e zyrës së tij, radhën e pafund të bashkatdhetarëve të mi, që rrinin të heshtur me ditë të tëra përballë sportelit të ambasadës.

Kjo vizë më nevojitej atëhere sepse doja të shtypja me cilësi të lartë (megjithëse Onufri kishte shtypshkronjën e vet) një vëllim poetik të Kavafisit, që e kishte përkthyer miku im Luan Zyka, një njohës i shkëlqyer i greqishtes. Por ç’kishte bërë Nikos, ndërkohë që ne bisedonim? E gjithë procedura për marrjen e vizës ishte kryer. Edhe sot që po i shkruaj këto radhë e ndiej lehtësimin dhe sjelljen e tij elegante dhe i jam përjetë mirënjohës!

Duke përkthyer këtë intervistë të tij të para pesë vjetëve, mesova se ishte një poet i rëndësishëm i kulturës greke dhe Kavafis kishte ndikuar në krijimtarinë e tij. Ja që Kavafis, me siguri, kishte ndikuar tërthorazi edhe për mua për t’i shtypur poezitë e tij në Greqi.

Letërsia dhe arti nuk kanë kufij, por atëhere isha me fat që nëpunësi i ambasadës ishte poet dhe me siguri, kishte respekt për botuesit.

S’euxaristo polu agapite Nikos!

BUJAR HUDHRI

Fillova të shkruaj sërish poezi pas një periudhe të gjatë ndërprerjeje, kryesisht pas viteve të studimeve, megjithëse gjatë kohës së studimeve lexoja shumë prozë dhe romane. Në Kretë, megjithatë, ku jam rritur, tradita e gjallë popullore që buron nga “Erotokritos” dhe vazhdon me vargjet e rimuar në formë rrëfimi ose dialogu (mantinada), na bën të gjithëve të mendojmë si poetë! Frymëzimi im buron nga përpjekja për të shprehur refleksimin filozofik në formë poetike. Një përpjekje për të ndërthurur filozofinë me formën e përqendruar dhe të dendur të poezisë.

Për shkak të detyrës suaj si Këshilltar për Shtypin dhe Komunikimin në Sekretariatin e Përgjithshëm për Media dhe Komunikim, keni jetuar për shumë vite jashtë vendit. A ju ka munguar Greqia gjatë gjithë këtyre viteve?

Po dhe jo. Meqenëse rutina ime e përditshme dhe puna ime ishin drejtpërdrejt të ndërthurura me aktualitetin politik dhe zhvillimet e tjera në vend, si edhe si pjesë e administratës publike të Greqisë jashtë saj, nuk do të thosha se më ka munguar Greqia. Ajo ishte vazhdimisht e pranishme në mendjen time. Ajo që më ka munguar ndoshta ishte peizazhi, njerëzit e mi dhe kujtimet e mia. Megjithatë, kjo nostalgji është një shtysë krijuese për poezinë.

Cili është fokusi kryesor i përmbledhjeve tuaja poetike?

E konsideroj veprën time poetike, të botuar nga Gavrielides Publications, si një trilogji, një refleksim i përsëritur mbi historinë greke, brenda hapësirës dhe kohës, si edhe mbi historinë e Ballkanit dhe të Evropës në përgjithësi. Për më tepër, librat e mi janë të lidhur me qytetet ku i kam shkruar, gjatë kohës kur shërbeja si Këshilltar për Shtypin dhe Komunikimin në disa ambasada të Greqisë: përmbledhjen e parë e nisa në Tiranë dhe e përfundova në Bruksel; të dytën në Sofje dhe të tretën në Budapest. Në njëfarë mënyre, ato janë kronika poetike të këtyre qyteteve, ose të paktën kështu do të doja t’i karakterizoja.

Përmbledhja e parë (*Traktate të një Force Shumëkombëshe ose Terra Incognita*) i referohet një konceptimi të Ballkanit si një terren i ashpër historik, i cili e përvetëson ose madje e burgos objektivitetin në sferën e brendshme të idesë së një toke të panjohur (*Terra incognita* është nëntitulli).

Përmbledhja e dytë është një metaforë e rikthimit të përjetshëm në Kohë, përmes portave të një ure të ruajtur nga katër shqiponja imagjinare (*Ura e Shqiponjave*), të cilat përbëjnë korin, ndërsa në qendër gjendet një kalendar digresiv i jetës së përditshme. Mund të them se është një këndvështrim metafizik i historisë.

Në përpjekjen e tretë, bëj një anatomi poetike të stereotipeve tona atavike, atë që filozofi anglez Francis Bacon e quajti “Idola tribus”. Në mënyrë të pashmangshme, kjo më çon në një marrëdhënie të vetëdijshme me Greqinë dhe atdheun tim, Kretën. Në këtë kuptim, e shoh veprën time si një lloj poezie politike, megjithëse jo e dukshme në shikim të parë.

A mendoni se revolucioni digjital ka ndikuar në krijimin poetik dhe, nëse po, në çdrejtim?

Jo në mënyrë kaq vendimtare, por besoj se ai do të ndikojë çdo aspekt të artit dhe të shprehjes. Dhe nuk kam parasysh vetëm mënyrën e qarkullimit, botimit dhe shpërndarjes së krijimtarisë poetike. Ai do të ndikojë në mënyrë strukturore.

Le të jap një shembull: haiku-ja ka filluar të bëhet një formë poezie me të cilën po merren gjithnjë e më shumë poetë në mbarë botën, duke shkruar përtej traditës japoneze që e krijoi atë. Kjo ndodh sepse sot, me një “tweet” të thjeshtë, mund të shpërndash haikun tënd të përditshëm. Nga ana tjetër, ky fakt përcakton edhe mënyrën se si po shkruhet sot poezia, me çfarëdo ndikimi që kjo mund të ketë, negativ apo pozitiv.

Poezia rikthehet në plan të parë, pasi interneti kërkon komunikim të shkurtër dhe të përmbledhur, një lloj sinteze, si një formë arti bashkëkohor. Vitin e kaluar mora pjesë në Festivalin e 27-të Ndërkombëtar në Medellín, Kolumbi, ku kuptova se prirjet moderne në poezinë ndërkombëtare po ndërthurin multimedia-n, video-artin dhe artet performuese në përgjithësi.

A mendoni se kriza e fundit ekonomike ka ndikuar në poezinë greke?

Mendoj se po. Brezi i ri ka filluar të krijojë artin e kësaj periudhe në çdo fushë. Është një përvojë kolektive që përcakton fuqishëm mënyrën se si sot i perceptojmë horizontet tona. Është karakteristike se, kur po largohesha nga Berlini, ku shërbeja së fundmi, një poet gjerman më propozoi të përgatisnim së bashku një “Antologji të Poezisë Greko-Gjermane të Krizës”.

Për më tepër, ajo do të jetë shenja që ndan dy periudha të historisë së fundit të Greqisë: periudhën e krizës nga periudha pas saj.

*Intervistoi Marianna Varvarrigou
Greek News Agenda Agenda, 29 tetor 2018
Përktheu nga anglishtja Bujar Hudhri*

Karikaturë nga Arben Mexsi

